



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE

RAPORT KONSULTIMI
PËR PROJEKT STRATEGJINË PËR SUNDIMIN E LIGJIT

Hyrje

Projekt Strategjia për Sundimin e Ligjit është nisma e parë strategjike dhe gjithëpërfshirëse për planifikimin e politikave në këtë sektor. Strategjia është hartuar në bashkëpunim dhe koordinim të plotë në mes të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial, si dhe institucioneve tjera në këtë sektor, por edhe në partneritet dhe konsultim me shoqërinë civile dhe donatorët ndërkombëtar.

Përmes Strategjisë synohet që të rikthehet besimi i qytetarëve dhe qytetareve në drejtësi, sistem gjyqësor e prokurorial.

Strategjia është pesë vjeçare, zbatimi i saj synohet të filloj në mesin e vitit 2021 dhe e njëjta do të skadoj në mesin e vitit 2026. Ajo ndahet në gjithsej 7 (shtatë) kapituj, gjegjësisht 6 (gjashtë) kapituj të pjesës narrative dhe Kapitullit 7 (shtatë) – Planit të Veprimit, ku janë të listuara aktivitetet specifike që kontribuojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe adresimin e problemeve të identifikuara.

Ecuria procesit të konsultimit

Projekt Strategjia për Sundimin e Ligjit është publikuar për konsultim me publikun në platformën elektronike për konsultimet me datë 18.01.2021 dhe e njëjta ka qenë e hapur për konsultime deri me datë 18.01.2022.

Gjatë procesit të konsultimit janë pranuar gjithsej 366 komente nga institucionet/organizatat si në vijim:

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Akademia e Drejtësisë;
- Policia e Kosovës;
- Njësia për Inteligjencë Financiare;
- Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyres së Kryeministrit;
- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë;
- Misioni i OSBE-së në Kosovë;
- OJQ 'Grupi për Studime Juridike dhe Politike';
- OJQ 'Rrjeti i Grave të Kosovës', dhe
- OJQ 'Advancing Together'.

Pas pranimit të komenteve, me datë 29.04.2021, është zhvilluar një takim i përbashkët me të gjitha palët që kanë dërguar komente gjatë konsultimit publik dhe anëtarët e grupit punues për hartimin e Projekt Strategjisë. Ky takim është udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu, në të cilin kanë marr pjesë edhe Kryesuesi i KGJK-së z. Skender Çoçaj, Kryesuesi i KPK-së z. Jetish Maloku dhe përfaqësues tjerë të institucioneve. Në këtë takim është diskutuar për komentet e pranuar dhe kontribuesit

janë njoftuar se për adresimin e tyre specifik në Projekt Strategji do të organizohen takime bilaterale me ta.

Këto takime bilaterale janë organizuar gjatë dy muajve - Maj dhe Qershor, 2021, ku janë dhënë edhe qartësime të mëtutjeshme për komentet e dërguara dhe mënyrën e adresimit të tyre.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike;	30 ditë	Kontribues - 9
2. Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike	30 ditë	Kontribues - 1
3. Takimet publike	1	

Përmbledhje e kontributeve të pranura gjatë procesit të konsultimit

Në procesin e konsultimit publik janë dërguar komente të natyrës së ndryshme qoftë në pjesën narrative të Strategjisë, ashtu edhe në Planin e Veprimit - gjithsej 366.

Nga këto komente:

- 201 komente janë **pranuar plotësisht** (55%).
- 55 komente janë **pranuar pjesërisht** (15%).
- 110 komente janë **refuzuar** (30%).

Hapat e ardhshëm

Projekt Strategjia është finalizuar dhe është miratuar nga Qeveria me datën 11 gusht 2021.

Shtojca - Tabela e detajuar me informatat për kontribuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranura dhe të refuzuara.

Për shkak të numrit të madh të komenteve, shtojca është e bashkëngjitur në formatin *excel*.

Emri i organizates/individit	Objektivi Specifik (Dokumenti i Politikës)	Aktiviteti (shëno rreshtin e aktivitetit)	Teksti aktual i aktivitetit	Komenti	Përgjigja nga Ministria: Pranohet plotësisht/ pranohet pjesërisht/ refuzohet	Sqarimi nga Ministria
EU	Koment i pergjithshem			Strategjia duhet të parashohë një kohëzgjatje të përcaktuar. Sugjerojmë që të shtohet një kornizë të afateve kohore për zbatimin e Strategjisë, p.sh. 2021 - 2026.	Pranohet plotësisht	Është reflektuar periodha kohore në titullin e Strategjisë.
EU	Koment i pergjithshem			Do të ishte mirë të përfshihej një listë e shkurtesave për shkurtesat e përdorura në Strategji.	Pranohet plotësisht	Është hartuar lista e shkurtesave në fillim të Strategjisë.
EU	Koment i pergjithshem			Numërimi i kapitujve përkatës në Strategji çon në konfuzion. Gjithashtu, kujdesi i duhur duhet kushtuar numërimit dhe referencave të aktiviteteve, p.sh. Duke filluar me Objektivin Strategjik 4.1 Forcimi i sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial, tabela që përmban Objektivat Specifikë referohet si 5.1.1 Rritja e përgjegjshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe vazhdimi me Objektivin Strategjik përsëri 4.1 Forcimi i sistemit të Drejtësisë Penale, etj. Në këtë drejtim nevojitet	Pranohet plotësisht	Është bërë harmonizimi i numrave dhe referencave në verzionin final.

				harmonizimi i numrave dhe referencave.		
EU	Koment i pergjithshem			Përkthimi mund të jetë një çështje, si dhe ndonjëherë Strategjisë duket se i mungon një strukturë e qartë dhe ka shumë përsëritje. Kjo mund të përmirësohet më tej. Për më tepër, duket se ka mospërputhjet në terminologjinë e përdorur në të tri gjuhët.	Pranohet plotësisht	Verzionet e përkthyer janë rishikuar.
EU	Koment i pergjithshem			Ka veprime në Planin e Veprimit që nuk janë lidhur me ndonjë apo edhe janë në kundërshtim me disa nga gjetjet dhe/ose rekomandimet në të dy dokumentet. Në të njëjtën kohë, disa nga gjetjet dhe/ose rekomandimet e rëndësishme nga të dy dokumentet nuk adresohen nga Plani i Veprimit.	Pranohet pjesërisht	Disa rekomandime nga dokumentet e politikave janë larguar për shkak se: kanë filluar të implementohen; nuk kanë qenë koherente me realitetin aktual; dhe ndryshimet kushtetuese janë larguar për shkak të qëndrimeve të Qeverisë së kaluar. Disa aktivitete shesë megjithatë janë shtuar pas periudhës së konsultimit publik.

EU	Koment i pergjithshem			Seksioni i sfondit apo historikut të Strategjisë është mjaft optimist dhe nuk po pasqyron plotësisht realitetin. Kur pika e fillimit të një strategjie nuk pasqyron realitetin, strategjia dhe zbatimi i saj nuk do të kenë rezultatet e dëshiruara.	Pranohet pjesërisht	Disa pjesë të Sfondit janë rishikuar, në përputhje me komentet e pranuar. Gjithashtu do të bëhet publikimi i dokumenteve të politikave në webfaqen e MD-së, për të treguar se ku është bazuar Sfondi.
EU	Koment i pergjithshem			Kemi pritur që Strategjia të ishte disi më inovative dhe të propozojë zgjidhje disi më kreative, duke pasur parasysh edhe rekomandimet në dokumentet e politikave. Gjithashtu, veprimet nuk janë mjaft konkrete. Ndërsa shumë sfida të sektorit të drejtësisë përshkruhen në detaje, ka disa zgjidhje konkrete të propozuara.	Pranohet pjesërisht	Shih komentin më lartë për 'largimin e disa rekomandimeve të dokumenteve të politikave'. Në anën tjetër PV aktualisht ka mjaft veprime konkrete, por nëse futen veprime shtesë në PV tash pas konsultimit, atëherë mund të konsiderohet që Strategjia ka ofruar edhe më shumë inovacion dhe zgjidhje më kreative.

EU	Koment i pergjithshem			Strategjia përdor gjuhë konkluduese pa siguruar ndonjë referencë ose provë për të mbështetur përfundime të tilla. Për shembull në fq. 11 të Strategjisë, ku thuhet “Kjo do të thotë që disa gjyqtarëve dhe prokurorëve u mungon integriteti, gjë që nga ana tjetër potencialisht ndikon në vendimet e tyre.” Duke qenë se Strategjia është hartua me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara përkatëse, ajo duhet të përmbajë gjuhë më neutrale dhe më e rëndësishmja të gjitha konkluzionet duhet të mbështeten nga prova dhe analiza. Në pjesën për komente specifike, ne do të japim disa shembuj më konkretë të një gjuhe të tillë.	Pranohet plotësisht	Dokumentet e politikave do të publikohen në uebfaqen e MD-së.
EU	Koment i pergjithshem			Gjatë gjithë Planit të Veprimit, ekziston një mospërputhje ndërmjet numrit të aktiviteteve të parashikuara për të arritur rezultatet. Për shembull, nuk është realiste të thuash që me një fushatë sensibilizuese, 1 fushatë televizive dhe 1 broshurë të botuar dikush mund të edukojë publikun dhe të rrisë numrin e mbështetësve të reformave kundër korrupsionit.	Refuzohet	Fjala është për nga një fushatë në vit, por ka edhe aktivitete tjera që kontribuojnë në rritjen e edukimit të publikut.
EU	Koment i pergjithshem			Pasojat e Pandemisë së COVID-19 nuk përmenden ose nuk merren parasysh gjatë gjithë Strategjisë.	Pranohet plotësisht	Është paraparë zbatimi i Planeve emergjente të KGJK

				Është e rëndësishme të diskutohen pasojat e pandemisë dhe të gjitha çështjet shoqëruese.		dhe KPK për pandeminë.
EU	Koment i pergjithshem			Strategjia nuk arrin të sigurojë një bazë kundrejt të cilave mat progresin/mungesën e një numri çështjesh për të cilat diskuton.	Pranohet plotësisht	Strategjia i ka Objektivat dhe Indikatorët e saj. Gjithashtu janë shtuar indikatorë shtesë.
EU	Koment i pergjithshem			Rekomandohet që Strategjia të përdorë gjuhën për sqarimin e hierarkisë së Strategjisë dhe Planit të Veprimit karshi strategjive tjera sektoriale të sundimit të ligjit, dhe në rast se ekzistojnë strategji të miratuara në nivelin e Kuvendit, të rregullojnë bashkëjetesën e masave të ngjashme për çështjet e mbuluara nga drafti aktual i Strategjisë.	Pranohet plotësisht	Kjo është sqaruar në tekst.
EU	Koment i pergjithshem			Strategjia u referohet treguesve të ndryshëm nga institucione të ndryshme për qëllime të monitorimit dhe vlerësimit. Është e rëndësishme të dihet nëse këta tregues bien ndesh ose jo, pasi kjo do të ndikojë në rezultatin e monitorimit dhe vlerësimit. Duhet të ketë një ekuilibër ndërmjet treguesve të ndryshëm.	Pranohet plotësisht	Treguesit sipas pikëpamjes tonë nuk bien ndesh dhe ka ekuilibër.
EU	Koment i pergjithshem			Meqenëse Strategjia synon të trajtojë si prioritet çështjet në departamentet civile dhe administrative, ne propozojmë sa vijon Treguesit e performancës së CEPEJ për këto kategori specifike të rasteve, Normën	Pranohet plotësisht	Këta tregues janë shtuar.

				e Zgjidhjes së Lëndëve (%) dhe Kohën e llogaritur për përfundimin e lëndëve të pazgjidhura (ditë) - (gjithashtu tabela në dokumentin e dërguar nga EUO).		
EU	Koment i pergjithshem			<p>Sugjerojmë një tjetër tregues kyç të performancës: mosha e lëndëve të pazgjidhura, i cili monitoron numrin e lëndëve që janë, për shembull, më pak se 6 muaj të vjetra, ndërmjet 1 dhe 2 vjeç, më shumë se 3 vjeç, etj. Ky tregues është thelbësor për të siguruar që lëndët më të vjetra zgjidhen së pari (siç përmendet në Strategji: Parimi FIFO).</p> <p>Tregues tjerë që mund të përdoren janë kohëzgjatja mesatare e procedurave dhe numri i seancave të shtyra. Në fund, është e rëndësishme të theksohet se jo vetëm sasia, por edhe cilësia e punës së bërë nga gjykatat duhet të monitorohen. Përqindja e lëndëve të kthyera për rigjykim nga gjykata e apelit në gjykatat themelore duhet të monitorohet.</p>	Pranohet plotësisht	Janë adresuar të gjithë indikatorët, ndërkaq për matjen e përqindjes së lëndëve të kthyera, është futur një aktivitet i ri në PV.
EU	Koment i pergjithshem			Rekomandojmë që Plani i Veprimit të rishikohet në përputhje me Terminologjinë e CEPEJ: “Treguesit e CEPEJ 3.1 a) Norma e Zgjidhjes së Lëndëve, b) Koha e llogaritur për përfundimin e lëndëve të pazgjidhura”. Këto janë termat	Pranohet plotësisht	Këta tregues janë shtuar.

				zyrtarë nga Fjalori CEPEJ i përkthyer në shqip.		
EU	Koment i pergjithshem			<p>Është fakt i njohur që sistemi i Kosovës në përgjithësi është i pajisur me ligje të mira.</p> <p>Problemi është (mungesa) e vullnetit/kompetencës së faktorit njerëzor për t'u pajtuar me të vërtetë dhe për zbatimin e ligjeve ekzistuese. Sigurisht, asnjë strategji nuk mund të rregullojë mungesën e vullnetit politik. Megjithëse zbatimi i legjislacionit përmendet në Strategji si sfidë e përgjithshme, legjislacioni specifik i cili ngec në zbatim nën kapitujt përkatës nuk përmendet. Ne nuk shohim veprime dhe objektiva konkrete që do të adresonin këtë mungesë të zbatimit.</p>	Pranohet pjesërisht	Në pjesën narrative dhe Planin e Veprimit të Strategjisë është diskutuar çështja e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, pas konsultimeve shtesë me ZBE.
EU	Koment i pergjithshem			<p>Strategjia në mënyrë më të dukshme mund të marrë në konsideratë zbatimin e nenit 5 të Ligji për Barazinë Gjinore. Ky nen, ndër të tjera, parasheh që të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore duhet të analizojnë statusin e grave dhe burrave në organizatën dhe fushën përkatëse; të miratojnë strategji dhe plane veprimi për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi</p>	Pranohet pjesërisht	Janë paraparë aktivitete shtesë sa i përket mbledhjes së statistikave në Planin e Veprimit. Pjesa e rekrutimit është tanimë e rregulluar me aktet e brendshme të KPK-së dhe KGJK-së.

				Gjinore; të sigurojnë që proceset e përzgjedhjes, rekrutimit dhe emërimit të jenë në përputhje me kërkesën për përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave; dhe të ndajnë të gjitha të dhënat dhe informacionet e mbledhura statistikore sipas gjinisë.		
EU	Koment i përgjithshëm			Strategjia duhet të jetë e lidhur në mënyrë të qartë me implementimin e detyrimeve për të drejtat e njeriut nga Kosova dhe duhet ta njohë këtë në hyrjen dhe tekstin e saj në mënyrën e duhur.	Pranohet plotësisht	Është reflektuar në tekst
EU	Koment i përgjithshëm			Ne e mirëpresim referencën në Strategji për parandalimin e korrupsionit dhe masat e sugjeruara aty.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i përgjithshëm			Si pjesë e modifikimit të mandatit dhe drejtimit të disa prej kompetencave në parandalimin e korrupsionit, vendosja e një bashkëpunimi të vazhdueshëm, të rregullt me shoqërinë civile, OJQ-të dhe organizatat e tjera tashmë aktive në fushën e monitorimit të korrupsionit dhe parandalimin e tij, duke përdorur aftësitë e tyre për të mbledhur reagime dhe informacione nga shoqëria civile duhet të krijohen.	Refuzohet	Ka aktivitete specifike të parapara tanimë në PV - Kapitulli 3.4

EU	Koment i pergjithshem			Rekomandohet të analizohet më tej problemi dhe të gjendet një zgjidhje më të mirë në trajtimin e problemit të lëndëve të vjetra dhe shkeljen e standardeve të arsyeshme kohore.	Pranohet plotësisht	Një numër i madh i aktiviteteve në Planin e Veprimit pritet të ndikojnë në numrin e lëndëve të vjetra si dhe shkeljen e standardeve të arsyeshme kohore. Ky problem megjithatë do të shtjellohet tutje në Koncept Dokumentin e paraparë për gjykimin në kohë të arsyeshme.
EU	Koment i pergjithshem			Sa i përket substancës, terminologjia e përdorur në Strategji përfshin në mënyrë zëvendësuese termet "Veting", "Verifikim" dhe "kontrolle integriteti". Kjo duhet të sqarohet përmes përdorimit të terminologjisë sistematike pa përdorur termin "veting". "Veting" i referohet një rivlerësimi të plotë të njëhershëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve si në Shqipëri; "Kontrollet e integritetit" duket se është termi i duhur për procesin e parashikuar në Strategji, i cili përbëhet nga një sistem kontrollesh të rregullta çdo pesë vjet, që duhet të kryhen nga një njësi e specializuar.	Pranohet pjesërisht	Termi është i sqaruar brenda në dokumentin e politikave që sjellë këto rekomandime. Aktivitetet që janë përfshirë në Strategji nuk e japin përgjigjen finale për modalitetet e vetingut, por bëjnë thirrje që të dizajnohet një sistem për verifikim të vazhdueshëm dhe të rregullt të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe stafit mbështetës.

						Aktivitetet specifike do të vendosen në Plan të Veprimit në përputhje me Koncept Dokumentin që është duke u zhvilluar për vetingun në sistemin e drejtësisë.
EU	Koment i pergjithshem			Ndërsa BE është e gatshme të ndihmojë autoritetet e Kosovës me masa për të forcuar llogaridhënien dhe integritetin e gjyqësorit të saj, rezultate të konsiderueshme pozitive mund të arrihen me aplikimin sistematik të mjeteve tashmë ekzistuese me disa përmirësime të mundshme. Një veting i plotë nuk është i përshtatshëm për kontekstin në Kosovë (pasi të gjitha kushtet e nevojshme nuk ekzistojnë). Kjo është për një numër arsyesh, duke përfshirë: Ø duhet të konsiderohet vetëm si një masë e jashtëzakonshme e mundësisë së fundit ku niveli i korrupsionit është	Refuzohet	Shih komentin paraprak.

				<p>aq i lartë sa institucionet përkatëse janë thelbësisht jofunksionale në një masë që kërkon masa urgjente dhe radikale. Ne nuk konsiderojmë se kështu është rasti në Kosovë; Ø ku mjetet tashmë ekzistuese (procedurat disiplinore, deklaratimet e pasurisë, vlerësimi, trajnimi gjyqësor) tashmë janë shfrytëzuar plotësisht; Ø do të jetë përçarës për sistemin e drejtësisë për një kohë të konsiderueshme dhe duhet të përdoret me kujdes.</p>		
EU	Koment i përgjithshëm			<p>Sa u përket kontrolleve të propozuara të integritetit, Strategjia nuk arrin të përshkruajë qartë parimet themelore, të cilat do të drejtojnë këtë proces dhe tiparet e tij kryesore. Ne këshillojmë që Strategjia të përshkruajë qartë këto parime dhe procedura. Në veçanti, fusha e kontrolleve dhe përbërja/struktura e njësisë së specializuar që do t'i kryejë ato duhet të përcaktohet. Për më tepër, Strategjia duhet gjithashtu të përcaktojë qartë ndërhyrjet legislative të nevojshme për të kryer siç duhet këtë proces.</p>	Pranohet pjesërisht	Shih komentën paraprak.

EU	Koment i pergjithshem			<p>Ndërsa Strategjia përmend një numër ndërhyrjesh legislative për të adresuar gjetje dhe sfida të caktuara, është e vështirë të ekzistojë një pasqyrë e qartë e legjislacionit që do të miratohet/ndryshohet bazuar në Strategji. Ne sugjerojmë që drafti i Strategjisë të përfshijë të gjithë legjislacionin që do të duhet të ndryshohet/miratohet për të arritur objektivat përkatëse (ndoshta si një Shtojcë). Ju lutemi merrni në konsideratë me këtë rast edhe referencën për draftin e Kodit Civil. Për më tepër, duke pasur parasysh që një numër ligjesh të referuara në draft Strategji janë tashmë në një fazë të përparuar të hartimit (Kodi i Procedurës Penale, Ligji për SHSK-në, Ligji për SHKK-në, etj.), Do të ishte e dobishme të përcaktohet qartë faza e secilës prej nismave legislative. Strategjia përfshin dispozita mbi projektligjet që janë tashmë shumë përpara. Në këto pjesë, Strategjia duhet të jetë më kreative/inovative / t'i referohet faktit se MD-ja tashmë po zbaton masat, dhe i përgjigjet kësaj. Për më tepër, ne rekomandojmë që Strategjia të përmendë se legjislacioni i tillë do t'i nënshtrohet, kur është e zbatueshme dhe e</p>	Pranohet pjesërisht	Edhe pse ligjet tjera janë të avancuara, ato nuk janë miratuar ende nga Qeveria, andaj duhet të jenë në Strategji për tu siguruar miratimi dhe zbatimi i tyre. Lista e ligjeve është e panevojshme të theksohet në Strategji, ngase ajo reflektohet në Programin Legjislativ dhe do të ndryshoj rregullisht edhe në përputhje me analizat e Koncept Dokumenteve të parapara për tema të caktuara. Nuk pranohet komenti sa i përket Komisionit të Venecias ngase ajo është procedurë ad hoc, dhe varet nga vullneti i Qeverisë në bashkëpunim me hisedarët tjerë se kur e shohin të nevojshme ta dërgojnë një projektligj për
----	-----------------------	--	--	--	---------------------	--

				nevojshme, shqyrtimit të Komisionit të Venecias para miratimit të tij.		shqyrtim atje, dhe si e tillë nuk ka nevojë të jetë në plan të verpimit.
EU	Koment i pergjithshem			Ju lutemi merrni parasysh futjen e nevojës për konsolidimin e legjislacionit (kompleks) si objektiv i përgjithshëm nën prioritetin e duhur.	Refuzohet	Pajtohemi që konsolidimi i legjislacionit është i rëndësishëm esenciale. Mirëpo konsolidimi parashihet të rregullohet me Projektligjin për Aktet Juridike të koordinuar nga ZKM. Në këtë drejtim, deri në miratimin e atij Ligji, që nuk mund të paragjykohej, MD do

						të shqyrtojë mundësitë gjatë vitit 2022, se si të adresohet kjo çështje për legjislacionin në fushëveprimin e MD-së, gjatë rishikimit vjetor të PV.
	Koment i përgjithshëm			Strategjia duhet të pranojë rëndësinë e kapacitetit menaxherial dhe të llogaridhënies në zbatimin e ligjeve brenda institucioneve përkatëse. Menaxherët në institucione të ndryshme duhet të aftësohen që të jenë në gjendje të përmbushin këto sfida në punën e tyre të përditshme. Përgjegjësia menaxheriale, kur zbatohet në mënyrë korrekte dhe të fuqishme, do të funksionojë për rezultate më të mira në të gjithë sistemin. Për të siguruar aftësinë për të menaxhuar siç duhet menaxherët duhet të aftësohen për ta bërë këtë. Duhet të sigurohen burimet për trajnim, trajnim gjatë shërbimit etj. Kapacitetet menaxheriale në secilin prej institucioneve duhet të mbështeten me trajnime për të ditur se çfarë dhe si të bëjnë dhe çfarë	Refuzohet	Janë të parapara në PV aktivitetet për Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët tanimë (p.sh. në Kapitullin 1.1, 1.2, 1.4 dhe II.2

				<p>saktësisht pritet prej tyre. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, shteti përmes përfaqësuesve të zgjedhur politikisht të popullit, duhet të kujdeset për alokimin e burimeve të mjaftueshme për aktorët brenda sundimit të ligjit.</p> <p>Nevojat e institucioneve duhet të identifikohen në mënyrë profesionale dhe gjithëpërfshirëse.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

EU	Koment i pergjithshem			<p>Konfiskimi është kryesisht i pa adresuar në këtë strategji. I vetmi veprim i parashikuar është "Ndryshimi i legjislacionit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të jashtëligjshme në mënyrë që një përqindje e caktuar e të ardhurave të konfiskimit tu alokohet agjencive të sektorit të drejtësisë", gjë që lë të kuptohet për krijimin e një fondi konfiskimi pa paraparë ndonjë masë të besueshme për këtë qëllim. Sipas mendimit tonë, Strategjia duhet të kishte adresuar si vijon:</p> <p>o Mungesa për një kohë të gjatë e zbatimit të ligjeve ekzistuese, përkatësisht dispozitave përkatëse në KPP dhe Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit (qëllimi: përmirësimi i numrit/shumës së pasurive të konfiskuara që është shumë i ulët për momentin). Natyrisht, zbatimi i kornizës ligjore të konfiskimit varet nga një numër faktorësh (p.sh., performanca e prokurorëve në hetim dhe procedurat gjyqësore, vetëdijesimi i gjyqtarëve, integriteti i PK-së dhe institucioneve të tjera të tilla si për shembull Agjencia Kadastrale dhe</p>	Pranohet plotësisht	<p>Koncepti Dokumenti për fondin e konfiskimit do të analizojë tutje problematikën e pjesës së konfiskimit. Ky Koncept Dokument është pjesë e Planit të Veprimit, ndërsa pas konsultimit janë shtuar edhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve në këtë drejtim.</p>
----	-----------------------	--	--	---	---------------------	---

				<p>bankat).</p> <p>Plani i veprimit mund të kishte specifikuar më mirë veprimet për t'u ndërmarrë në këtë drejtim. Për shembull, duke parashikuar trajnime të dedikuara për prokurorë dhe gjyqtarë ose duke përfshirë konfiskimin në mesin e treguesve të performancës së prokurorëve.</p> <p>o Krijimi i fondit të konfiskimit për të vendosur se si të përdoren pasuritë dhe paratë e konfiskuara (ne pajtohem me rezervimin e disa prej tyre tek "agjencitë e sektorit të drejtësisë", por është e qartë që kjo kërkon shumë më shumë mendime dhe planifikim);</p> <p>o Analiza e problemeve që ndikojnë në menaxhimin e pasurive të konfiskuara nga AAPSK (ka shumë) dhe zgjidhje dhe veprime të propozuara.</p>		
EU	Koment i përgjithshëm			<p>Strategjia gjithashtu duhet të adresojë fenomenet e pastrimit të parave, duke e harmonizuar atë me strategjitë ekzistuese të pastrimit të parave. Ndërsa Rishikimi synon të adresojë çështje që ndikojnë në funksionimin e sektorit të sundimit të ligjit, duke njohur korrupsionin e</p>	Refuzohet	<p>Tanimë ekziston Plani i Veprimit në fuqi i NJIF, i miratuar nga Qeveria me datë 24/12/2020 me Vendimin Nr. 05/52. Strategjia e Sundimit të Ligjit do të veprojë</p>

				nivelet të lartë si problem (siç pasqyrohet në raportet e Vendeve të BE-së dhe dokumente tjera ndërkombëtare), Strategjia nuk adreson pastrimin e parave si mjet për të frenuar përdorimin e të ardhurave nga korrupsioni. Korrupsioni dhe pastrimi i parave janë dy anët e medaljes që ndodhin zakonisht së bashku.		krahas këtij Plani të Veprimit.
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 1 - Hyrje	Në këtë drejtim, bazuar në gjendjen e këtij sektori, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përcaktuar në programin e saj...	Ne këshillojmë që Strategjia të mos u referohet programeve të qeverisë pasi këto zakonisht nuk janë për të gjithë periudhën e strategjisë. Më mirë nëse do t'i referohej SKZh-së, por meqenëse kjo nuk është ende në fuqi, ne e konsiderojmë më të përshtatshme t'i referohemi Kushtetutës dhe të heqim referenca të tilla politike afatshkurtra.	Refuzohet	Programi i Qeverisë është baza kryesore për çdo reformë. Referenca në Kushtetutë tanimë ekziston (paragrafi i parë i Kapitullit 1 - Hyrja).
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 1 - Hyrjenë veçanti krimi dhe korrupsioni, zhvillimi ekonomik dhe përparimi i procesit të integritetit evropian, përkatësisht zbatimi i MSA-së....	Ju lutemi merrni parasysh edhe këtu referencën për barazinë gjinore. Gjithashtu, ju lutemi sigurohuni që kurdoherë që i referohet shoqërisë civile brenda Strategjisë (dhe Planit të Veprimit), të përfshihen gjithashtu referenca për organizatat që punojnë për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore.	Pranohet plotësisht	Është pranuar dhe ndryshimi është reflektuar në tekst

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 2 - Metodologjia	Kështu, janë mbajtur më shumë se 45 punëtori dhe takime publike, me më shumë se 1.000 pjesëmarrës nga qeveria, gjyqësori, donatorët dhe shoqëria civile.	Sipas Ligjit për Barazinë Gjinore, duhet të synohet që gratë dhe burrat të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procesin e hartimit të politikave. Ne do të këshillojmë të jepem të dhëna në lidhje me pjesëmarrësit e ndarë sipas gjinisë (sa burra dhe sa gra morën pjesë në procesin e konsultimit?)	Pranohet plotësisht	Të dhënat janë ofruar në verzionin final të Strategjisë.
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 2 - Metodologjia	Institucionet e përfshira në faza të ndryshme të këtij procesi janë: [...], Përfaqësuesit e Zyrës së BE-së dhe USAID-it,	EULEX-i duhet të shtohet në listën e institucioneve të përfshira në proces.	Pranohet plotësisht	Është pranuar dhe ndryshimi është reflektuar në tekst
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 2 - Metodologjia		Çuditërisht sipas këtij kapitulli, Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës nuk janë përfshirë në përgatitjen e kësaj Strategjie dhe Plani të Veprimit, megjithëse strategjia dhe plani i veprimit përfshijnë disa objektiva dhe veprime për përmirësimin e ekzekutimit të sanksioneve penale. Kjo	Pranohet plotësisht	Është pranuar dhe ndryshimi është reflektuar në tekst

				mund të zvogëlojë entuziazmin e tyre në zbatimin e tyre pasi ata nuk ndiejnë “pronësi” mbi veprimet e planifikuara.		
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3 - Sfondi		Seksioni i historikut duhet të përfshijë faktin se gratë mbeten të nënpërfaqësuar në sektorin gjyqësor, ⁹ veçanërisht në nivelet e vendimmarrjes. Shihni si referencë Analizën Gjinore të Kosovës të financuar nga BE nga 2018	Pranohet plotësisht	Është pranuar dhe ndryshimi është reflektuar në tekst
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3 - Sfondi	Këto të dhëna janë krahasuar kundrejt standardeve ndërkombëtare dhe evropiane të sektorit të sundimit të ligjit, kryesisht ato të Këshillit Evropian dhe BE-së....	Ne besojmë se keni synuar t'i referoheni Këshillit të Evropës, në vend të Këshillit Evropian. (komenti ka kuptim vetëm në gjuhë angleze)	Pranohet plotësisht	Është pranuar dhe ndryshimi është reflektuar në tekst

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 3 - Sfondi	Ato përfshijnë shkeljen e të drejtave të njeriut dhe pengimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror,....	Ju lutemi përfshini këtu edhe referencën për investimet, përfshirë ato të huaja.	Pranohet plotësisht	Është pranuar dhe ndryshimi është reflektuar në tekst
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 3.1	Për funksionimin e duhur të gjyqësorit, duhet të ekzistojnë katër elementë kryesorë: efikasiteti, profesionalizmi, llogaridhënia dhe integriteti.	Pavarësia e gjyqësorit dhe prokurorisë duhet të referohen edhe këtu. Përmendet në pjesë tjera të dokumentit	Pranohet plotësisht	Është pranuar dhe ndryshimi është reflektuar në tekst
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 3.1	Për gjyqtarët dhe prokurorët, për monitorimin e efikasitetit, zbatohet 'norma e orientuar' dhe Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Lëndëve (SMIL) po funksionon gjithashtu për disa vjet	Ju lutemi mbani në mend se SMIL ende nuk është plotësisht funksional në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë (apeli është ende në zbatim). Si një sistem menaxhimi, ai nuk është ende funksional për shkak të faktit se tiparet / njoftimet statistikore janë ende në zhvillim	Pranohet plotësisht	Është prezantuar si sfidë që vazhdon.

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 3.1	Megjithëse objektivi i të gjitha këtyre reformave ka qenë zvogëlimi i numrit të lëndëve të vjetra të pazgjdhura në gjykata...	Është e dobishme të përcaktohet koncepti 'lëndët e vjetra të pazgjdhura' për qëllimet e kësaj strategjie. A po flasim për lëndët më të vjetra se 2 vjet, apo për të gjitha lëndët (ngarkesa e punës) brenda gjykatave?	Pranohet plotësisht	Është sqaruar.
----	-----------------------	---------------	---	--	---------------------	----------------

	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1	Faktori i tretë, është përdorimi i ulët i mundësive të ZAK-së.	Do të ishte mjaft e rëndësishme të merret parasysh edhe roli i trajtimit jashtëgjyqësor të ofruar nga Avokati i Popullit. Nuk është një ZAK i tillë, por duke nxitur besimin e qytetarëve në institucion, gjykatat mund të marrin më pak ankesa, dhe qytetarët mund të shmangin procedurat e shtrenjta dhe të gjata dhe të kenë një zgjidhje më të shpejtë për të drejtën e tyre e cila është shkelur.	Pranohet plotësisht	<p>Kjo është marr parasysh dhe është diskutuar me IAP. Në "Strategjinë e IAP 2021-2025 dhe Planin e Zbatimit të Strategjisë së IAP 2021-2023", ekzistojnë aktivitete specifike që synojnë arritjen e objektivës 2.1 që theksohet aty: Vetëdijesimi i publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i konceptit për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe informimin për rolin dhe rëndësinë e IAP-së • Hartimi i planit vjetor të aktiviteteve për promovimin dhe edukimin në fushën e të drejtave të njeriut • Hartimi i programit për promovimin dhe edukimin në fushën e
--	-----------------------	---------------	--	--	---------------------	---

						<p>të drejtave të njeriut</p> <ul style="list-style-type: none">• Organizimi i fushatave të vetëdijesimit për mandatin e IAP-së dhe aktivitetet e institucionit• Fushata të vetëdijesimit lidhur me mandatin e institucionit për trajtimin e ankesave për shkelje të të drejtave të fëmijës• Publikimi i buletinit për të drejtat e njeriut dhe për punën e IAP-së• Publikimi i video-spotëve për promovimin e të drejtave të njeriut
--	--	--	--	--	--	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1	Kjo shihet më së miri në aspektin e drejtësisë komerciale, ku të dy departamentet, përkatësisht Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike në Gjykatën Themelore në Prishtinë...	Këto departamente gjithashtu merren me drejtësi administrative. Ky paragraf nuk është i plotë pa trajtuar gjithashtu çështjen e drejtësisë administrative, veçanërisht pasi është theksuar më lart se kohëzgjatja e lëndëve civile dhe administrative është veçanërisht problematike	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1	Kjo vlen edhe për ligjin civil, veçanërisht për legjislacionin për të drejtën e pronës.	Ju lutemi shtoni në fund të fjalisë "gjithashtu mbi ligjin e familjes dhe trashëgimisë në fuqi"	Refuzohet	Nuk ka problem të konsolidimit në këto dy ligje.
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1	Ata duhet të ndjekin trajnime të vazhdueshme, vetëm në rastet kur ata kanë vlerësim të performancës së ulët.	Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të marrin pjesë vazhdimisht në trajnime çdo vit. Pra, jo vetëm në rastin e vlerësimit të performancës së ulët. KGJK tashmë ka një rregullore, e cila obligon për trajnime të detyrueshme për gjyqtarët. Staf i ndihmës gjithashtu duhet të	Pranohet plotësisht	Ky është konstatim, që është tanimë i reflektuar në Planin e Veprimit.

				<p>trajnohet. Gjithashtu, trajnimi duhet të jetë më praktik dhe më pak teorik.</p>		
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 3.1	Trajnimet e specializuara për ta janë të rralla.	<p>Komuniteti ndërkombëtar/donatorët i kanë ofruar policisë trajnime të bollshme të specializuara. Problematike është zbatimi i ngadaltë i njohurive të reja të fituara dhe gjithashtu metoda më klasike e ofrimit të trajnimit. Trajnimi duket se varet kryesisht nga vullneti i tyre. Ekspertët e BE-së kanë rekomanduar trajnime të përbashkëta praktike dhe trajnime të tipit të studimit të rasteve për gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit. Ata gjithashtu kanë rekomanduar krijimin e një grupi pune për të parë lidhjen e bazave të të dhënave të agjencive të ndryshme të zbatimit të ligjit</p>	Pranohet plotësisht	

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1		<p>Policia e Kosovës inspektohet dhe hetohet nga Inspektorati Policor i Kosovës megjithatë, nuk ka kompetencë të vërtetë për ta detyruar Policinë e Kosovës të zbatojë rekomandimet. Duke qenë se organizatat janë brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme mund të argumentohet se Ministri mund të ngurrojë të shtyjë rekomandimet e bëra kundër Policisë. Mund të jetë e dobishme për Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Policor të Kosovës nëse Policia do të mbahej përgjegjëse në lidhje me rekomandimet e bëra nga IPKja dhe të jepte arsyetim pse rekomandimet nuk zbatohen. Kjo do të sigurojë një vëzhgim dhe përgjegjësi më të madhe për punën policore në Kosovë, dhe gjithashtu, do të rrisë besimin e publikut.</p>	Refuzohet	Nuk është analizuar mjaftueshëm ky veprim, do të shqyrtohet për vitet e ardhshme.
----	-----------------------	---------------	--	---	-----------	---

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1	Sistemi aktual në shumicën e rasteve prodhon vlerësime të larta, gjë që nuk është në përputhje me vonesat dhe shkeljet e dukshme që ndodhin gjatë administrimit të drejtësisë.	Është e vështirë të arrihet një sistem efektiv i vlerësimit të performancës dhe të zbatohet në të vërtetë. Kjo do të duket se është në përputhje me KGJK-në, KPK-në dhe Policinë e Kosovës. Strategjia thekson llogaridhënien e pamjaftueshme brenda sistemit gjyqësor si një arsye kryesore për uljen e motivimit për efikasitet në punë. Një nga faktorët kryesorë që shprehet është vlerësimi joadekuat i performancës me vlerësime të larta që nuk janë në përputhje me vonesat e dukshme të gjata në trajtimin e lëndëve gjyqësore. Vlerësimi më i fortë i performancës në vetvete nuk do të korigjojë këtë çështje, duhet të përfshihet një mekanizëm i fuqishëm i përgjegjësisë, ku gjyqtarët, prokurorët dhe policia japin llogari. Mekanizmat efektivë të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies janë thelbësore për zhvillimin e performancës.	Refuzohe t	Mekanizmat janë të paraparë dhe ka aktivitetet për të l fuqizuar ato (Shih Kapitullin 1.1, 1.3 dhe 2.2)
----	-----------------------	---------------	--	--	------------	---

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1		Dokumenti përmend vlerësimet e performancës dhe transparencën e ulët si faktorët kryesorë për të kontribuar në mungesën e përgjegjësisë. Sidoqoftë, a do të ishte me vlerë të eksplorohej edhe ndikimi i procedurave disiplinore në përgjegjësi?	Pranohet plotësisht	Në sfond është cekur se Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore është i ri dhe në proces të plotësim-ndryshimit, andaj mungojnë të dhëna për zbatimin e tij.
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1	Kjo do të thotë që disa gjyqtarëve dhe prokurorëve u mungon integriteti, gjë që nga ana tjetër potencialisht ndikon në vendimet e tyre.	Ky është një nga shembujt e gjuhës përfundimtare të përdorur në Strategji, të cilin ne e ngremë edhe në vërejtjet tona të përgjithshme. Deklarata të tilla duhet të përpunohen më tej, duke përfshirë referenca specifike që çojnë në përfundime të tilla.	Pranohet plotësisht	Është riformulohet kjo pjesë e tekstit dhe në sfond është bërë ndërlidhja me dokumentin e politikës të publikuar.

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1	Për më tepër, ka mungesë të një sistemi të duhur të vetingut.	Kjo fjali e veçantë në versionin shqip të draft strategjisë thotë se "... ka mungesë të sistemit të duhur të kontrolleve të integritetit (vetingut)". Në këtë drejtim duhet të përdoret terminologjia e duhur në Strategji, për të shmangur çdo keqkuptim. "Veting" i referohet një rivlerësimi të plotë të njëhershëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve si në Shqipëri; "Kontrollet e integritetit" duket se është termi i duhur për procesin e parashikuar në Strategji.	Pranohet pjesërisht	Termi është i sqaruar brenda në dokumentin e politikave që sjellë këto rekomandime. Aktivitetet që janë përfshirë në Strategji nuk e japin përgjigjen finale për modalitetet e vetingut, por bën thirrje që të dizajnohet një sistem për verifikim të vazhdueshëm dhe të rregullt të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe stafit mbështetës. Aktivitetet specifike do të vendosen në Plan të Veprimit në përputhje me Koncept Dokumentin që është duke u zhvilluar për vetingun në sistemin e drejtësisë.
----	-----------------------	---------------	---	--	---------------------	---

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.1	Integriteti i policisë është gjithashtu i rëndësishëm për funksionimin e sistemit.	<p>Ndryshimi në Ligjin për Policinë për të lejuar standardet profesionale për të kryer teste të integritetit tek zyrtarët e policisë është i rëndësishëm. Është e përshtatshme dhe me të vërtetë detyrim profesional mbi shërbimin policor të kryejë teste integriteti dhe kjo duhet të drejtohet nga inteligjenca. Nëse del në dritë një informacion i besueshëm se një oficer policie është i përfshirë në sjellje kriminale ose diskredituese, i takon shërbimit policor të kryejë test integriteti dhe duhet të përdoren opsione të tilla si operacionet e fshehta dhe blerjet e provave.</p> <p>Në lidhje me sinjalizimin, është e domosdoshme që trajtuesit e trajnuar brenda standardeve profesionale të trajtojnë ose të merren me sinjalizuesit, pasi kjo është e ngjashme me trajtimin e informatorit dhe duhet të trajtohet si</p>	Pranohet plotësisht	
----	-----------------------	---------------	--	---	---------------------	--

				<p>e tillë. Dështimi për ta bërë këtë do të jetë në kundërshtim me KEDNJ-në dhe në veçanti mund të përbëjë shkelje të Nenit 2 të KEDNJ-së.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.2		<p>Një çështje që duket se mungon në Strategji ka të bëjë me ekzekutimin e sanksioneve për të pandehurit pa aftësi mendore. Për shkak të kapacitetit të kufizuar në institucionet e kujdesit shëndetësor për trajtimin e autorëve me çrregullime mendore, këta përfundojnë në burgje të rregullta, me rezultatin që ata nuk marrin trajtim adekuat dhe mund të paraqesin një kërcënim të mundshëm për veten, të burgosurit e tjerë dhe stafin e burgut. Kjo çështje, e cila është ngritur ndër të tjera edhe nga Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës, duhet të adresohet si pjesë e kësaj strategjie.</p>	Pranohet pjesërisht	Kjo çështje do të adresohet gjatë rishikimit të Planit të Veprimit.
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.3		<p>Duke qenë se grupet e marginalizuara dhe të prekshme shpesh vuajnë nga qasja e rënduar në drejtësi, rekomandohet që edhe në hyrje të ketë një referencë</p>	Pranohet plotësisht	

				për ato grupe.		
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 3.3	Individëve duhet t'u jepet qasje adekuate në to, ...	Kjo duhet të riformulohet: "Të gjithë individët, përfshirë ata nga grupet e marginalizuara dhe të prekshme,".	Pranohet plotësisht	

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 3.3	Së pari, mbetet sfiduese për grupet më të cenuara në shoqëri, të tilla si gratë, fëmijët, të moshuarit, komuniteti LGBTI dhe komunitetet e pakicave etnike.	<p>Brenda këtij përkufizimi të grupeve më të cenueshme, personat me aftësi të kufizuara, një nga grupet e cenueshme të shoqërisë kosovare, nuk janë të listuar.</p> <p>Shumë pengesa i parandalojnë personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në drejtësi në bazë të barabartë me të tjerët, duke filluar nga qasja fizike në mjediset e drejtësisë, pengesat në qasjen e ndihmës ligjore dhe përfaqësimit ose mungesa e informacionit. Përshtypja e përgjithshme është se Strategjia nuk merr në konsideratë një qasje të përshtatur për grupet në nevojë dhe as nuk ofron propozime specifike në planin e veprimit.</p> <p>Për më tepër, duket se ka mungesë harmonizimi ndërmjet draftit të strategjisë dhe planit të veprimit. Shumica e aktiviteteve të parapara në planin e veprimit kanë të bëjnë me dhunën e bazuar në gjini, dhunën në familje dhe për LGBTI, duke lënë</p>	Pranohet plotësisht	
----	-----------------------	---------------	---	--	---------------------	--

				<p>mënjë të gjitha grupet tjera të cenueshme. Prandaj, veprime specifike duhet të parashihen për grupe tjera të prekshme, siç janë fëmijët, të moshuarit, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe pakicat etnike. E njëjta gjë vlen edhe për drejtësinë për të mitur, e cila po ashtu mungon në planin e veprimit.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.3	Kjo është rezultat i mungesës së mjeteve financiare, informacionit, statusit shoqëror dhe nivelit të ulët të besimit në sistem.	Infrastruktura dhe qasja fizike në institucionet gjyqësore është gjithashtu pjesë e së drejtës për të pasur qasje në drejtësi dhe duhet të përmendet këtu.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.3	Dhuna në familje mbetet në nivele të larta, dhe administrimi i drejtësisë në këtë drejtim nuk është ende në nivel të kënaqshëm.	Për shkak të, ndër të tjera, besimit të ulët në institucione dhe stigmës së përhapur, dhuna në familje mbetet shumë e nënraportuar.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.3	Drejtësia administrative është çështje me prioritet.	Pajtohemi që drejtësia administrative duhet të jetë prioritet në mënyrë që qytetarët të mbajnë administratën publike llogaridhënëse dhe të përdorin të drejtën e tyre për drejtësi. Sidoqoftë, përveç kësaj fjalie, drejtësia administrative nuk është përfshirë në Strategji dhe as në Planin e Veprimit.	Pranohet plotësisht	Është futur aktiviteti i ri për miratimin e Ligjit për Konfliktet Administrative, krahas masave të tjera që kërkojnë analizë për nevojat në lidhje me këtë fushë të së drejtës.

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.3	Së fundmi, sa u përket mjeteve juridike, vlen të përmendet se palëve u mungon një mjet juridik efektiv për të shpejtuar procedurat në rastet e vonesave të konsiderueshme në zgjidhjen e lëndëve të tyre...	Qasja në drejtësi dhe mjetet juridike efektive kanë të bëjnë gjithashtu me zvogëlimin e numrit të lëndëve të vjetra të pazgjidhura të sistemit gjyqësor. Pra, jo vetëm kompensimi për vonesat në zgjidhjen e lëndëve është i rëndësishëm, por edhe trajtimi i shkakut të këtyre vonesave në mënyrë që të zvogëlohen numrat e lëndëve të pazgjidhura.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.3	MD është institucioni kryesor politikëbërës në fushën e sektorit të sundimit të ligjit.	Është e rëndësishme që kjo pjesë të pranojë rëndësinë e angazhimit të duhur të aktorëve tjerë, përfshirë KGJK-në dhe KPK-në në hartimin e politikave në fushën e sundimit të ligjit. Duhet gjithashtu të merret parasysh që të dyja, KGJK-ja dhe KPK-ja të miratojnë dhe zbatojnë aktet nënligjore, zhvillojnë politika, mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit primar në lidhje me gjyqësorin dhe prokurorinë.	Pranohet plotësisht	

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 3.3	Së pari, qasja strategjike është e fragmentuar nga planet specifike strategjike, kundrejt një strategjie gjithëpërfshirëse, dhe kompetencat e MD-së nuk janë të plota, mungojnë ato për ndihmë juridike falas, mbështetjen e viktimave dhe dëshmitarëve, dhe të tjera.	Përkrahja e viktimave dhe dëshmitarëve është gjatë gjithë procedurës penale, kryesisht përgjegjësi e prokurorisë.	Pranohet plotësisht	Është rregulluar në tekst
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 3.3	Për më tepër, MD-ja nuk monitoron rregullisht, për nevojat e saj, punën dhe funksionimin e gjyqësorit...	Ne do të këshillojmë për kujdes në terminologjinë këtu. Nuk është kompetencë e MD-së të monitorojë punën e gjyqësorit.	Pranohet plotësisht	Është riformuluar teksti.

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 3.3	Kapacitetet e departamenteve kryesore janë të kufizuara, veçanërisht në aspektin e njohjes së detyrimeve që lindin gjatë procesit të anëtarësimit në BE dhe lobimit në këtë proces, në fushën e drejtësisë.	Duhet të bëhet një referencë specifike në promovimin e pjesëmarrjes së grave në sektorin e drejtësisë. Prandaj, sugjerohet të futet një paragraf vijues këtu: Strategjia duhet të qëndrojë në parimin themelor të sigurimit të përfaqësimit të barabartë të grave në vendimmarrje në të gjitha nivelet në sistemin e drejtësisë si mënyra e vetme për të arritur në mënyrë efektive barazinë gjinore brenda sektorit të Sundimit të Ligjit. Strategjia gjithashtu duhet të bëjë thirrje për promovimin e pjesëmarrjes së grave në sektorin e drejtësisë në përputhje me nenin 6 të Ligjit të Kosovës për Barazinë Gjinore	Pranohet plotësisht	
----	-----------------------	---------------	---	---	---------------------	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4	Siç u diskutua më lart, ky besim është gjetur të jetë zbehur si rezultat i sfidave ndaj përgjegjësisë, efikasitetit, profesionalizmit dhe integritetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial,...	Pavarësia e gjyqësorit dhe prokurorisë duhet të përfshihet këtu po ashtu.	Pranohet plotësisht	
----	--------------------------	-------------	---	---	------------------------	--

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.1		<p>Digjitalizimi i sektorit të sundimit të ligjit duhet të pasqyrohet gjithashtu këtu,</p> <p>pasi një nga objektivat e digjitalizimit është rritja e efikasitetit. Prandaj, një tekst konkret shtesë mund të shtohet nën objektivin "Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial" si paragraf i veçantë.</p> <p>“Në mënyrë që të rritet efikasiteti i të gjithë sektorit të sundimit të ligjit do të investohen përpjekje të mëtejshme në digjitalizimin dhe përdorimin e teknologjisë moderne në sektor. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndërveprimit ndërmjet sistemeve të ndryshme të TI-së, futja e komunikimit elektronik ndërmjet gjykatave dhe përdoruesve të gjykatave, krijimi i dosjeve digjitale dhe prokuroriale dhe arkivit, si dhe qasja e qytetarëve në shërbime të ndryshme elektronike (të tilla si vërtetimi i pronësisë, vërtetimi i pandëshkueshmërie, vërtetimi se nuk po zhvillohet procedurë penale).”</p>	Pranohet plotësisht	Është cekur në tekst, por jo në titullin e objektivit.
----	-----------------------	---------------	--	---	---------------------	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.1	Ndërkohë, objektivi për ndërtimin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit ndihmës synohet të arrihet përmes ndërhyrjeve të synuara në reformimin e sistemit të rekrutimit, ngritjes në detyrë, verifikimit dhe vetingut.	Duhet të jepet përkufizimi i duhur i kuptimit të "verifikimit" dhe "vetingut", pasi këto fjalë mund të përfshijnë qasje të ndryshme. Shih gjithashtu pjesën 4.1.4. "Veting" i referohet një rivlerësimi të plotë të njëhershëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve si në Shqipëri dhe nuk duhet të përdoret për procesin e paraparë në Strategji; "Kontrollet e integritetit" është termi i duhur për procesin e parashikuar në Strategji.	Pranohet pjesërisht	Termi është i sqaruar brenda në dokumentin e politikave që sjellë këto rekomandime. Aktivitetet që janë përfshirë në Strategji nuk e japin përgjigjen finale për modalitetet e vetingut, por bën thirrje që të dizajnohet një sistem për verifikim të vazhdueshëm dhe të rregullt të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe stafit mbështetës. Aktivitetet specifike do të vendosen në Plan të Veprimit në përputhje me Koncept Dokumentin që është duke u zhvilluar për vetingun në sistemin e drejtësisë.
----	-----------------------	---------------	---	--	---------------------	---

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.1	Në mënyrë që të lehtësohet ushtrimi më efektiv i mandatit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, planet janë të harmonizohen dispozitat mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke përfshirë elementët thelbësorë që çojnë në shkarkimin e tyre, ...	A nënkupton kjo ndryshime në Kushtetutën e Kosovës, përmes së cilës sigurohen bazat për shkarkime të gjyqtarëve dhe prokurorëve? Apo kjo do të thotë vetëm rregullim i mëtejshëm i procesit të shkarkimit brenda legjislacionit primar dhe sekondar? Kjo duhet të sqarohet.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.1		Ky seksion nuk diskuton procedurat disiplinore. A ka treguar ndonjë analizë që aktualisht nuk është e mundur të vlerësohet ndikimi i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke pasur parasysh që ai ka hyrë në fuqi jo shumë kohë më parë, dhe më shumë kohë duhet për të vlerësuar ndikimin e tij?	Pranohet plotësisht	Është cekur kjo, në përputhje edhe me komentin më lartë për Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore.

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.1	Zgjidhjet e ofruara për të arritur objektivin e rritjes së efikasitetit janë: ..	<p>Përdorimi i duhur i SMIL-it në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë nuk duhet të lihet jashtë këtu si një zgjidhje për rritjen e efikasitetit. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë përmirësimin e analizës së informacionit statistikor të gjeneruar nga SMIL-i, mbi të cilën menaxhmenti mund të marrë vendime të balancuara. Për më tepër, duhet të përmendet edhe përdorimi i vazhdueshëm i sistemit qendror të regjistrimit penal që u siguron gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe qytetarëve të dhëna të besueshme lidhur me dënimet.</p>	Pranohet plotësisht	
----	-----------------------	---------------	--	--	---------------------	--

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.1	Përmes Ligjit për Gjykatën Komerciale, gjykata do të ketë burime dhe menaxhim të dedikuar, gjyqtarë të specializuar në të dy nivelet, procedura të veçanta të menaxhimit të lëndëve, duke çuar kështu në zgjidhjen më të shpejtë dhe më profesionale të lëndëve.	Gjykata komerciale duhet të përdorë SMIL-in si të gjitha gjykatat e tjera dhe të mos hartojë ndonjë procedurë të veçantë për menaxhimin e lëndëve.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.1	Përmes masave për sqarimin e procedurave të brendshme, pritet të përmirësohen procedurat e caktimit të lëndëve, trajtimi i materialeve joaktive dhe në përgjithësi menaxhimi i rrjedhës së lëndëve.	Kjo duhet të referojë gjithashtu vendimin për prioritetet.	Pranohet plotësisht	

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.1	Për më tepër, ndërtimi i një sistemi më të mirë për raportim në KGJK dhe KPK, do të mundësojë mbledhjen më të mirë të të dhënave dhe të dhëna të besueshme dhe, në fund, analiza dhe politika më të mira.	Grumbullimi dhe disponueshmëria e të dhënave të besueshme është tashmë në vazhdim, për shembull përmes SMIL-it. Analizimi i këtyre të dhënave dhe përdorimi i tyre për zhvillimin e duhur të politikave është një hap tjetër i rëndësishëm, i cili kërkon vëmendje të veçantë.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.1		Akreditimi i Institutit të Mjekësisë Ligjore në përputhje me ISO17025: 2017, dhe mirëmbajtja e akreditimeve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë do të ketë ndikim të madh në efikasitetin dhe efektivitetin e prokurorisë publike dhe sistemit gjyqësor. Implementimi i këtij standardi në shërbimin mjekoligjor në Kosovë do të mundësojë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve laboratorike dhe do të sigurojë një sistem të pavarur, të paanshëm dhe	Pranohet pjesërisht	Kjo çështje nuk është analizuar specifikisht në dokumentet e politikave dhe është duke u trajtuar aktualisht ndaras nga MD.

				objektiv, me anë të të cilit laboratorët mund të përfitojnë nga një rishikim i plotë operativ.		
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.1	Objektivi i rritjes së profesionalizmit dhe kompetencës synon të rrisë cilësinë e drejtësisë, duke investuar në kapacitetin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit ndihmës.	Stafi ndihmës duhet të përfshihet me siguri, por gjithashtu duhet të përfshihet një masë specifike, që synon zhvillimin e tyre profesional.	Pranohet plotësisht	

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.1	Brenda kësaj mase, është planifikuar të miratohet një ligj i veçantë për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili do të unifikonte dhe qartësonte dispozitat mbi statusin, instrumentet dhe mundësitë për zhvillimin e karrierës dhe përgjegjësitë specifike të institucioneve ndaj këtyre profesionistëve.	Kjo është mirë në lidhje me LZP pasi gjyqtarët dhe prokurorët janë jashtë fushëveprimit të tij. Sidoqoftë, është e rëndësishme të siguroheni që stafi administrativ i gjykatave nuk është i mbuluar nga ligji i ri (dhe kështu të hiqet nga LZP ku ata aktualisht i përkasin - shih nenin 2 të LZP-së: 3. Nëpunës civil - zyrtari publik brenda Shërbimit Civil i cili kryen detyrën në një pozitë duke filluar nga zyrtari profesional në pozicionin e sekretarit të përgjithshëm në (...) administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë,)	Refuzohet	Ky rekomandim nënkupton ndryshimin e Ligjit për Zyrtarë Publik, që ka qenë pjesë e reformës së administratës publike. Ndryshimi i tij mund të shkojë në kundërshtim me qëllimin e reformës. Sidoqoftë, kjo pjesë nuk ka qenë e analizuar në dokumentet e politikave, andaj si e tillë nuk mund të merret parasysh në këtë fazë.
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.1	Një propozim tjetër përqendrohet në ndërtimin e një sistemi rekrutimi, transferimi dhe avancimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në kompetenca.	Parimet e rekrutimit duhet të jenë pjesë e ligjit të veçantë të mësipërm, në të njëjtën mënyrë dispozitat për rekrutimin dhe zhvillimin e karrierës përfshihen në LZP.	Pranohet plotësisht	Parimet e rekrutimit do të përfshihen në Ligjin e veçantë.

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.1	Sistemi aktual i verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka një listë të gjatë të mangësive, në mesin e të cilave mund të dallojmë performancën e vetingut vetëm në kohën e rekrutimit dhe gamën jashtëzakonisht të ngushtë të informacionit të mbledhur si pjesë e këtij procesi. Prandaj, masa kryesore brenda këtij objektivi specifik planifikon të ndërtojë një sistem të pavarur që siguron kontrolle të vazhdueshme dhe të rregullta të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i njohur ndryshe si	Strategjia dhe Plani i Veprimit i referohen në mënyrë të ndërsjellë "vetingut", verifikimit "dhe" kontrolleve të integritetit". Ne jemi kundër kësaj. Termi "veting" i referohet një ndërhyrjeje të jashtëzakonshme të njëhershme për qëllimin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për shembull siç po ndodh tani në Shqipëri. Sidoqoftë, Strategjia i referohet një procesi të kontrolleve të vazhdueshme të integritetit për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë. Prandaj, termi "veting" nuk duhet të përdoret. Më tej, Strategjia nuk arrin të përshkruajë qartë parimet themelore, të cilat do të drejtojnë këtë proces dhe tiparet e tij kryesore. Ne këshillojmë që Strategjia të përshkruajë qartë këto parime dhe procedura. Në veçanti, fusha e kontrolleve (kufizuar në deklarimin e pasurisë?) dhe përbërja/struktura e njësisë së specializuar që do t'i kryejë	Pranohet pjesërisht	Termi është i sqaruar brenda në dokumentin e politikave që sjellë këto rekomandime. Aktivitetet që janë përfshirë në Strategji nuk e japin përgjigjen finale për modalitetet e vetingut, por bën thirrje që të dizajnohet një sistem për verifikim të vazhdueshëm dhe të rregullt të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe stafit mbështetës. Aktivitetet specifike do të vendosen në Plan të Veprimit në përputhje me Koncept Dokumentin që është duke u zhvilluar për vetingun në sistemin e drejtësisë.
----	-----------------------	---------------	--	---	---------------------	---

			<p>"Veting". Ky sistem do të përfshijë të gjithë spektrin e kontrollit efektiv të integritetit. Në aspektin strukturor, ai planifikon të ndërtojë një njësi të pavarur, të përbërë nga ekspertë të specializuar për hetim dhe veting, të zgjedhur me ekspertizë ndërkombëtare dhe përmes procedurave të veçanta. Në aspektin ligjor, ai do të mundësojë zgjerimin e spektrit të dhënave të mbledhura për kandidatët e vetingut, duke mundësuar kështu mbledhjen e të dhënave jo vetëm</p>	<p>ato duhet të përcaktohet. Për më tepër, Strategjia duhet gjithashtu të përcaktojë qartë ndërhyrjet legislative të nevojshme për të kryer siç duhet këtë proces. BE është e gatshme të ndihmojë autoritetet e Kosovës me masat që duhet të merren për të forcuar llogaridhënien dhe integritetin në sistemin e saj të drejtësisë. Ne konsiderojmë se rezultate të rëndësishme, pozitive mund të arrihen me zbatimin sistematik të mjeteve tashmë ekzistuese dhe futjen e mjeteve të reja, siç është e përshtatshme për të siguruar integritetin, llogaridhënien dhe luftimin e korrupsionit. Në këtë drejtim, Be-ja vlerëson se një veting i plotë nuk është i përshtatshëm për kontekstin në Kosovë (pasi të gjitha kushtet e nevojshme nuk ekzistojnë). Kjo është për një numër arsyesh, duke përfshirë:</p>	
--	--	--	---	--	--

			<p>nga regjistrat publik por edhe informacione tjera financiare dhe shëndetësore për kandidatët. Ai gjithashtu do të garantojë mbrojtjen ligjore të të dhënave të kandidatëve, si dhe mjetet juridike në dispozicion për këtë.</p>	<p>- duhet të konsiderohet vetëm si masë e fundit, masë e jashtëzakonshme kur niveli i korrupsionit dhe ndikimi politik në gjyqësor janë jashtëzakonisht të larta dhe për këtë arsye, kur institucionet përkatëse janë thelbësisht jofunksionale në një masë që kërkon masa urgjente dhe radikale; do të jetë përçarës për sistemin e drejtësisë për një kohë të konsiderueshme dhe duhet të përdoret me kujdes;</p>	
--	--	--	--	--	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.2	Vlerësimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë	Ky objektivi duhet të riformulohet. Ky nuk është objektivi. "Vlerësimi" i problemeve në lidhje me luftën kundër KOK-së duhet të ishte bërë në pjesën e mëparshme të kësaj strategjie nën 3.1. "Drejtësia penale". Bazuar në atë analizë, ky paragraf duhet të përmbajë objektivat specifike.	Pranohet plotësisht	Objektivi është riformuluar
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.2	Integriteti i Policisë së Kosovës	Ky objektivi duhet të riformulohet, pasi i mungon një folje ose një ambicie.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.2	Objektivi që ka të bëjë me vlerësimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë ...	Vlerësimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë nuk është një objektivi për se. Ky paragraf duhet të rëndisë objektivat specifike bazuar në një vlerësim të kryer më parë në strategji, për shembull: trajtimi i ndërhyrjeve politike në gjyqësor, ose forcimi i regjimit të konfiskimit dhe përdorimi shoqëror i pasurive të konfiskuara, ose adresimi i mangësive në zbatimin e këtij apo atij ligji etj.	Pranohet plotësisht	

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.2	Objektivi i veçantë për përmirësimin e profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë synon të luftojë korrupsionin e nivelit të lartë dhe kundër krimit të organizuar përmes zhvillimit profesional dhe gjithashtu të luftojë pastrimin e parave.	Pastrimi i parave është gjithashtu një sfidë serioze. Ne nuk mund ta luftojmë atë vetëm me zhvillim profesional dhe trajnim nëse nuk ka vullnet politik për ta luftuar atë (e njëjta gjë për korrupsionin dhe krimin e organizuar) dhe me ndërhyrjen politike në procedurat gjyqësore. Për më tepër, Strategjisë i mungon adresimi i fenomeneve të pastrimit të parave. Ndërsa Rishikimi Funkcional synon të adresojë çështje që ndikojnë në funksionimin e sektorit të sundimit të ligjit, duke njohur korrupsionin e nivelit të lartë si problem (siç pasqyrohet në raportet e Vendeve të BE-së dhe dokumente tjera ndërkombëtare), Strategjia nuk adreson pastrimin e parave si mjet për të frenuar përdorimin e të ardhurave nga korrupsioni. Korrupsioni dhe pastrimi i parave janë dy anët e medaljes që ndodhin zakonisht së bashku. Ne gjithashtu sugjerojmë përafrimin me strategjitë ekzistuese	Refuzohe t	Masat janë paraparë në Planin e Veprimit të NJIF, të miratuar nga Qeveria në vitin 2020.
----	-----------------------	---------------	---	---	------------	--

				të pastrimit të parave.		
--	--	--	--	----------------------------	--	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.2		<p>Megjithëse të dhënat e përdorura për përgatitjen e strategjisë janë krahasuar me standardet ndërkombëtare dhe evropiane të sektorit të sundimit të ligjit, kjo pjesë në lidhje me korrupsionin nuk arrin të vërejë se cilat standarde ndërkombëtare dhe evropiane synon të arrijë. A janë ato të përfshira në konventat e Këshillit të Evropës, UNCAC apo tjera? Për më tepër, fushëveprimi i objektivit antikorrupsion, përfshirë masat në Planin e Veprimit, duket të jetë shumë i ngushtë në fushën e veprimit.</p>	Refuzohet	<p>Këto të dhëna më detajisht janë sqaruar në Dokumentet e Politikave. Nuk ka më shumë hapësirë për t'i elaboruar ato në narrativ apo në Plan të Veprimit</p>
----	-----------------------	---------------	--	---	-----------	---

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.2	Gjithashtu, aspekti tjetër që paraqet një sfidë ka të bëjë me cilësinë e hetimeve që ndodhin në raste të nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar posaçërisht kur bëhet fjalë për hetimin financiar, i cili kërkon një koordinim më të mirë në mënyrë që pasuritë e fituara në mënyrë të jashtëligjshme të konfiskohen.	Ju lutemi shënoni rëndësinë e udhëheqjes së prokurorëve gjatë hetimeve. Për më tepër, ekziston një neglizhencë e përgjithshme ndaj parimit "ndiqni paratë", i cili është i një rëndësie të madhe në hetimin e pastrimit të parave dhe krimit financiar.	Pranohet plotësisht	
----	-----------------------	---------------	--	--	---------------------	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.2	<p>Rekomandohet gjithashtu të ndryshohet skema aktuale e konfiskimit të pasurive, ku do të ishte e mundur të ndahet një përqindje e caktuar e të ardhurave nga shitja e pasurive të konfiskuara për të mirën e sektorit të drejtësisë penale.</p>	<p>Pjesërisht kjo do të bëhet përmes zbatimit të fuqishëm. Përqindja e veçantë është një motivues, ashtu si edhe numrat e konfiskimeve të përfunduara.</p> <p>Për më tepër, çështjet në lidhje me konfiskimin e pasurive nuk janë elaboruar sa duhet. Gjëja më e rëndësishme do të ishte të fillohet me disa pasuri të konfiskuara që potencialisht mund të ndahen. Ky është problemi kryesor dhe një mënyrë e trajtimit të tij mund të jetë ndarja e një pjese të të ardhurave me sektorin e drejtësisë. Por objektivi kryesor në një strategji të tillë duhet të jetë i qartë.</p>	Refuzohet	<p>Këto elaborime do të adresohen në Koncept Dokumentin për Fondin e Konfiskimit, i cili është pjesë e kësaj Strategjie.</p>
----	-----------------------	---------------	---	--	-----------	--

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.2	Po kështu, në vlerësimin e performancës, rekomandohet që opinionet gjyqësore në një panel të identifikojnë autorin e krimit edhe në rastet kur gjyqtari ka një mendim të kundërt, i cili do t'i mundësonte komisionit të vlerësimit të performancës të vlerësonte në mënyrë adekuate trajnimin profesional të gjyqtarit.	Është e vështirë të kuptohet se çfarë do të thotë kjo. Në dokumentin e politikave nr. 7, fq. 59, ekziston rekomandimi 26 që thotë: "Mendimet gjyqësore të dhëna nga një panel duhet të identifikojnë autorin. Nëse një anëtar i trupit gjykues kundërshton, ose arrin në të njëjtin përfundim, por i mbështetur nga arsyetime të ndryshme ligjore, ai gjyqtar duhet të shkruajë një mendim të veçantë kundërshtues ose pajtues nën emrin e tij/saj."	Pranohet plotësisht	Ky ndryshim tanimë është përfshirë në draft Kodin e Procedurës Penale.
----	-----------------------	---------------	--	--	---------------------	--

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.2	<p>Palët e përfshira në këtë proces fajësojnë njëra-tjetrën, respektivisht gjykatat dhe prokuroria. Prandaj, ky objektivi synon të shikojë në mënyrë specifike aspektet që lidhen me vlerësimin e performancës dhe vlerësimin e fuqisë së gjyqësorit, trajnimin dhe edukimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe shikimin e çështjeve që lidhen me pavarësinë e institucioneve gjyqësore.</p>	<p>Në këtë drejtim duhet të theksohet se shumë raste (të nivelit të lartë) të lidhura me korrupsionin mbështeten tek ekspertët e jashtëm (shpesh financiarë). Gjyqësori mbështetet veçanërisht në ekspertizën e tyre. Shpesh, nuk është e qartë se në ç'masë këta ekspertë me të vërtetë kanë edhe kualifikimet përkatëse për t'u marrë me çështje të veçanta të sfiduara. Çështjet faktike dhe ligjore shpesh përzihen. Roli i ekspertëve (financiarë) duhet të jetë i qartë. Mendimi i një eksperti nuk mund të zëvendësojë zbatimin/interpretimin e ligjit nga Gjykata.</p>	Pranohet plotësisht	Konkluzioni është i saktë por komenti i paqartë, sa i përket nderlidhjes dhe rekomandimit final
----	-----------------------	---------------	--	--	---------------------	---

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.2	Ky trajnim duhet të përfshijë etikën ligjore, pastaj të mbulojë fushën e praktikës së gjyqtarëve dhe prokurorëve për të përmirësuar zhvillimin e karrierës së tyre, si dhe të krijojë hapësirë për zhvillimin e interesit në fusha të reja. Për qëllime të trajnimit, rekomandohet që ADja të zhvillojë programe të përshtatshme për shkrimin ligjor dhe të zhvillojë programe për menaxhim progresiv.	Këto trajnime duhet t'i referohen posaçërisht adresimit të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ndërsa e shohim vlerën e trajnimeve për çështje etike, nuk e shohim kuptimin e parashikimit të trajnimeve për zhvillimin e karrierës në këtë pjesë të Strategjisë.	Pranohet plotësisht	Edhe këto trajnime kanë rëndësi për këtë sektor, por janë bartur në një kapitull tjetër.
----	-----------------------	---------------	--	--	---------------------	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.2		Shqyrtoni mundësinë e përmendjes së përpjekjeve dhe angazhimit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës në zbatimin e policisë së drejtuar nga intelijenca dhe komuniteti si një model pune në të gjithë forcën policore.	Pranohet pjesërisht	Këto përpjekje dhe ky angazhim janë të vlerësuara dhe do të analizohen vitet në vijim mundësitë se si ky aspekt të avancohet tutje.
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.2	Objektivi në lidhje me Integritetin e Policisë së Kosovës përqendrohet në çështje që lidhen me sfidat me të cilat përballet organizata, d.m.th. korrupsioni policor dhe sjelljet e tjera reale dhe të perceptuara kriminale.	Sipas II.4 në planin e veprimit, përfshihet gjithashtu një përmendje e "masave të kontrollit të integritetit" për policinë. Është e paqartë nëse kjo i referohet një sistemi ekzistues të vendosur, ose një sistemi të ri në përputhje me diskutimet në GP të Llogaridhënies. Sa i përket integritetit, PK-ja ka planin e saj të brendshëm të veprimit, i cili de facto i është bashkëngjitur Planit të saj Strategjik të Zhvillimit. Së dyti, në lidhje me Vetëpunimin e Sigurisë kjo rregullohet me Ligjin për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë, ndërsa pozicionet e larta të PK-së kanë qasje në informacionin e klasifikuar siç janë informacioni "KONFIDENCIAL" dhe "SEKRET". Vetëm DP i PK-së ka qasje në informacionin "TOP SECRET".	Pranohet plotësisht	Kjo nënkupton që testimi i integritetit të bëhet edhe nga vet policia, përveç sistemeve verifikuese ekzistuese që ekzistojnë aktualisht.

				<p>Prandaj, veprimi përkatës ka nevojë për fokus shtesë. Përveç kësaj, merrni parasysh shtimin e fajit për viktimat dhe veprimet e oficerëve të policisë ndaj viktimave të dhunës në familje dhe seksuale.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.2	Gjithashtu, Policia e Kosovës, në bashkëpunim me IPK-në, duhet të kryejë inspektime të rregullta dhe auditime të brendshme për të rritur kontrollin dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet brenda vetë institucionit.	Prokuroria në krye të hetimeve, bashkëpunimi me policinë për të siguruar burime të përshtatshme për të ofruar dhe për të siguruar burime, të cilat janë detyrim për Drejtorin e Policisë. Task forcat e krijuara nga politikanët nuk duhet të jenë mjeti kryesor. Mbështetja politike për burimet si për policinë ashtu edhe për prokurorinë është e përshtatshme, por mënyra se si ata e menaxhojnë hetimin i takon prokurorisë për të vendosur nga ana e tyre dhe policisë nga ana operative. Si përfundim, siguroni burimet financiare të identifikuar nga profesionistët e ngarkuar dhe më pas lëreni të kryejnë punën, sipas ligjeve dhe rregulloreve dhe me përgjegjësi të plotë menaxheriale dhe individuale për të dhënë rezultatet.	Pranohet plotësisht	
----	-----------------------	---------------	--	--	---------------------	--

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.2	SHSK-ja do të luante këtë rol duke hartuar raportin parafjalisë ku SHSK-ja do të vlerësonte rëndësinë e një sanksioni alternativ për individin dhe kështu do të rriste besueshmërinë e sanksioneve alternative për prokurorët dhe gjyqtarët.	Shikoni komentin tonë më lart në lidhje me personat e paaftë në aspektin mendor (Problemet në ekzekutimin e sanksioneve penale / fq. 15).	Pranohet plotësisht	Kjo çështje do të adresohet në rishikimin e Planit Vjetor.
----	-----------------------	---------------	--	---	---------------------	--

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.2	<p>Forcimi i kapaciteteve të planifikimit strategjik të SHSK-së dhe SHKK-së;</p> <p>Riorganizimi i infrastrukturës së SHKK-së;</p> <p>Zhvillimi i politikës së burimeve njerëzore të SHKK-së dhe SHSKsë;</p> <p>Vendosja dhe zhvillimi i një vlerësimi të qëndrueshëm të rrezikut dhe nevojave dhe sistemit individual për planifikimin e burgimit për të burgosurit dhe personat në sprovim; Fokusimi në rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve;</p> <p>Zhvillimi i legjislacionit;</p> <p>Zhvillimi i</p>	Shumë e paqartë dhe e pa sqaruar si duhet në Planin e Veprimit.	Refuzohet	Janë të sqaruara në PV - Kapitulli 2.3.
----	-----------------------	---------------	---	---	-----------	---

			Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe mbështetja për përdorimin e sanksioneve dhe masave alternative; si dhe zhvillimin e legjislacionit për Sanksonet dhe Masat e Komunitetit.			
--	--	--	---	--	--	--

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.3	Ndërhyrjet e parapara nën objektivin specifik për forcimin e qasjes në drejtësi për qytetarët synojnë të lehtësojnë qasjen e qytetarëve në gjykata dhe prokurori përmes përmirësimit të garancive ligjore, rritjes së kompetencave dhe rolit të Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet organeve gjyqësore dhe jogjyqësore.	Qasja në drejtësi ka të bëjë gjithashtu me zvogëlimin e numrit të lëndëve të vjetra të pazgjidhura të sistemit gjyqësor. Qasja në drejtësinë administrative varet shumë nga lëndët e vjetra të pazgjidhura. Nëse duhen mbi dy vjet që një vendim administrativ të gjykohet në gjykatë, mund të mos ketë rëndësi nëse në fund është vërtetuar si i drejtë apo jo. Por koha është e rëndësishme kur flasim për qasje në drejtësi.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.3		Strategjia nuk arrin të diskutojë siç duhet dhe në mënyrë të vazhdueshme për drejtësinë administrative.	Pranohet plotësisht	Janë shtuar aktivitete që kanë të bëjnë me drejtësinë administrative në Planin e Veprimit.

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.3	Një seri veprimesh konkrete janë paraparë brenda masës së tretë të këtij objektivi që kanë për qëllim përmirësimin e qasjes në drejtësi për personat dhe grupet në nevojë.	Gjithashtu masat në lidhje me anëtarët e komuniteteve pakicë të Kosovës mund të specifikohen brenda këtij objektivi (p.sh. masat për të rritur numrin e anëtarëve të komuniteteve pakicë në gjyqësor, përkthimi uniform i ligjeve në gjuhët zyrtare). Komenti vlen edhe për Planin e hartuar të Veprimit.	Pranohet pjesërisht	Struktura aktuale i reflekton kërkesat kushtetuese dhe ligjore, dhe kjo merret parasysh në mënyrë të rregullt nga KGJK dhe KPK.
----	-----------------------	---------------	--	---	---------------------	---

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.3	<p>Aktivitetet e propozuara nën këtë masë kanë për qëllim avancimin e kapaciteteve të institucioneve përkatëse për luftimin e dhunës me bazë gjinore, thellimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve gjyqësore dhe jo-gjyqësore për luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe mbështetje më të madhe financiare për strehimoret për viktimat e dhunës me bazë gjinore.</p>	<p>Në mënyrë që të arrihet efikasiteti i drejtësisë në të gjithë sektorët, por veçanërisht në lidhje me qasjen në drejtësi për grupet në nevojë, dhe në përputhje me dispozitat e Konventës së Stambollit, duhet të ketë një kërkesë për të investuar në një sistem të të dhënave me cilësi të lartë, të besueshme, të krahasueshme dhe të ndara sipas gjinisë.</p> <p>Për momentin, kjo nuk po ndodh plotësisht brenda sistemit të drejtësisë në Kosovë. Një sistem efektiv dhe funksional i mbledhjes së të dhënave duhet të forcohet aty ku ai ekziston tashmë, sikur tek rastet e dhunës në familje dhe bazës së të dhënave të dhunës në familje, dhe të krijohet aty ku nuk ekziston (shih për shembull rastet e dhunës seksuale). Fondet duhet të alokohen edhe për këtë drejtim.</p>	Pranohet plotësisht	<p>Janë shtuar aktivitete shtesë për zbatimin e kërkesave që dalin nga Konventa e Stambollit si dhe veçanërisht një aktivitet specifik për mbledhjen konsistente të të dhënave.</p>
----	-----------------------	---------------	---	---	---------------------	---

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.3	Propozon transpozimin e dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në ligjin lokal në Kosovë	Dhuna në familje mund të jetë në të dy strategjitë. Është e rëndësishme që ajo të përfshihet në këtë, sepse Konventa e Stambollit, përveç parashikimit të të drejtave të grave, kërkon përmirësimin e kapaciteteve dhe njohurive nga institucionet gjyqësore dhe të sigurisë, pra, në thelbin e sundimit të ligjit. Ministria e Drejtësisë ka një rol koordinues në luftën kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Prokurori duhet të njihet me ndryshimet në legjislacion dhe mjetet e reja të mundshme në dispozicion. Policia, si reaguesi i parë i raporteve të dhunës në familje, është një nga institucionet kryesore të përfshira në luftimin e fenomeneve, etj	Pranohet pjesërisht	
----	-----------------------	---------------	---	---	---------------------	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.3	Masa e katërt e parashikuar brenda këtij objektivi propozon aktivitete drejt vendosjes së bashkëpunimit efektiv ndërmjet organeve jo-gjyqësore dhe gjykatave dhe prokurorive. Në mënyrë të veçantë, kjo masë adreson rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) dhe është propozuar ndryshimi i ligjit për IAP në mënyrë që t'i jepen këtij të fundit autorizime vendimmarrëse përveç atyre këshilluese.	Avokati i Popullit duhet të konsultohet në detaje për këtë çështje (përveç nëse kjo është bërë tashmë) dhe duhet të ofrohet më shumë qartësi në lidhje me këtë temë, duke përcaktuar qartë fushën e ofrimit IAP-së ndoshta disa kompetenca vendimmarrëse, veçanërisht në lidhje me gjyqësorin dhe funksionimin e gjykatave. Roli i Avokatit të Popullit të Kosovës në lidhje me gjykatat është përcaktuar qartë në Ligjin aktual mbi Avokatin e Popullit dhe kjo dispozitë është në përputhje me praktikën ndërkombëtare, por gjërat mund të shtjellohen më tej gjithashtu.	Pranohet plotësisht	
----	-----------------------	---------------	---	---	---------------------	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.3	Objektivat specifike për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të mjeteve juridike kanë për qëllim promovimin e përmirësimit të garancive ligjore për mbrojtjen gjyqësore në lidhje me arritjen e të drejtave themelore në çështjet penale, civile dhe administrative.	Sistemi qendror i regjistrimit penal që do t'u sigurojë qytetarëve të dhëna të besueshme të dënimit, duhet të përfshihet këtu gjithashtu.	Refuzohet	Kjo është tanimë në Kapitullin 3.5.
----	-----------------------	---------------	---	---	-----------	-------------------------------------

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.3	Kjo do të bëhet përmes Ligjit të ri për Mbrojtjen e të Drejtës për Gjykim brenda një kohe të arsyeshme për të përcaktuar mjetet juridike efektive për rastet që përfshijnë vonesa në procedurat gjyqësore.	Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parashkrimit pasi ajo është një nga pasojat e vonesave në procedurat gjyqësore. Ka raste që arrijnë afatin e parashkrimit për shkak të lëndëve të vjetra të pazgjidhura ose kapacitetit të pamjaftueshëm të stafit të gjykatës. Sidoqoftë, ka raste kur parashkrimi paraqitet për shkak të mungesës së aftësive profesionale ose korrupsionit. Prandaj, mund të krijohet një mekanizëm për të përcaktuar arsyen për të cilën është arritur afati i parashkrimit dhe duhet të jepet dëmshpërblimi i duhur në raste të tilla (p.sh. të ndryshohet legjislacioni në mënyrë që të sanksionohet në mënyrë të përshtatshme prokurori/gjyqtari përgjegjës). Ne jemi të vetëdijshëm se afatet e parashkrimit për ndjekjen penale të çështjeve janë rritur shumë në	Refuzohe t	Komenti është refuzuar, por është ndryshuar gjuha e përdorur tek Objektivat. Pjesa tjetër ndërlidhet me Koncept Dokumentin e paraparë për gjykimin në kohë të arsyeshme.
----	-----------------------	---------------	--	---	------------	--

				Kodin Penal që është aktualisht në fuqi.		
--	--	--	--	---	--	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.3	<p>Ky objektiv strategjik synon t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës që të përfitojnë nga e drejta kushtetuese për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme dhe duke i dhënë mjetet juridike të disponueshme dhe efektive në praktikë. Kjo do të bëhet përmes Ligjit të ri për Mbrojtjen e të Drejtës për Gjykim brenda një kohe të arsyeshme për të përcaktuar mjetet juridike efektive për rastet që përfshijnë vonesa në procedurat gjyqësore. Një ligj i tillë mund të paraqesë, ndër të tjera, të</p>	<p>Si është puna me ligjin për konfliktet administrative? Qytetarët duhet të jenë në gjendje të mbajnë administratën publike përgjegjëse për vendimet arbitrare që prekin të drejtat e tyre. Merrni parasysh shtimin e lejit të Gjykatës Kushtetuese që të japë dhe përcaktojë kompensimin financiar për të shmangur vonesat shtesë në kërkimin e këtij kompensimi në llojet e tjera të procedurave (e ngjashme me praktikën e KEDNJ-së). Ne nuk jemi të sigurt pse në këtë pjesë i referohet vetëm drejtësisë penale.</p>	Pranohet plotësisht	Ligji i ri për Konfliktet Administrative është përfshirë në PV, si dhe aktivitetet tjera relevante për drejtësinë administrative.
----	-----------------------	---------------	--	--	---------------------	---

			<p>drejtën e ankimit në Gjykatën Kushtetuese; e drejta e ankimit në një gjykatë të shkallës më të lartë; futja e mjeteve juridike përshpejtuese dhe kompensuese specifike për drejtësinë penale. Një ligj i tillë do të përfitonte nga mjetet juridike shtesë, të cilat do të rrisnin efektivitetin e mbrojtjes së të drejtave themelore dhe procedurale të qytetarëve.</p>			
--	--	--	---	--	--	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.3	Për më tepër, ky objektivi strategjik synon të promovojë të drejtat dhe liritë e njeriut, duke rritur masat e mbrojtjes ligjore të personave që u nënshtrohen procedurave penale (mbrojtje nga keqtrajtimi, e drejta e qasjes tek një avokat i përcaktuar, e drejta për interpretim dhe përkthim) , në përputhje me standardet evropiane, përfshirë adresimin e një nevoje urgjente për të harmonizuar legjislacionin në fuqi me standardet ndërkombëtare	Është e paqartë pse kjo është një përparësi. Legjislacioni aktual në këtë fushë është në përputhje me acquis-in. Për më tepër, ju lutemi shtoni referencë në fushën e procedurave civile dhe administrative.	Pranohet plotësisht	Është ndryshuar gjuha e përdorur tek Objektivat, në përputhje me komentin.
----	-----------------------	---------------	---	---	---------------------	--

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.3	Objektivi i pestë strategjik synon të rrisë rolin e Ministrisë së Drejtësisë në monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të reformës në drejtësi, duke marrë një rol udhëheqës në koordinimin e të gjitha autoriteteve përkatëse...	Nuk është e qartë se çfarë nënkuptohet këtu me "autoritetet". Me siguri, kjo nuk mund të përfshijë KGJK-në dhe KPKnë. Ky paragraf ka nevojë për shqyrtim të mëtejshëm duke pasur parasysh pavarësinë e gjyqësorit dhe prokurorisë.	Pranohet plotësisht	Teksti është riformuluar.
----	-----------------------	---------------	---	--	---------------------	---------------------------

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.3	Konkretisht, Ministria e Drejtësisë, përmes zbatimit të këtij objekti, do të ketë një rol kryesor në identifikimin e dobësive në funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe adresimin e tyre përmes planifikimit adekuat dhe hartimit të masave të nevojshme për të përmirësuar problemet e paraqitura, drejt ngritjes së pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies, profesionalizmit dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë në Kosovë.	Ky seksion duhet të hartohet me kujdes të duhur. Institucionet kryesore në sigurimin e një sistemi gjyqësor dhe prokurorial të pavarur, të paanshëm, të përgjegjshëm, profesional dhe efikas janë KGJK dhe KPK, prandaj roli i MDsë në këtë drejtim duhet të shtjellohet qartë.	Pranohet plotësisht	Teksti është riformuluar.
----	-----------------------	---------------	---	---	---------------------	---------------------------

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.3	Përmes zbatimit të masave të përcaktuara në këtë objektiv, themelohet Departamenti për Organizimin e Gjyqësorit, me detyrën e përgatitjes së propozimeve ligjore përkatëse në lidhje me organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit. Ministria e Drejtësisë synon të rrisë profesionalizmin dhe specializimin e Departamentit Ligjor në fusha të veçanta si ato penale, civile, administrative, komerciale.	Kjo duhet të konsiderohet në lexim të ngushtë me detyrat e KGJK-së dhe KPKsë në këtë drejtim. Duhet të parandalohet mbivendosja me zhvillimet në institucione të tjera (të pavarura)	Pranohet plotësisht	Në rregull është kjo ngase kompetencat e Departamentit/Divizionit do të parashihen me Rregulloren e brendshme të MD-së dhe nuk cenojnë pavarësinë e KPK-së dhe KGJK-së.
----	-----------------------	---------------	---	--	---------------------	---

EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.3	Më e rëndësishmja, është propozuar të krijohet një Divizion i Analizës dhe Monitorimit Analitik, i cili pritet të sigurojë për Ministrinë të dhëna empirike, të marra nga metoda të shëndosha shkencore, të cilat do ta ndihmojnë atë në politikëbërje më të mira për gjyqësorin si dhe për të gjithë sistemin e drejtësisë.	Do të ishte mirë nëse këto të dhëna ndahen gjithashtu me Këshillat, duke pasur parasysh rolin dhe përgjegjësitë e tyre në zhvillimin e politikave për gjyqësorin dhe prokurorinë.	Pranohet plotësisht	
----	-----------------------	---------------	--	---	---------------------	--

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.4	Më tej, reformat e propozuara me këtë objektiv parashohin krijimin e një mekanizmi koordinimi antikorrupsion në nivelin e Qeverisë, i cili do të zëvendësonte Këshillin Antikorrupsion në nivelin e Presidencës.	Sipas njohurive tona, roli i Këshillit Kombëtar kundër Korrupsionit ishte minimalisht shumë marginal. Është e vështirë të vlerësohet nëse zëvendësimi i tij me një mekanizëm koordinues në nivelin e Qeverisë do të bënte ndonjë ndryshim. Veprimet e parapara në Planin e Veprimit nuk hedhin më shumë dritë mbi këtë çështje (shih komentet në Planin e Veprimit).	Pranohet plotësisht	Është larguar ky aktivitet.
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.4	Përmirësimi i punës së strukturave kryesore në luftën kundër korrupsionit brenda Policisë, Inspektoratit Policor dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës janë masa tjera të parashikuara brenda këtij objekti. Ato synojnë të ndërtojnë kapacitetet e	Kjo nuk i shton shumë asaj që parashihet në pjesë tjera të kësaj strategjie dhe është mjaft e paqartë.	Pranohet plotësisht	Teksti është riformuluar.

			strukturave përkatëse, të forcojnë bazën ligjore dhe operative për funksionimin e tyre dhe të përmirësojnë standardet e integritetit dhe llogaridhënies.			
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 4.4	Gjithashtu, është propozuar që të rikualifikohet mosdeklarimi i pasurisë si shkelje administrative dhe/ose disiplinore, ndërsa përcaktimi fillestar i mosdeklarimit si veprë penale sugjerohet të zbatohet vetëm në rastet e përsëritjes së mosdeklarimit	Ky veprim do të kërkonte një ndryshim të nenit 430 të Kodit Penal, i cili parasheh që mosdeklarimi i njëhershëm është veprë penale. Ne besojmë se ky nen është mjet i rëndësishëm për parandalimin e korrupsionit dhe nuk shohim ndonjë nevojë për ndryshimin e tij.	Refuzohet	Sipas mendimit tonë nuk ka nevojë të ndryshohet Kodi Penal dhe ekziston hapësira ligjore që kjo shkelje me ligj të veçantë, të konsiderohet së pari shkelje administrative.

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 4.4	Përparimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, si masë e fundit, synon forcimin e pjesëmarrjes së Kosovës në negociatat për miratimin e traktateve ndërkombëtare në këtë fushë dhe përfundimin e marrëveshjeve bilaterale dhe memorandumeve të mirëkuptimit me agjencitë e huaja dhe vendase përgjegjëse për monitorimin e deklaramit të pasurisë.	A nuk do të zbatohet kjo kornizë ndërkombëtare atëherë për taksat dhe flukset e jashtëligjshme financiare pak më përgjithësisht? Të përmendet vetëm prona duket përsëri pak e ngushtë në fushën e nivelit të strategjisë, ju mund të përmendni se në planin e veprimit, por në përgjithësi duhet parë një rrjedhë të jashtëligjshme financiare që është e lidhur me korrupsionin pak më gjerë.	Refuzohet	Nuk është fjala vetëm për pronat.
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 5.0		Sugjerim për të shtuar Agjencinë për Barazi Gjinore pasi që ata janë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, të dyja këto janë të lidhura ngushtë me Objektivat Specifike të	Refuzohet	Kjo mbetet për vendim të menaxhmentit të MD-së.

				kësaj strategjie.		
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 5.0	Një pjesë integrale e strategjisë është plani i veprimit për periudhën 2021-2023, i cili përpunon në detaje objektivat strategjike dhe specifike, aktivitetet, institucionet përgjegjëse, koston financiare për zbatim dhe treguesit (baza, objektivi i mesëm dhe i fundit).	Të dhënat përkatëse duhet të ndahen sipas gjinisë sipas nevojës.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i përgjithshëm	Kapitulli 5.0	Përfaqësuesit kryesorë në organin koordinues ndërinstytucional do të jenë:...	Ne sugjerojmë përfshirjen e Policisë së Kosovës në përbërjen e këtij organi.	Pranohet plotësisht	

EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 5.0	Figura 1: Piramida e strukturave institucionale për rregullimet e zbatimit të strategjisë.	Ju lutemi përfshini në figurë të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë, në vend që t'i referoheni vetëm MD-së.	Refuzohet	Qëllimi i kësaj figure nuk është të përfshihen zbatuesit e strategjisë, por për monitorimin e zbatimit të Strategjisë.
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 5.0	Figura 2: Përbërja e Komitetit Drejtues të strategjisë	Ne rekomandojmë përfshirjen e institucionit të Avokatit të Popullit në përbërjen e Komitetit Drejtues. Për më tepër, ne rekomandojmë që të hiqni Partnerët Zhvillimor si anëtarë nga Komiteti Drejtues dhe t'i përfshini ata si vëzhgues. Shoqëria civile gjithashtu mund të përfshihet si vëzhgues në Komitetin Drejtues.	Pranohet plotësisht	
EU	Koment i pergjithshem	Kapitulli 5.0	Tregues tjerë në nivelin e aktivitetit propozohen nga MD-ja dhe konfirmohen me secilin institucion përgjegjës për të qenë në nivelin e rezultateve të objektivave të përgjithshëm dhe	Rekomandim për të përdorur gjithashtu Treguesin e Qeverisjes në të gjithë botën: a) Sundimi i Ligjit dhe b) Kontrolli i Korrupsionit (të dyja nga Banka Botërore), dhe së dyti Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit TIB. BE i ka përdorur këta tregues për një kohë të gjatë. Treguesit e CEPEJ dhe ËJP janë të rinj në Kosovë, do të ishte mirë që t'i plotësoni me tregues që lejojnë krahasimin edhe për një periudhë më	Refuzohet	Është refuzuar sepse ka mjaftueshëm indikatorë dhe nuk është qëllimi të matet suksesi i Strategjisë në raport me situatën para 5 ose 10 viteve, por me situatën aktuale.

			specifik, si dhe rezultateve në nivelin e aktivitetit	të gjatë prapa.		
EU	I.1_Llogaridhenja	19	Ndryshimi i ligjit për KPK-në për të përcaktuar që numri i anëtarëve të prokurorisë në KPK të zvogëlohet;	Në përbërjen e Këshillave, është e vështirë të kesh një kuptim gjithëpërfshirës dhe të qartë të rezultatit përfundimtar të ndryshimeve të parapara. Çfarë sjellin ato për sa i përket numrit të anëtarëve porotë kundrejt anëtarëve që vijnë nga brenda gjyqësorit, duke ditur që sipas standardeve evropiane për gjyqësorin, këta të fundit duhet të përfaqësojnë të paktën gjysmën e anëtarëve të Këshillave? Institucionet së pari duhet të dalin me një plan të duhur dhe të përgjithshëm mbi përbërjen dhe funksionimin e KPK-së para se të	Refuzohet	Analiza tanimë ekziston në dokumentin e politikave për llogaridhënien.

				<p>propozojnë të gjithë këta hapa konkretë. Kualifikimet e anëtarëve po ashtu duhet të shqyrtohen.</p>		
EU	I.1_Llogaridhenja	20	<p>Ndryshimi i Ligjit për KGJK-në për të përcaktuar që anëtarët e KGJK-së të zgjedhur nga Kuvendi do të jenë profesorë të juridikut dhe përfaqësues të shoqërisë civile</p>	<p>Nuk ka nevojë për ndryshim të Ligjit për KGJK-në në mënyrë që të përfshihen profesorë të juridikut dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ligji nuk e kufizon asnjë profesionist të aplikojë për pozicionin e anëtarit të KGJK-së. Sipas Ligjit dhe Kushtetutës, 3 anëtarë të KGJK-së të zgjedhur nga Kuvendi nuk kanë pse të jenë gjyqtarë.</p>	Pranohet plotësisht	Ky aktivitet është larguar nga Plani i Veprimit.

EU	I.1_Llogaridhenja	26	Miratimi i kornizës rregullative nga KGJK dhe KPK për të siguruar që funksionet e Njësive të Inspektimit Gjyqësor (NjIGj) parashihen me ligj, duke respektuar pavarësinë gjyqësore dhe prokuroriale	Njësia e Inspektimit të KPK-së (NjVPP) përcaktohet me Ligj. Kjo duhet të jetë në lidhje me miratimin e rregulloreve nga Këshillat siç parashihet me ligjet përkatëse. NjIGj tashmë është një kategori ligjore shih nenin 36 par. 4 të Ligjit për KGJK-në dhe nenin 30 par. 2 të Ligjit për KPK-në.	Refuzohet	Baza dhe elementet kryesore të funksionimit të NjIGJ duhet të jenë në legjislacionin primar.
EU	I.1_Llogaridhenja	28	Rishikimi dhe ndryshimi i shablloneve aktuale të përdorura për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve në atë mënyrë që të shabllonet të reflektojnë plotësisht kriteret cilësore sipas legjislacionit të ndryshuar	Ju lutemi përafroji me veprimin 1.2.1 - shabllonet duhet të miratohen së bashku me rregulloret përkatëse për vlerësimin e performancës - nuk është e qartë pse shabllonet duhet të rishikohen para rregulloreve - përafroji afatet kohore që të jenë të njëjta si për rregulloret ashtu edhe për modelet apo shabllonet.	Pranohet plotësisht	Është reflektuar: meqë rregulloret tashmë janë miratuar (pas dërgimit të Strategjisë në konsultime publike), viti i miratimit të Rregullores është bërë 2021 ndërkaq ajo për shabllone është lënë 2022

EU	I.1_Llogaridhenja	29	Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve me shpjegime të hollësishme nga KGJK-ja dhe KPK-ja në lidhje me të gjithë procesin e vlerësimit të performancës	Udhëzimet duhet të ndjekin rregulloren për vlerësimin e performancës, prandaj afatet kohore duhet të harmonizohen. Veprimi/objektivi 1.2.1 më lart i referohet vitit 2022 për miratimin e rregullores, megjithatë afati kohor i udhëzimeve është 2021 - shqyrtoni përafrimin e afateve kohore!	Pranohet plotësisht	Është reflektuar: afati për udhëzimet tash është 2022, sikur edhe për shabllonet.
EU	I.1_Llogaridhenja	32	Vlerësimi vjetor nga KGJK i numrit të kërkuar ligjërish të gjyqtarëve (1/3)	KPK-ja duhet të shtohet, ose "dhe prokurorët" duhet të fshihen. Plani i veprimit duhet të parashikojë në zhvillimin e një modeli, për të rishikuar rregullisht nevojat për gjykim dhe aprovimin nga KGJK-ja.	Pranohet plotësisht	Diskrepanca ka qenë vetëm në versionin e gjuhës angleze dhe serbe. Është reflektuar ndryshimi, duke e fshier "edhe prokurorëve" meqë KPK e bën këtë në baza të rregullta.
EU	I.1_Llogaridhenja	33	KGJK ofron arsyetime të qarta për çdo vendim lidhur me avancimin e gjyqtarëve bazuar në vlerësimin e performancës	A nuk duhet që rezultati të jetë hartimi/rishikimi i Rregullores përkatëse të KGJK-së për Avancimet? Rregullorja aktuale është e vjetruar dhe nuk pasqyron ndryshimet legislative që ndodhën në vitin 2019.	Pranohet pjesërisht	Komenti pranohet: është futur një aktivitet i ri me të cilin parashihet miratimi i Rregulloreve të reja, por në të njëjtën kohë mbetet edhe ky aktivitet, meqë janë çështje të ndara.

EU	I.1_Llogaridhenja	38	Ofrimi i trajnimeve për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës	Dy veprime kanë rezultat të ngjashëm. Shihni veprimin vijues: Organizimi i programeve të trajnimit për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës.	Refuzohet	Metoda e pershkrimit të aktiviteteve për trajnime është: dizajnimi i kurrikulës dhe mbajtja e trajnimeve, pra janë dy aktivitete të ndara. Kjo ndihmon edhe matjen më të mirë të rezultateve.
----	-------------------	----	--	---	-----------	---

EU	I.1_Llogaridhenja	42	Publikimi i raporteve të detajuara mbi proceset e rekrutimit, të cilat përmbajë informata të detajuara mbi gjithë procesin e rekrutimit dhe mbarëvajtjen e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	<p>Cili proces rekrutimi? Gjyqtarët? Stafin ndihmës? Në çdo rast duhet të sqarohet nëse janë gjykatat apo KGJK-ja ajo që duhet të publikojë raporte të tilla. Kur bëhet fjalë për rekrutimin, Plani i Veprimit duhet të parashikojë masa dhe veprime më konkrete:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i praktikave uniforme të praktikave të rekrutimit ndërmjet KGJK-së dhe KPK-së. - Të përdoren laboratorë kompjuterikë me testin e gjeneruar nga softueri për të gjithë kandidatët ose makineri të lexueshme të skanimit në mënyrë që secili kandidat të dijë në fund të testit nëse ai/ajo ka kaluar apo jo. - Të lejohet kontrolli publik nga OJQ-të ose subjekte tjera për testin me shkrim të kandidatëve. Testi me shkrim duhet të gjenerohet edhe nga softueri kompjuterik. - Vlerësimi i kandidatëve të bëhet në mënyrë të pavarur nga anëtarët e panelit - në mënyrë elektronike - Të krijohet një panel i madh me d.m.th. 20 gjyqtarë/anëtarë të cilët do të trajnohen për 	Pranohet pjesërisht	Disa nga masat janë përfshirë në pjesën e PV, sa i përket integritetit. Përveç, kontrollit publik nga OJQ-të ose subjektet tjera të testeve me shkrim e cila nuk është e përshtatshme të përfshihet.
----	-------------------	----	---	---	---------------------	--

				<p>metodologjinë e testimit, intervistimit dhe pikëzimit.</p> <ul style="list-style-type: none">- Ndërsa anëtarët e veçantë të panelit për një proces të veçantë rekrutimi të zgjidhen nga paneli i madh vetëm një ose dy ditë para se të fillojë provimi.		
--	--	--	--	--	--	--

EU	I.4_Integriteti	10	Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës në mënyrë që vetëm gjyqtarët me një mandat të përhershëm dhe minimumi prej gjashtë (6) vjet përvojë si gjyqtarë dhe prokurorë të mund të jenë anëtarë të KGJK-së	Pse 6 vjet? Si eliminohet konflikti i propozimit me parimin e lirisë së zgjedhjeve, duke marrë parasysh faktin se këta janë individë të zgjedhur nga kolegët e tyre?	Pranohet plotësisht	Ky aktivitet është riformular dhe do të përcaktohen kritere shtesë për anëtarë gjyqtarë të KGJK-së.
EU	I.1_Llogaridhenja	48	Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale dhe legjislacionit shoqërues për të lejuar mjetet juridike kundër vendimit të prokurorit për pushimin e ndjekjes penale	Kjo është tashmë në draftin e KPP-së, i cili priste miratimin e Qeverisë përpara krizës. Sidoqoftë, është e rëndësishme të mbahet ky veprim, pasi KPP nuk është miratuar ende.	Pranohet plotësisht	

EU	I.1_Llogaridhenja	49	Miratimi i udhëzimeve nga KGJK në mjediset ku zhvillohen seancat dëgjimore, për të siguruar mbajtjen e seancave gjyqësore në sallën e gjykimeve në vend të zyrave të gjyqtarëve, veçanërisht në rastet e profilit të lartë	Kjo tashmë është krijuar si praktikë.	Pranohet plotësisht	
----	-------------------	----	--	---------------------------------------	---------------------	--

EU	I.1_Llogaridhenja	50	<p>KGJK monitoron nga afër zbatimin e kriterëve ligjore për transferimin dhe avancimin e gjyqtarëve, në mënyrë që të përmirësohen praktikat e promovimeve të gjyqtarëve përmes transfereve</p>	<p>Para monitorimit, KGJK-ja duhet të miratojë rregullore të azhuruara për rregullimin e kriterëve dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin primar.</p> <p>KGJK-ja nuk monitoron; KGJK-ja është e ngarkuar me transferimet. Ajo që duhet të rregullohet është që asnjë transferim ose ngritje në detyrë nuk zyrtarizohet dhe bëhet operative derisa i njëjti gjyqtar të mos merret me çështjet të cilat atij/asaj i janë caktuar para se të transferohej/promovohej. Praktika e deritanishme ka zbuluar që pas transferimit/ngritjes në detyrë gjyqtarët braktisin lëndën e caktuar duke e bërë atë të fillojë përsëri sipas kërkesës së kodit të procedurës penale.</p> <p>Ligji gjithashtu duhet të përcaktojë qartë kushtet e transferimit, transferimit të përhershëm, caktimit dhe promovimit. Rezultati duhet të jetë fillimisht miratimi i rregullores së rishikuar për ngritjen</p>	Pranohet plotësisht	Aktivitet i ri është futur në Objektivën për llogaridhënjë
----	-------------------	----	--	--	---------------------	--

				në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve.		
--	--	--	--	---	--	--

EU	I.1_Llogaridhenja	52	KGJK monitoron nga afër angazhimet e jashtme të gjyqtarëvesi dhe kompensimet për t'u siguruar zbatimin e kriterit ligjor që të ardhurat e gjyqtarëve nga angazhimet e jashtme nuk tejkalojnë 25% të pagave të tyre bazë	Si bëhet monitorimi? Ky Plan i Veprimit duhet ta specifikojë atë, duke pasur parasysh që dispozitat në ligj janë në fuqi që nga viti 2015 por asnjëherë nuk janë zbatuar.	Pranohet plotësisht	Është ndryshuar rezultati i aktivitetit.
EU	I.1_Llogaridhenja	53	KPK monitorojnë nga afër angazhimet e jashtme të prokurorëve si dhe kompensimet për t'u siguruar zbatimin e kriterit ligjor që të ardhurat e prokurorëve nga angazhimet e jashtme nuk tejkalojnë 25% të pagave të tyre bazë	I njëjti koment.	Pranohet plotësisht	Është ndryshuar rezultati i aktivitetit.

EU	I.1_Llogaridhenja	58	KGJK krijon një mekanizëm përcjellës elektronik që regjistron ankesat për shkelje të rregullave disiplinore, veprimet e ndërmarra dhe progresin përgjatë fazës së hetimit	Ne nuk e kemi parë këtë mekanizëm? Si funksionon ai? Kush e mirëmban dhe administron atë?	Refuzohet	Fjala është për një mekanizëm që do të krijohet.
EU	I.1_Llogaridhenja	60	KGJK ndërmerr fushatata të vazhdueshme mediale dhe informative për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për sistemin e ri ligjor të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve	Ekzistojnë dy veprime të ngjashme, ku që të dyja përmendin KGJK-në. Një veprim duhet të drejtohet drejt KPK-së.	Pranohet plotësisht	Pranohet dhe është evituar problemi teknik në gjuhën angleze.
EU	I.1_Llogaridhenja	62	KGJK vlerëson efektivitetin e sistemit të ri të përgjegjësisë së gjyqtarëve pas një periudhe zbatimi një vjeçar, dhe propozon masat korigjuese për	Në të vërtetë, bazuar në konkluzionet e takimit të Nënkomitetit të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë 2020 ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe BE-së, të mbajtur më 10-11 qershor 2020, KGJKja ka marrë përsipër të kryejë një	Pranohet plotësisht	është ndryshuar viti në 2022.

			autoritetet përkatëse, sipas rastit	vlerësim të sistemit disiplinor deri në fund të vitit 2020 .		
EU	I.1_Llogaridhenja	63	KPK vlerëson efektivitetin e sistemit të ri të përgjegjësisë së prokurorëve pas një periudhe zbatimi një vjekar, dhe propozon masat korigjuese për autoritetet përkatëse, sipas rastit	Bazuar në konkluzionet e takimit të Nënkomitetit të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë 2020 ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe BE-së, të mbajtur më 10-11 qershor, 2020, KPK-ja ka marrë përsipër të kryejë një vlerësim të sistemit disiplinor deri në fund të vitit 2020.	Pranohet plotësisht	është ndryshuar viti në 2022.
EU	I.1_Llogaridhenja	64	Masa e politikës: Mekanizma efikas të informimit publik që japin qasje të shpejtë dhe të saktë në informata	Këto udhëzime dhe procedura duhet të jenë në përputhje me dispozitat ligjore në lidhje me qasjen në dokumente publike në përgjithësi, kështu që nuk ka kornizë diferencuese.	Pranohet plotësisht	Është ndryshuar viti në 2022. Nënkuptohe.

EU	I.1_Llogaridhenja	69	KPK vlerëson kapacitetet e tyre të brendshme për të trajtuar kërkesat për qasje në dokumente publike në përputhje me legjislacionin përkatës për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave	Për KGJK-në, është përfshirë një veprim i veçantë në lidhje me udhëzimet dhe procedurat për qasje në dokumente publike. Pse nuk përfshihet ky veprim për KPK-në?	Refuzohet	Rekomandimi ka të bëjë në me procesin e publikimit të vendimeve gjyqësore, të cilën mund ta bëjë vetëm KGJK.
----	-------------------	----	--	--	-----------	--

EU	I.1_Llogaridhenja	71	<p>KGJK vazhdon përditësimin e faqes së internetit me informata thelbësore për publikun, përfshirë këtu: vendimet e gjykatave që publikohen menjëherë pas marrjes së tyre; qasje në raporte analitike dhe gjithëpërfshirëse me informata lidhur me proceset e emërimeve, promovimeve, vlerësimeve, procedurave disiplinore, informatave relevante në lidhje me punën dhe aktivitetet e KGJK dhe planet e veprimit, rezultatet e konsultimeve të rregullta ndërmjet KGJK/KPK dhe gjykatave/prokurori ve për aktivitetet përcjellëse të</p>	<p>Ju lutemi cekni se e gjithë përmbajtja në faqen e internetit duhet të botohet në të dy gjuhët zyrtare njëkohësisht! Shpesh, përmbajtja në gjuhën serbe nuk pasqyron përmbajtjen në gjuhën shqipe.</p>	Pranohet plotësisht	Është cekur brenda në tekst të aktivitetit dhe rezultatit.
----	-------------------	----	---	--	---------------------	--

			çështjeve të identifikuara përmes mekanizmave të ndryshëm të vlerësimit			
--	--	--	--	--	--	--

EU	I.1_Llogaridhenja	72	<p>KPK vazhdon përditësimin e faqes së internetit që përmban informata thelbësore për publikun, përfshirë këtu: vendimet e prokurorive publikohen menjëherë pas marrjes së tyre; qasje në raporte analitike dhe gjithëpërfshirëse me informata lidhur me proceset e emërimeve, promovimeve, vlerësimeve, procedurave disiplinore, informatave relevante në lidhje me punën dhe aktivitetet e KPK dhe planet e veprimit, përfshirë rezultatet e konsultimeve të rregullta ndërmjet KGJK/KPK dhe gjykatave/prokurori</p>	<p>Ju lutemi cekni se e gjithë përmbajtja në faqen e internetit duhet të botohet në të dy gjuhët zyrtare njëkohësisht! Shpesh, përmbajtja në gjuhën serbe nuk pasqyron përmbajtjen në gjuhën shqipe.</p>	Pranohet plotësisht	Është cekur brenda në tekst të aktivitetit dhe rezultatit.
----	-------------------	----	--	--	---------------------	--

			ve për aktivitetet përcjellëse të çështjeve të identifikuara përmes mekanizmave të ndryshëm të vlerësimit			
--	--	--	--	--	--	--

EU	I.2_Efikasiteti	14	Kryerja e një analize për kapacitetet dhe efikasitetin, duke përfshirë vlerësimin e ngarkesës me raste, lëndët e vjetra dhe shpërndarjen e drejtë të numrit të rasteve tek gjyqtarët, e Gjykatës Themelore në Prishtinë.	Vlerësimi i njëjtë duhet të bëhet për të gjitha gjykatat dhe degët, veçanërisht në dritën e shkarkimit të kompetencave në lidhje me përmbartimin dhe kundërvajtjet. Tani me këto kompetenca të hequra, që do të thotë se nevojiten shumë pak gjyqtarë për lëndë përmbartimore dhe kundërvajtje, duhet të bëhen analizat për të parë se si këta gjyqtarë (80+) janë caktuar përsëri dhe si ndryshoi situata pasi e gjithë ideja prapa këtyre reformave do të shkarkonte barrën e gjykatës dhe të bëhet caktimi i gjyqtarëve për të punuar në lëndë më të rënda dhe gjithashtu në lëndët e vjetra të pazgjidhura.	Refuzohet	Për vitin 2021 është paraparë kjo gjykatë, për vitet tjera mund të mendohet për analizimin e gjykatave të tjera në raport me mapping & surveys si veprime të planifikuara në Kapitullin III.
----	-----------------	----	--	---	-----------	--

EU	I.2_Efikasiteti	15	Themelimi dhe funksionalizimi i një degë të Gjykatës Themelore të Prishtinës në Fushë Kosovë.	Kjo masë duhet të përfshijë në të njëjtën kohë një vlerësim të ekzistencës së disa degëve shumë të vogla ku buxheti tejkalon nevojat për ekzistencën e tyre (sipas rastit) si dhe të fshijë nga ligji krijimin e degëve në Junik dhe Shtime (këto dy degë nuk janë ende funksionale, megjithëse ligji është në fuqi që nga viti 2015).	Pranohet plotësisht	Pas diskutimeve me KGJK-në është vendosur që të pranohet ky koment dhe të futet rekomandim i ri në Objektivën mbi Efikasitetin që të ndryshohet Ligji për Gjykatat për t'u fshier këto dy degë nga ligji.
EU	I.2_Efikasiteti	16	Hartimi i planit një vjeçar dhe tre vjeçar që përmban nevojat për rekrutim dhe trajnim dhe përcakton politika rigoroze dhe transparente afatmesme dhe afatgjata në përcaktimin e numrit të gjyqtarëve, dhe stafit mbështetës për gjykata.	Në vend të kësaj, KGJK/KPK duhet të kryejë një 'rishikim funksional' të stafit të gjykatës duke pasur parasysh automatizimin e proceseve të brendshme (SMIL).	Pranohet pjesërisht	Një rishikim i këtillë është planifikuar të bëhet në kuadër të Koncept Dokumentit për nëpunësit civil në administratën e gjykatave dhe prokurorive . Prandaj, ky koment është adresuar përmes futjes së këtij Koncept Dokumenti tash në PV, tek objektiva për Efikasitetin

EU	I.2_Efikasiteti	19	Ofrimi i trajnimeve të specializuara për menaxhim dhe udhëheqje për kryeprokurorët dhe për kandidatët në pozita drejtuese	Kjo duhet të bazohet në një plan karriere për secilin prokuror (kryeprokuror).	Refuzohet	Plane të karrierës nuk ka, por ofrimi i trajnimeve parashihet në PV - Kapitulli 1.2.
EU	I.2_Efikasiteti	20	Masa e politikës: Përmirësimi i grumbullimit dhe analizës së të dhënave nga KGJK-ja dhe KPK-ja, gjykatat dhe prokuroritë	Duhet gjithashtu të përfshihet një masë specifike në lidhje me analizën e të dhënave, që synojnë zhvillimin e politikave.	Pranohet plotësisht	Është futur një aktivitet i ri në objektivin e efikasitetit.
EU	I.2_Efikasiteti	22	Zbatimi i vazhdueshëm dhe konsistent i SMIL në mënyrë që raportet të ofrojnë përmbajtje sasiore dhe analitike dhe që publiku të ketë qasje në informata për rolin dhe veprimtarinë e gjykatave dhe prokurorive.	Nuk ka të bëjë vetëm me zbatimin e SMIL-it, por gjithashtu edhe me përdorimin e vazhdueshëm të sistemit nga gjyqtarët, prokurorët dhe personeli ndihmës. Personeli i statistikave duhet të trajnohet për PPSS dhe softuer tjetër për të analizuar informacionin e gjeneruar statistikor.	Pranohet plotësisht	Është adresuar përmes futjes së aktivitetit të ri të përmendur më sipër

EU	I.2_Efikasiteti	24	Zbatimi i rekomandimit të CEPEJ-së për menaxhimin e kohës në mënyrë që në një instancë gjyqësore rasti të zgjidhet brenda një periudhe dyvjeçare nga dita e paraqitjes së tij	Rekomandimet për menaxhimin e kohës të CEPEJ janë gjithashtu të nevojshme për Prokurorinë në lidhje me afatet e tyre kohore. Plani i veprimit nuk shtjellon se si ta arrijmë këtë. Ndjekja e rrjedhës së lëndës është e pranueshme, por për të arritur qëllimin dy-vjeçar është krejtësisht një tjetër nivel planifikimi dhe përcaktimesh të lëna mënjanë.	Refuzohet	Sipas dijenisë tonë CEPEJ nuk përdor indikator specifik për Prokurorinë.
EU	I.2_Efikasiteti	26	Futja e caktimit automatik të lëndëve tek gjyqtarët	SMIL tashmë e ka prezantuar këtë veçori, megjithatë ka disa shqetësime se kjo nuk respektohet plotësisht.	Pranohet plotësisht	
EU	I.2_Efikasiteti	34	Trajnimi i gjyqtarëve në fusha të specializuara komerciale.	Gjithashtu stafi i ndihmës juridike duhet të trajnohet.	Pranohet plotësisht	Është shtuar një aktivitet i ri.
EU	I.2_Efikasiteti	35	Masa e politikës: Mekanizmat efektiv të ZAK-së që i përshtaten përmasave dhe nevojave të biznesit	Rekomandojmë një vlerësim gjithëpërfshirës të gjendjes aktuale për përdorimin e ZAK-së, evolucionin e tij ndër vite, sfidat aktuale dhe stimujt ligjorë e përpjekje tjera për të përparuar	Refuzohet	Ka vlerësime gjithëpërfshirëse në dokumentin e politikave nr. 12 për profesionet e lira

				ZAK-në në përputhje me mjetet dhe standardet e CEPEJ.		
EU	I.2_Efikasiteti	40	Masa e politikës: E-Drejtësia dhe ndërlidhshmëria e të dhënave	Ne rekomandojmë të shtoni një rekomandim për përdorimin e thirrjeve elektronike për të përmirësuar komunikimin ndërmjet gjykatave dhe avokatëve, gjë që do të rrisë efikasitetin e sistemit të drejtësisë në tërësi (domethënë: thirrjet u dërgohen avokatëve me e-mail). Përndryshe kjo mund të bjerë nën Kapitullin "Fuqizimi i rolit të Ministrisë së Drejtësisë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian", Masa e Politikës: Përdorimi i teknologjive moderne në sektorin e drejtësisë.	Pranohet plotësisht	Është shtuar një aktivitet i ri tek "E-Drejtësia": Funkcionalizimi i vecorisë së SMIL për të mundësuar thirrjet elektronike nga gjykata drejtuar palëve dhe përfaqësuesve të tyre
EU	I.3_Profesionalizimi	11	Masa e politikës: Harmonizimi i trajnimeve të ofruara për zhvillim profesional me nevojat e sektorit të drejtësisë	Ne do të sugjerim që të përfshihet edhe një veprim në lidhje me zhvillimin profesional të stafit ndihmës ligjorë.	Pranohet plotësisht	Janë shtuar dy aktivitete për të reflektuar komentimin

EU	I.3_Profesionalizimi	16	Caktimi automatik i lëndëve në bazë të ekspertizës së gjyqtarit kur është e mundshme.	Zbatimi i këtij veprimi nuk duhet të ndërhyjë në parimin që sistemi duhet të caktojë lëndë rastësisht dhe automatikisht. Me fjalë tjera, duhet të ketë disa gjyqtarë me një ekspertizë specifike për të siguruar që jo të gjitha ato lëndë që kërkojnë këtë ekspertizë specifike të shkojnë tek i njëjti gjyqtar, por përkundrazi të shpërndahen në mes të disa gjyqtarëve në një mënyrë të rastësishme. Ju lutemi përkufizoni ekspertizën. A është specializimi?	Pranohet plotësisht	Është riformuluar rezultati për të reflektuar komentin
EU	I.3_Profesionalizimi	18	Hartimi i planeve të trajnimit për fushat që janë identifikuar si mangësi të zakonshme të gjyqtarëve gjatë vlerësimit të performancës në sektorin e drejtësisë.	Ne rekomandojmë që kjo të riformulohet në: Zhvillimi i planeve të trajnimit për fushat që janë identifikuar si mangësi të zakonshme të gjyqtarëve kur kryhen vlerësimet e performancës në sektorin e drejtësisë dhe bazuar në anketat e Vlerësimit të Nevojave të Trajnimit të kryera në online nga Akademia.	Pranohet plotësisht	Është riformuluar në përputhje me komentin

EU	I.2_Efikasiteti	20	Masa e politikës: Përmirësimi i grumbullimit dhe analizës së të dhënave nga KGJK-ja dhe KPK-ja, gjykatat dhe prokuroritë	Ne rekomandojmë të shtohet "zhvillimi i raporteve statistikore bazë dhe të avancuara dhe tabelave në SMIL për kryetarët e gjykatave/kryeprokuroret, gjyqtarët/prokuroret dhe KGJK/KPKnë, duke përdorur treguesit dhe metodologjinë e performancës CEPEJ.	Pranohet pjesërisht	Janë vendosur aktivitete shtesë në PV për avancimin e modulit statistikor si dhe për realizimin e vlerësimit të rregullt të efikasitetit të sistemit të drejtësisë bazuar në metodologjinë e CEPEJ. Viteve në vijim do të vlerësohet se si kjo mund të bëhet edhe më specifike.
EU	I.2_Efikasiteti	20	Masa e politikës: Përmirësimi i grumbullimit dhe analizës së të dhënave nga KGJK-ja dhe KPK-ja, gjykatat dhe prokuroritë	Ne propozojmë rekomandimin e mëposhtëm: "Raportet e rregullta mbi performancën e gjykatës të përgatitura nga KGJK-ja dhe KPK-ja me analiza të hollësishme të statistikave duke përdorur treguesit e performancës CEPEJ, sipas kategorisë së lëndëve, për të identifikuar trendet, dobësitë dhe duke bërë rekomandime."	Pranohet pjesërisht	Shih komentit më lartë.

EU	I.2_Efikasiteti	20	Masa e politikës: Përmirësimi i grumbullimit dhe analizës së të dhënave nga KGJK-ja dhe KPK-ja, gjykatat dhe prokuroritë	Ne rekomandojmë që ta modifikoni këtë rekomandim si më poshtë: “Zbatimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i SMIL-it me mekanizma të fuqishëm të cilësisë së të dhënave në mënyrë që raportet të sigurojnë përmbajtje sasiore dhe analitike dhe që publiku të ketë qasje në informacion mbi rolin dhe veprimtarinë e gjykatave dhe prokurorive.”	Refuzohet	Tanimë ekziston ky aktivitet në Kapitullin 1.2.
----	-----------------	----	---	---	-----------	---

EU	I.2_Efikasiteti	26	Futja e caktimit automatik të lëndëve tek gjyqtarët	<p>Ne rekomandojmë riformulimin e rekomandimit në vijim si më poshtë: “Fillimi i zbatimit - Zgjerimi i caktimit automatik dhe sipas rastit të lëndëve për gjyqtarët në të gjitha llojet e lëndëve, në të gjitha gjykatat dhe për anëtarët e trupit gjykues” Fjala "prezantuar - fillimi i zbatimit" nuk mund të përdoret sepse sistemi automatik i caktimit të lëndëve ka filluar në shkurt të vitit 2020. Veprimi KoSEJ II ka ndihmuar ekipin e SMIL-it në zhvillimin e një raporti statistikor për të monitoruar këto detyra (d.m.th. Cilat bëhen automatikisht dhe ato të bëra manualisht). Raportet janë në dispozicion në SMIL. Këto raporte duhet të monitorohen dhe analizohen nga afër rregullisht në gjykata dhe në KGJK. Raporti më i fundit tregon se një numër i lartë i rasteve së pari caktohen automatikisht por pastaj caktohen manualisht.</p>	Pranohet plotësisht	Është riformuluar - 'Vazhdimi dhe përmbushja e plotë.'
----	-----------------	----	---	--	---------------------	--

EU	I.3_Profesionalizmi	25	Realizimi i një analize mbi nevojën për specializim të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ana e AD në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në.	Kjo pikë veprimi duhet të vijë para ndarjes së një buxheti më të madh për AD-në.	Pranohet pjesërisht	Është pranuar në parim; Çështja e buxhetit gjithashtu çështje e diskutueshme brenda Koncept Dokumentit për Ligjin e ri për AD.
EU	I.3_Profesionalizmi	32	Përcaktimi i kriterëve të rrepta dhe të qarta për zgjedhjen e mentorëve.	Përzgjedhja e trajnerëve dhe mentorëve është proces shumë i rëndësishëm. AD duhet t'i përmbahet standardit më të lartë të profesionalizmit dhe meritokracisë kur zgjedh trajnerë dhe mentorë; ndërsa lista e trajnerëve dhe moduleve që ato mbulojnë duhet të jetë publike në çdo kohë.	Pranohet plotësisht	

EU	I.4_Integriteti	10	Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës në mënyrë që vetëm gjyqtarët me një mandat të përhershëm dhe minimumi prej gjashtë (6) vjet përvojë si gjyqtarë dhe prokurorë të mund të jenë anëtarë të KGJK-së.	Kërkesa për të pasur një mandat të përhershëm si gjyqtar në mënyrë që të aplikohet si anëtar i KGJK-së tashmë është paraparë në Ligjin për KGJK-në (neni 9 par.1.8). Cili është arsyeimi për të ngritur nivelin e punës me vite shtesë përvojë pune si gjyqtar apo prokuror për t'u bërë anëtar i KGJK-së?	Pranohet plotësisht	Ky aktivitet është riformuluar dhe do të përcaktohen kritere tjera shtesë dhe jo përvoja.
EU	I.4_Integriteti	14	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës ashtu që vetëm kandidatët që nuk janë politikisht aktiv për tre vitet e fundit të mund të konsiderohen për anëtarësim në KPK.	Kjo duhet të zbatohet edhe për KGJK-në.	Pranohet plotësisht	është shtuar aktiviteti i ri

EU	I.4_Integriteti	15	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës ashtu që të përcaktohen kritere shtesë specifike për prokurorët me mandat të përhershëm që mund të jenë anëtarë të KPK-së.	E njëjta pyetje si më sipër është e vlefshme edhe për ngritjen e nivelit të lartë për prokurorët që duan të bëhen anëtarë të KPK-së.	Pranohet plotësisht	Ky aktivitet është riformuluar dhe do të përcaktohen kritere tjera shtesë dhe jo përvoja.
EU	I.4_Integriteti	17	Hartimi i udhëzimit me shkrim për prokurorë për votimin e anëtarëve të ardhshëm të KPK-së sipas meritës dhe kapacitetit.	Kjo nuk është e qartë? A nënkupton kjo ndryshim të rregullores së KPK-së për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë?	Refuzohet	Dokumenti i politikave, ashtu si edhe aktiviteti vetëm bëjnë thirrje për hartimin e udhëzimeve me shkrim për të sqaruar bazat mbi të cilat duhet votuar një anëtar për KPK. Nuk është fjala për ndryshim të rregullores.
EU	I.4_Integriteti	18	Masa e politikës: Rekrutimi, promovimi dhe transferimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit	Kur bëhet fjalë për rekrutimin, Plani i Veprimit duhet të parashikojë më në veçanti masa dhe veprime më konkrete. Shihni më tej komentin tonë për I.1.3.2.	Pranohet pjesërisht	Kjo lidhet me komentin në rreshtin nr.128. Shih spjegimet aty.

			mbështetës i bazuar në kompetencë			
EU	I.4_Integriteti	20	Ndryshimi i aktit nënligjor për avancimin e procedurës për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha pjesëve të provimit për përzgjedhjen e prokurorëve të rinj.	Cili është dallimi me 4.2.1?	Refuzohet	Aktiviteti 4.2.1 ka të bëjë me rekrutimin e gjyqtarëve, ndërsa ky aktivitet me prokurorët. Ky është dallimi.
EU	I.4_Integriteti	28	Ftesa nga Këshilli e dërguar	Ky nuk është në të vërtetë një rezultat.	Pranohet plotësisht	Është riformuluar rezultati - Ftesa do të jetë publike.
EU	I.4_Integriteti	39	Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores (15/2016) për transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve me qëllim të përcaktimit të kriterëve objektive për vlerësimin e kandidatëve, njohurive, aftësive dhe përvojës në	Ju lutemi, harmonizoni me Kapitullin I, Veprimi 1.4.6.	Refuzohet	Aktiviteti 1.4.6 ka të bëjë me monitorimin nga ana e Këshillit të zbatimit të kriterëve, ndërsa ky aktivitet me ndryshimin e Rregullores 15/2016. Nuk ka nevojë për harmonizim ngase janë aktivitete të ndara.

			ushtrimin e rolit specifik në të cilin ata duan të transferohen.			
EU	I.4_Integriteti	48	Masa e politikës: Realizimi i kontrolleve të pavarura dhe të vazhdueshme të integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës	A bazohet kjo në raportin e QeK-së të GP të themeluar për modalitetet për të siguruar llogaridhënie brenda gjyqësorit - raporti i është dërguar QeK-së në dhjetor, 2020.	Pranohet plotësisht	Dokumenti 'modalitetet e llogaridhënies' është bazë për Koncept Dokumentin që është duke u hartuar nga grupi punues i koordinuar nga MD.
EU	I.4_Integriteti	55	Masa e politikës: Fuqizimi i kapaciteteve të Njësive ekzistuese për verifikim në KGJK dhe KPK	A nuk duhet që mandati i Njësive të Verifikimit në vend të rregullohet, të qartësohet me ligjin e propozuar që do të miratohet për Kontrollin e Integritetit të Gjyqtarëve, Prokurorëve dhe Stafit Mbështetës? Është e rëndësishme të shihet nëse do të ketë dy procese paralele në verifikim.	Refuzohet	Dokumenti i politikave parasheh nevojën për të fuqizuar njësitë aktuale ndërkohë që ndërtohet apo zhvillohet koncepti tjetër për një kontroll integriteti më të avancuar dhe të vazhdueshëm. Këto dy qëllime nuk bien

						ndesh me njëra-tjetrën.
EU	I.4_Integriteti	56	Hartimi i akteve nënligjore të cilat përcaktojnë qartazi mandatin e Njësive të Verifikimit.	A nuk duhet që mandati i Njësive të Verifikimit në vend të rregullohet, të qartësohet me ligjin e propozuar që do të miratohet për Kontrollin e Integritetit të Gjyqtarëve, Prokurorëve dhe Stafit Mbështetës? Duke pasur parasysh që këto Njësi merren me informacion shumë të ndjeshëm, duhet të përcaktohet një bazë e qartë ligjore për ekzistencën dhe funksionimin e saj, ose në mungesë të bazës ligjore, mbyllja e saj duhet të vihet në shqyrtim.	Refuzohet	Dokumenti i politikave parasheh nevojën për të fuqizuar njësitë aktuale ndërkohë që ndërtohet apo zhvillohet koncepti tjetër për një kontroll integriteti më të avancuar dhe të vazhdueshëm. Këto dy qëllime nuk bien ndesh me njëra-tjetrën.

EU	II.1_Vleresimi i luftes antikorrupsion	11	Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat ashtu që Gjykata Supreme të mandatohet si arbitër përfundimtar për interpretimin e ligjit	GJS tashmë është arbitri përfundimtar për interpretimin e ligjit në përputhje me Ligjin për Gjykatat (neni. 26, para 1.4.). Nuk ka nevojë për ndonjë ndryshim legjislativ në këtë drejtim, por thjesht të zbatuar ligjin ekzistues. Kjo masë është marrë nga Dokumenti i Politikës nr. 6 "Vlerësimi i Luftës Kundër KOK", i cili nuk ofron ndonjë arsyetim pseudo të ishte i nevojshëm një ndryshim i tillë në Ligjin për Gjykatat. Për më tepër, kjo masë duket plotësisht e shkëputur nga Strategjia, e cila nuk e përmend këtë dhe as nuk e kontekstualizon problemin e pretenduar.	Pranohet plotësisht	Ky aktivitet është fshirë
EU	II.1_Vleresimi i luftes antikorrupsion	12	Ndryshimi i legjislacionit për konfiskimin e pasurisë përfituar jashtëligjshëm në mënyrë që një përqindje e caktuar e të hyrave nga konfiskimi t'u	Ne e kuptojmë që kjo nënkupton krijimin e një fondi konfiskimi, të cilin ne e mbështesim plotësisht. Sidoqoftë, si Strategjia ashtu edhe Plani i Veprimit nuk arrijnë të shpjegojnë në mënyrë të qartë se si mund të bëhet kjo.	Refuzohet	Koncepti Dokumenti për konfiskimin do të jap shpjegimet dhe detajet e nevojshme.

			ndahet agjencive të sektorit të drejtësisë			
EU	II.1_Vleresimi i luftes antikorrupsion	13	Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale për të zgjatur periudhën e lejuar ligjërisht për hetime të veprave penale të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar	Kjo është paraparë tashmë në draftin e KPP-së, i cili priste miratimin e Qeverisë përpara krizës. Sidoqoftë, është e rëndësishme të mbahet ky veprim, pasi KPP nuk është miratuar ende.	Pranohet plotësisht	Është harmonizuar gjuha në tërë PV, për të cekur se KPPK do të jetë tërësisht draft i ri, dhe jo vetëm plotësim-ndryshim.

EU	II.1_Vleresimi i luftes antikorupsion	14	Themelimi i një grupi punues ndërinstucional për të ofruar intepretim të unifikuar të "dashjes" dhe për t'i paraprirë mendimit juridik të Gjykatës Supreme	Ky është gjithashtu rekomandim i Dokumentit të Politikës nr. 6, të cilin ne nuk e mbështesim. Interpretimi i "dashjes" duhet të zhvillohet nga jurisprudenca e gjykatave të Kosovës. Asnjë grup pune nuk mund ta zëvendësojë këtë funksion, i cili duhet të jetë prerogativë ekskluzive e gjykatave në praktikën e tyre gjyqësore. Për më tepër, kjo masë duket plotësisht e shkëputur nga Strategjia, e cila nuk e përmend këtë dhe as nuk e kontekstualizon problemin e pretenduar. Ligjëruesit e universitetit dhe autorët e komentareve gjithashtu mund të përfshihen.	Refuzohe t	Qëllimi i këtij aktiviteti është të ofrohen udhëzime se si të interpretohet dashja, dhe jo të zëvendësohet interpretimi eventual që mund të bëhet për çdo rast.
----	---------------------------------------	----	--	--	------------	---

EU	II.1_Vleresimi i luftes antikorupsion	15	Gjykata Supreme të hartojë dhe miratojë një mendim juridik për të unifikuar interpretimit të "dashjes" siç përkufizohet në nenin 21 të Kodit Penal	Ky është gjithashtu rekomandim i Dokumentit të Politikës nr. 6, të cilin nuk e mbështesim. Interpretimi i "dashjes" duhet të zhvillohet nga jurisprudenca e gjykatave të Kosovës. Asnjë grup pune nuk mund ta zëvendësojë këtë funksion, i cili duhet të jetë prerogativë ekskluzive e gjykatave në praktikën e tyre gjyqësore. Për më tepër, kjo masë duket plotësisht e shkëputur nga Strategjia, e cila nuk e përmend këtë dhe as nuk e kontekstualizon problemin e pretenduar. Ligjëruesit e universitetit dhe autorët e komentareve gjithashtu mund të përfshihen.	Refuzohet	Shih komentin paraprak.
EU	II.1_Vleresimi i luftes antikorupsion	18	Profilizimi i prokurorëve të PSRK-së në fusha të caktuara	PSRK-ja në thelb është riorganizuar tashmë në departamente të specializuara. Këto departamente duhet të fuqizohen nga bashkëpunëtorë profesionistë dhe ekspertë multi-disiplinor (kriminologë, ekspertë ligjorë financiarë, nga krimi kibernetik, etj)	Pranohet plotësisht	Aktiviteti i profilizimit të PSRK është larguar. Numri i ekspertëve do të shtohet si dhe do të analizohet mundësia e angazhimit të ekspertëve tjerë përmes Koncept Dokumentit për Ekspertiza Gjyqësore dhe Prokuroriale.

EU	II.1_Vleresimi i luftes antikorrupsion	20	Rritja e numrit të ekspertëve të specializuar financiar në PSRK dhe perforcimi i kriterëve për perzgjedhjen e tyre	Shikoni komentin në II.1.2.1. Bashkëpunimi me institucionet tjera që ofrojnë ekspertë financiarë nëse transferohen dhe jo të përfshirë në PSRK, p.sh. Universiteti.	Pranohet plotësisht	Do të ketë rritje të numrit të ekspertëve financiarë në PSRK, por edhe do të shihen mundësitë përmes Koncept Dokumentit për Ekspertiza Gjyqësore dhe Prokuroriale, angazhimi i ekspertëve të jashtëm.
EU	II.2_Ngritja e profesionalizmit në luftën e k.o	18	Eliminimi i obligimit për përfaqësim nga çdo rajon në KPK.	Shikoni gjithashtu I.1.1.2: kriteret cilësore për kandidatët për anëtarë	Pranohet plotësisht	është reflektuar në pëprthje me komentin më lartë, sipas referencës së komentit.
EU	II.2_Ngritja e profesionalizmit në luftën e k.o	20	Ndryshimi i Ligjit për Këshillin Prokurorial ashtu që KPSH të mos jetë anëtar i Këshillit	Ne do të çmonim një diskutim gjithëpërfshirës ndërmjet të gjitha palëve të interesuara për këtë çështje. Për më tepër, nuk jemi të sigurt se cili është arsyetimi pas një vendimi të tillë. Në lidhje me performancën institucionale, një vendim i tillë do të ndërpresë lidhjen ndërmjet kulmit strategjik dhe atij operativ. Sistemi nuk duhet të projektohet ad hominem nëse ky është qëllimi. Sistemi hierarkik nuk është i njëjtë me KGJK-në.	Refuzohet	Largimi i KPSH nga KPK është arsyetuar mjaftueshëm në dokumentet e politikave.

				Si e tillë duhet të ruhet prania e Kryeprokurorit në KPK.		
EU	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	9	Hartimi i planit strategjik shumë vjeçar nga SHKK, që parasheh gjithashtu riorganizimin e qendrave korrektuese, zbatimi i të cilit rregullisht vlerësohet kundrejt treguesve të miratuar	Kush pritet t'i shkruajë këto plane saktësisht dhe çfarë duhet të përmbajnë ato? Forcimi i aftësive të planifikimit strategjik për cilin qëllim?	Refuzohet	Masa është e qartë. Planet do të shkruaj SHKK me mbështetjen e Departamenteve të MD-së. Përmbajtja e Planit Strategjik mbetet të shihet, por qëllimi është që institucioni të ketë një planifikim më afatgjatë.

EU	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	10	Hartimi i planit strategjik shumë vjeçar nga SHSK, zbatimi i të cilit rregullisht vlerësohet kundrejt treguesve të miratuar	I njëjti koment	Refuzohet	Masa është e qartë. Planet do të shkruaj SHSK me mbështetjen e Departamenteve të MD-së. Përmbajtja e Planit Strategjik mbetet të shihet, por qëllimi është që institucioni të ketë një planifikim më afatgjatë.
EU	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	11	Hartimi i planit vjetor të veprimit të SHKK-së në bazë të planit strategjik	I njëjti koment	Refuzohet	Shih komentet paraprake.
EU	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	12	Hartimi i planit vjetor të veprimit të SHSK-së në bazë të planit strategjik	I njëjti koment	Refuzohet	Shih komentet paraprake.
EU	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	36	Hartimi i Ligjit për Sherbimin Korrektues	Ekziston tashmë një projektligj i cili i është nënshtruar konsultimit publik. Kështu që mbase ky veprim mund të ndryshohet në "hartim dhe miratim".	Refuzohet	Në bazë të logjikës së përgatitjes së PV - Hartimi është aktivitet, ndërsa Miratimi është rezultat.
EU	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	38	Hartimi i Ligjit për strukturën dhe organizimin e SHSK-së, për të rregulluar autoritetin e vendimarrjes sipas pozitave të stafit të SHSK-së	I njëjti koment	Refuzohet	Shih komentin paraprak.

EU	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	40	Hartimi i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale që rregullon ekzekutimin e dënimeve me burg, paraburgimin dhe gjysmëlirinë	I njëjti koment	Refuzohet	Shih komentin paraparak.
EU	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	44	Avancimi i udhëzuesit të Gjykatës Supreme për të siguruar zbatimin e politikave unike të dënimeve nga gjykatat	Çfarë do të thotë kjo në praktikë?	Pranohet plotësisht	Në praktikë domethënë që gjykatat zbatojnë politika unike, sidomos në trajtimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese.
EU	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	55	Publikimi i listës me të dhënat e kompensimeve të personave të privuar nga liria padrejtësisht	Publikimi i të gjitha vendimeve dhe listave me të dhëna për kompensim për personat të cilëve u është privuar padrejtësisht liria.	Refuzohet	Publikimi i të gjitha vendimeve sështë i nevojshëm, ngase vendimet janë proformë dhe lista i ka të gjitha të dhënat që janë me interes për publikun.
EU	II.4_Policia	11	Hartimi i Ligjit për Pension Policor i cili ulë moshën e pensionimit	Nuk është e qartë nëse i referohemi Projektligjit për Pensionin për Zyrtarët e Policisë në Policinë e Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me Kompetencat e Policisë	Pranohet plotësisht	Është sqaruar titulli konkret i Ligjit.

EU	II.4_Policia	12	Përditësimi i strategjisë për marrëdhënie me publikun për përdorim më të mirë të mediave sociale në ndërtimin e raporteve me publikun	Sugjerim për riformulim të tekstit: Azhurnimi i Strategjisë së Komunikimit të Policisë së Kosovës	Pranohet pjesërisht	Është riformuluar mirëpo mbetet pjesa e mediave sociale.
EU	II.4_Policia	13	Përmirësimi i mekanizmave koordinues në mes të PK dhe IPK lidhur me auditimin e brendshëm, vlerësimin e rrezikshmërisë, parregullsi të dokumenteve identifikuese	Veprimi nuk është shumë i qartë, sidomos fundi i fjalisë: “parregullsi të dokumenteve të identifikimit”.	Pranohet plotësisht	Është riformuluar. Policia e ka pasur komentën e njëjtë dhe aktiviteti është ndryshuar në përputhje me komentet e tyre.
EU	II.4_Policia	15	Ndërmarrja e Inspektimeve nga IPK/PK në policinë e zonës së Ferizajit lidhur me sjelljet e pahijshme në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen siç duhet shkaktarët kryesor	Merrni parasysh riformulimin: Inspektime të përbashkëta nga IPK dhe Drejtoria Rajonale e PK-së në Ferizaj në lidhje me sjelljen e pahijshme të policisë dhe shkaqet themelore të saj	Pranohet plotësisht	Aktiviteti është fshirë në tërësi, ngase Policia ka sugjeruar ashtu.

EU	II.4_Policia	17	Hartimi i akteve nënligjore që derivojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.	Kjo duhet të përfshijë detyrimet e njësive private në shkallë të gjerë për të instaluar një procedurë të brendshme që mbron sinjalizimin e ngjashme me atë për njësitë publike.	Pranohet plotësisht	Kjo çështje do të përfshihet në Strategjinë dhe Planin e Punës së Agjencisë.
EU	II.4_Policia	20	Hartimi i Udhëzimit Administrativ i cili përcakton procedurën për punë të përbashkët, përfshirë këtu zhvillimin e hetimeve të përbashkëta, brenda drejtorateve të Policisë, dhe zhvillimin e ehtimeve të përbashkëta ndërkombëtare	Shqyrtoni mundësinë e ndarjes së këtij veprimi në dy: 1) UA për bashkëpunimin ndërmjet agjencive; dhe 2) UA për hetime të përbashkëta ndërkombëtare.	Pranohet plotësisht	Udhëzimet janë ndarë.
EU	II.4_Policia	27	Nrdyshimi i Ligjit për Policinë për përcaktimin e kontrollin të integritetit për anëtarët e Policisë që parasheh ndërmarrjen e	Nevojiten sqarime të mëtejshme. Sa i përket integritetit, PK-ja ka planin e saj të brendshëm të veprimit dhe UA mbi integritetin. Së dyti, në lidhje me Vetingun e Sigurisë kjo rregullohet me	Refuzohet	Ligji nuk i adreson nevojat e tërësishme dhe reale për verifikimin e integritetit të Policisë.

			kontrolleve të rregullta pesë-vjeqare të integritetit pas vetingut fillestar	Ligjin për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë.		
EU	II.4_Policia	32	Zbatimi konsistent nga prokuroria i mbledhjes dhe dërgimi i informacionit kthyes për përmirësimin e hetimeve	Nuk ka të bëjë vetëm me mbledhjen dhe ndarjen nga prokuroria: prokurorët duhet të marrin rolin e tyre udhëheqës në hetime.	Pranohet plotësisht	Kjo është reflektuar. Prokurori i udhëheq hetimet dhe ka aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të tyre.
EU	III.1_Qasja ne drejtesi	30	Hartimi dhe vënia në dispozicion për publikun e informacioneve relevante përmes një aplikacioni në telefona të mençur, në të cilin vihen në dispozicion informata si vendndodhja e gjykatës(ave) dhe prokurorive, disponueshmëria dhe orari i transportit publik, koha e seancave	Kjo duhet të bëhet në të gjitha gjuhët zyrtare.	Pranohet plotësisht	

			dëgjimore dhe informacione të ngjashme)			
EU	III.1_Qasja ne drejtesi	31	Hartimi dhe vënia në dispozicion për publikun e informacioneve relevante përmes materialeve promovuese si broshura dhe postera, të cilat përmbajnë informata si vendndodhja e gjykatës(ave) dhe disponueshmëria dhe orari i transportit publik, me qëllim të ofrimit të informacioneve publike dhe lehtësisht të	Kjo duhet të bëhet në të gjitha gjuhët zyrtare.	Pranohet plotësisht	

			qasshme për qytetarët.			
EU	III.1_Qasja ne drejtesi	33	Përditësimi i faqeve të internetit të KPK me informata thelbësore dhe të thjeshtëzuara për publikun, përfshirë informacionin juridik, shabllonet e dokumenteve që duhet të dorëzohen në gjykatë/prokurori dhe udhëzimet tjera për publikun.	Kjo duhet të bëhet në të gjitha gjuhët zyrtare.	Pranohet plotësisht	

EU	III.1_Qasja ne drejtesi	46	Masa e Politikës: Përmirësimi i qasjes në drejtësi për personat dhe grupet e cenuara	<p>Në mënyrë që të arrihet efikasiteti i drejtësisë në të gjithë sektorët, por veçanërisht në lidhje me qasjen në drejtësi për grupet në nevojë, dhe në përputhje me dispozitat e Konventës së Stambollit, duhet të ketë një kërkesë për të investuar në një sistem të të dhënave me cilësi të lartë, të besueshme, të krahasueshme dhe të ndara sipas gjinisë.</p> <p>Për momentin, kjo nuk po ndodh plotësisht brenda sistemit të drejtësisë në Kosovë. Një sistem efektiv dhe funksional i mbledhjes së të dhënave duhet të forcohet aty ku ai ekziston tashmë, sikur tek rastet e dhunës në familje dhe bazës së të dhënave të dhunës në familje, dhe të krijohet aty ku nuk ekziston (shih për shembull rastet e dhunës seksuale). Fondet duhet të alokohen edhe për këtë drejtim.</p>	Pranohet plotësisht	Koment i përsëritur. Janë shtuar aktivitetet në këtë drejtim.
----	-------------------------	----	---	---	---------------------	---

EU	III.1_Qasja ne drejtesi	47	Ndryshimi i Kodit Penal të Kosovës për të njohur dhunën me bazë gjinore në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit me qëllim të ofrimit të mbrojtjes më efektive të grave; për të përfshirë krimet kundër personave LGBTI në përcaktimet e krimeve të urrejtjes për mbrojtje më efektive të të drejtave të komunitetit LGBTI.	Kjo është përfshirë tashmë në KP: Neni 70, paragrafi 2.12, dhe neni 141. Ju lutemi të keni parasysh se Strategjia e BE-së e miratuar në nëntor 2020 (Strategjia e Barazisë LGBTIQ 2020-2025) i referohet LGBTIQ-së).	Pranohet plotësisht	Komenti është i saktë. Riformulimi është bërë LGBTIQ.
EU	III.1_Qasja ne drejtesi	52	Analizimi i SMIL për të parë nëse përfshihen të dhënat e nevojshme për të monitoruar dhe raportuar lëndët e krimeve kundër komunitetit LGBTI dhe reflektimi i rekomandimeve të kësaj analize në	Ju mund të nevojitet të merrni në konsideratë zgjerimin e kësaj pjese të lidhur në mënyrë rigoroze me motive paragjyquese që lidhen me LGBTI tek grupet në nevojë dhe pakica të tjera, p.sh. etnike, fetare, etj. Për të përmirësuar regjistrimin, monitorimin, ndjekjen e krimin të urrejtjes si të tillë, në përputhje me qasjen e ECRI.	Refuzohet	Aktiviteti flet për analizim dhe pastaj do të merren veprime tjera, të bazuara në atë analizë.

			SMIL për të mundësuar monitorimin e hetimit, ndjekjes penale dhe dënimit të krimeve kundër komunitetit LGBTI			
EU	III.2_Mjetet juridike	9	Masa e politikës: Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për të siguruar mjete juridike efektive me shikim në shërbimet ligjore dhe të drejtësisë të orientuara kah qytetari	Mund të përfshihen gjithashtu veprime për të adresuar ndalimet e gjata në procedurën paraprake dhe mjetet juridike efektive për to.	Refuzohet	Në Kod janë të përcaktuara kriteret për paraburgim. Me vendimin e GJK konsiderojmë se është eliminuar ky problem.
EU	III.2_Mjetet juridike	24	Përkthimi në mënyrë sistematike i praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së	Zgjidhje më me kosto-efektive dhe pragmatike, siç është bërja e një përzgjedhje të gjykimeve në vend që të përkthehen të gjitha, duhet të konsiderohen pasi kjo zgjidhje duket tejet e shtrenjtë dhe nuk është e qëndrueshme në planin afatgjatë.	Pranohet plotësisht	Aktiviteti është riformuluar 'praktikës së përzgjedhur të GJEDNJ-së'.

EU	III.4_Shoqeria civile	19	Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit i cili parasheh shfrytëzimin e përvojës dhe kapaciteteve të organizatava joqeveritare në trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve, dhe stafit mbështetës në çështjet që lidhen me korrupsionin, krimin e organizuar, qasjen në drejtësi, instrumentet, masat e zbatimit, përmirësimin e standardeve dhe forcimin e mbikëqyrjes së masave kundër korrupsionit.	Nuk pajtohem me këtë rekomandim. Nuk ka ndonjë OSHC të specializuar që të ketë njohuri dhe me aftësi të larta në trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë të caktuar. Organizatat ndërkombëtare janë mjaft të përfshira në ofrimin e trajnimeve dhe njohurive të tilla.	Pranohet plotësisht	Aktiviteti është riformuluar pas diskutimeve me Akademinë e Drejtësisë.
----	-----------------------	----	---	--	---------------------	---

EU	III.5_MD	Koment i përgjithshëm për III.5		Ne rekomandojmë që të shtohet nën këtë kapitull që MD të vazhdojë të kryejë vlerësime të rregullta të sistemit të drejtësisë në Kosovë bazuar në metodologjinë CEPEJ (shih raportin në faqen e internetit të MD-së: https://md.rksgov.net/page.aspx?id=1,79 , në tre gjuhë). Këto vlerësime do të ndihmojnë MD-në në vlerësimin e ndikimit të reformave të saj.	Pranohet plotësisht	
EU	III.5_MD	26	Aftësimi i Divizionit të TI-së për digjitalizimin e tërë sektorit të drejtësisë me qëllim të përfshirjes së Divizionit të TI-së për çështje të caktuara në implementimin e sistemeve të TI në gjyqësor.	Duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit dhe prokurorisë.	Pranohet plotësisht	Aktiviteti është riformuluar.

EU	III.5_MD	28	Ndryshimi i Ligjit për KGJK-në dhe hartimi i Ligjit për Evidencë Qendrore Penale në atë mënyrë që siguron funksionalizimin e plotë të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve dhe garanton qasje të caktuar për MD-në	Kjo është shumë e ngatërruar. Evidenca Qendrore Penale dhe Menaxhimi i Lëndëve janë dy gjëra të ndryshme. Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë në mënyrë të kujdesshme për t'i dhënë MD-së ndonjë rol/qasje në menaxhimin e lëndëve. SMIL është një sistem i rrjedhës së punës në lidhje me lëndët e gjyqësorit dhe prokurorisë së pavarur: nuk duhet të lejohet qasja e asnjë instituti tjetër; institutet e tjera dhe palët e interesit mund të kërkojnë të marrin (rregullisht) vetëm informacione statistikore dhe analitike të gjeneruara.	Pranohet pjesërisht	Koncepti Dokumenti për SEQP është miratuar tanimë nga Qeveria. Shih komentin dhe spjegimet e mëtutjeshme në rreshtin 258. Qasja e MD-së në SMIL do të jetë e kufizuar për qëllime statistikore.
EU	IV.1_Korniza antikorrupsion	16	Hartimi i Ligjit për Kompetencat e Autoriteteve Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Korrupsionit i cili parasheh bashkëpunim të forcuar në mes të të gjithë akterëve të përfshirë në parandalimin dhe luftimin e	Nuk e kuptojmë se si do të nevojitej një ligj i tillë. Kompetencat e autoriteteve shtetërore në luftën kundër korrupsionit janë përcaktuar tashmë qartë në legjislacionin ekzistues. Fokusi duhet të vihet në zbatimin e ligjeve ekzistuese, më shumë sesa në shkrimin e ligjeve të reja.	Pranohet plotësisht	Ky aktivitet është larguar nga Plani i Veprimit.

			korrupsionit dhe përcakton masa të qarta për bashkëpunim.			
EU	IV.1_Korniza antikorrupsion	17	Masa e politikës: Zëvendësimi i Këshillit Kundër Korrupsionit të Presidentit me mekanizëm koordinues në nivel të Qeverisë	Sipas Strategjisë, faqe 34, ky Këshill Koordinues "do të përmirësojë koordinimin e politikave ndër-sektoriale anti-korrupsion për të gjithë qeverinë, pasi është vetë qeveria përgjegjëse për zbatimin e politikës anti-korrupsion". Asnjë nga këto veprime nuk shpjegon konkretisht se si do të bëhet kjo, përtej caktimit të "pikave të kontaktit" që janë gjenerike.	Pranohet plotësisht	Ky aktivitet është larguar nga Plani i Veprimit.
EU	IV.1_Korniza antikorrupsion	22	Masa e politikës: Përmirësimi i punës së Departamentit Special Antikorrupsion (DSAK) në Policinë e Kosovës	Referenca i bëhet Departamentit Special Kundër Korrupsionit/Task Forcës në Policinë e Kosovës, pavarësisht nga zhvillimet e reja me shfuqizimin e Task Forcës, dhe themelimi i Njësisë	Pranohet plotësisht	është shtuar aktiviteti i ri - do të krijohet baza ligjore për bashkëpunim në mes të PSRK-së dhe Njësisë së Veçantë të Hetimeve në PK.

				Speciale të Hetimit të PK-së.		
EU	IV.2_Deklarimi i pasurise	42	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për DP me qëllim të përcaktimit të qartë të mjeteve të brendshme që duhet të shterren, para kualifikimit të mosdeklarimit apo deklarimit të rrejshëm të pasurisë si vepër penale.	Ligji për deklarimin e pasurisë nuk është vendi për rregullimin e veprave penale. Ekziston tashmë një dispozitë në Kodin Penal, neni 430, i cili parasheh që mosdeklarimi i njëhershëm është vepër penale dhe duhet të qëndrojë ashtu siç është. Prandaj, ne rekomandojmë heqjen e këtij veprimi nga Plani i Veprimit.	Refuzohet	Ky është koment i përsëritur (shih rreshtin 112 dhe spjegimet aty)

AD	I.2_Efikasiteti		<p>Hartimi i planit një vjeçar dhe tre vjeçar që përmban nevojat për rekrutim dhe trajnim dhe përcakton politika rigorozë dhe transparente afatmesme dhe afatgjata në përcaktimin e numrit të gjyqtarëve, dhe stafit mbështetës për gjykata.</p>	<p>Plotësim ndryshimi i Ligjit për AD konform Opinioneve dhe Rekomandimeve të Këshillit Konsultativ të Gjykatësve Evropian (KKGJE) dhe Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropian (KKPE), si dhe Rrjetit Evropian për Trajnime Gjyqësore (EJTN), do të siguronte një qëndrueshmëri afatgjate dhe një garanci për zhvillim të vazhdueshëm të profesionalizimit dhe integritetit të sistemit të drejtësisë. Pra, fillimisht duhet të rregullohen kompetenca dhe detyrimet ligjore në lidhje me hartimin e planeve të trajnimit, e posaçërisht në modalitetin e trajnimit fillestar. Aktualisht trajnimin fillestar si gjyqtarët ashtu edhe prokurorët e ndjekin pas dekretimit dhe ky model nuk ka tregu rezultate. Andaj, sikurse është rekomandua në draft strategjinë RFSS në dokumentet e politikave, modaliteti i trajnimit fillestar duhet fillimisht të rregullohet me ligj dhe konform standardeve të institucioneve trajnuese të shteteve të BE-së respektivisht Opinioneve të Këshillit Konsultativ të Gjykatësve Evropian (KKGJE). Është me rëndësi të theksohet se modeli i trajnimit fillestar në AD është i vetmi model i tillë, dhe se shumë shtete që kanë pas të rregulluar këtë formë të</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Ministria e pranon se është e nevojshme të draftohet një ligj i ri për Akademinë. Megjithatë, për përmbajtjen e saktë të tij, do të jetë e nevojshme të përpilohet koncepti dokumenti, për të parë se cilat ndryshime janë me të vërtetë të nevojshme dhe cilat janë nevojat e sistemit në përgjithësi. Prandaj, është shtuar një aktivitet i ri për hartimin e këtij Koncepti Dokumenti</p>
----	-----------------	--	--	---	---------------------	---

				<p>trajnimet e kanë ndryshuar. Parimisht , në trajnim fillestar kandidati duhet të jetë kandidat e jo gjyqtar ose prokuror, ngase kjo bie ndesh me disa parime sikurse është " gjykimi i drejte dhe nga tribunali profesional". Pyetje është se gjyqtari në fazën e trajnimet fillestar a është dhe a konsiderohet profesional, nëse ai ose ajo nuk ka përfunduar provimet përfundimtare në trajnimin fillestar.</p>		
AD	I.2_Efikasiteti		<p>Hartimi i planit një vjeçar dhe tre vjeçar që përmbanë nevojat për rekrutim dhe trajnim dhe përcakton politika rigoroze dhe transparente afatmesme dhe afatgjata në përcaktimin e numrit të prokurorëve dhe stafit mbështetës për prokurori.</p>	- -	Pranohet pjesërisht	<p>Ministria e pranon se është e nevojshme të draftohet një ligj i ri për Akademinë. Megjithatë, për përmbajtjen e saktë të tij, do të jetë e nevojshme të përpilohet koncept dokumenti, për të parë se cilat ndryshime janë me të vërtetë të nevojshme dhe cilat janë nevojat e sistemit në përgjithësi. Prandaj, është shtuar një aktivitet i ri për</p>

						hartimin e këtij Koncept Dokumenti
AD	I.2_Efikasiteti		Trajnimi i gjyqtarëve në fusha të specializuara komerciale.	AD ka miratuar Programin Trajnues Kornize (2021-2022) pjesë e këtij programi është edhe kurrikula trajnuese për të drejtën komerciale. AD në bashkëpunim me projektin e USAID-it për të drejtën komerciale, në parim ka vendosur të realizojë 7 trajnime gjatë vitit por ky program është fleksibil ku sipas nevojave dhe kërkesave mund të përfshije edhe numër më të lartë të trajnimeve. Aktualisht janë duke u trajnuar 16 profesioniste nga fusha komerciale, që pas përfundimit të trajnimit për trajner do jenë trajnues për stafin dhe gjyqtarët e gjykatës komerciale	Pranohet pjesërisht	Ndonëse ka filluar trajnimi i trajnerëve, është me rëndësi që në Planin e Veprimit të mbetet masa me të cilën planifikohet që të bëhet trajnimi i gjyqtarëve.
AD	I.2_Efikasiteti		Trajnimi i ndërmjetësuesve, edukimi i stafit të gjykatave dhe nëpunësve të	Ligji për AD specifikisht përcakton se trajnimet për profesionet e lira dhe profesionistet e tjerë ligjore, përjashtimisht gjykatave dhe prokurorive, bëhet me kërkesë të institucionit përkatës dhe me	Pranohet plotësisht	Pranohet rekomandimi; Ligji i ri për AD-në do të japë edhe këtë mundësi për të trajnuar edhe profesionet e lira, kur

			ndërmjetësimi për referim të rasteve	mbulimin e shpenzimeve të trajnimit. Ndoshta do të ishte më e drejtë që të plotësohet ligji dhe t'u lejohej të gjitha profesioneve të lira që të ju ofrohen trajnimet në shpenzime të AD		kjo është e nevojshme, me qëllim të unifikimit të interpretimeve
AD	I.3_Profesionalizmi		Ndryshimi i Ligjit për KPK për të i mundësuar punën Prokurorëve të dekretuar, gjatë periudhës së trajnimit fillestar	Ndryshimet legislative që kanë ndodhë në Ligjin për Gjykatat dhe rekomandimi për ndryshimin e Ligjit për KPK, që gjyqtarët, respektivisht prokurorët gjatë vijueshmërisë në trajnim fillestar janë në kundërshtim me Opinionet dhe Rekomandimet të Këshillit Konsultativ të Gjykatësve Evropian (KKGJE) dhe Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropian (KKPE), si dhe Rrjetit Evropian për Trajnime Gjqësore (EJTN). Ngase Opinioni i KKGJE për trajnim fillestar të gjyqtareve thotë si ne vijim "që të gjithë të emëruarit në poste gjyqësore duhet të kenë apo të arrijnë, para se të fillojnë detyrën, njohuri gjithëpërfshirëse të së drejtës materiale vendore dhe ndërkombëtare dhe procedurave". Pra, vet fakti që konform legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon trajnimin fillestar, pas trajnimit teorik dhe praktik mbahet provimi/testi përfundimtar ku kushti i arritshmerisë është 41 pike nga 100, nënkupton se gjyqtarët / prokurorët	Pranohet plotësisht	Pranohet komenti. Wshtë fshirë rekomandimi për KPK-në. Për KGJK-në nuk ka pasur rekomandim të këtillë.

				në trajnim fillestar nuk munden të trajtohen si të gatshëm dhe të trajnuar për detyrat e gjyqtarit dhe prokurorit. Duhet të ketë kujdes se kjo praktikë mund të paraqet probleme serioze në proceset euro integruese të Kosovës, kur është fjala për sundimin e ligjit.		
AD	I.3_Profesionalizmi		Hartimi i ligjit të veçantë për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të gjitha instrumentet dhe mundësitë e zhvillimit në karrierë, dhe qartëson kompetencat në mes të KGJK-së, KPK-së dhe AD-së.	Ligji në fjalë duhet të jetë në harmoni të plotë me Kartën Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, e që paraqet një nga dokumentet themelore i cili përcakton disa standarde dhe shërben si bazë për secilën demokraci të re për t'iu përmbajtur kërkesave të saj minimale. Ajo është përpiluar për t'i mbuluar të gjithë komponentët kryesorë të zhvillimit të karrierës siç është rekrutimi, trajnimi, karriera dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve, si dhe sistemi disiplinor që i drejton ato (shih dokumentin e politikave Ngritja e profesionalizmit dhe kompetencës në sistemin gjyqësor dhe Prokurorial Draft dokumenti RFSS)	Pranohet plotësisht	Pranohet dhe rekomandimi do të merret parasysh edhe gjatë hartimit të Koncept Dokumentit për këtë Ligj, në në të cilin edhe AD do të ketë rol qenësor.

AD	I.3_Profesionaliz mi		Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve në sistemin gjyqësor i kryer në 3-5 vitet e fundit.	<p>Kompetencat në këtë fushë janë të paqarta, dhe mund të interferojnë në detyrimet dhe obligimet e secilës palë. AD në kompetencë të saj vazhdimisht i raporton Kryesuesit, Komisionit për vlerësim të performancës dhe Kryetarëve të gjykatave në lidhje me vijueshmërinë dhe pjesëmarrjen në trajnime të gjyqtarëve. Deri më tani nuk ka ndonjë praktikë nga ana e këshillit, apo edhe e komisionit të performancës në lidhje me trajnimet e realizuara, pra nuk ka komunikim në këtë fushë. Kujtojmë se, Këshilli Drejtues i AD përbëhet nga 4 anëtar të sistemit gjyqësorë duke përfshi nga një përfaqësues të secilit nivel të gjykatave duke filluar nga Supremja, Apeli, Themeloria dhe një përfaqësues i Sekretarit të Këshillit gjyqësorë të Kosovës. Si dhe 4 anëtar nga Sistemi Prokurorial ku baza e përfaqësimit është e njëjtë. Kompetence ligjore e këtij këshilli është vlerësimi dhe aprovimi i të gjitha programeve të trajnimit, të trajnueseve, mentorëve, planit të punës, buxhetit dhe gjitha të tjerat. Në kuptimin e kornizës ligjore të zbatueshme tani, AD udhëhiqet, menaxhohet dhe raporton gjitha instancave më të larta të sistemit</p>	Pranohet pjesërisht	Pas diskutimit me AD dhe KGJK, pranohet pjesërisht dhe do të adresohet gjatë hartimit të Koncept Dokumentit dhe Ligjit për AD, për t'u siguruar që të sqarohen kompetencat dhe të mos ketë mbivendosje. Në planin e veprimit parashihet AD si institucioni i parë bartës.
----	----------------------	--	--	---	---------------------	---

				gjqësorë dhe Prokurorial të vendit, dhe krijimi e mekanizmave tjerë për trajnime nga këshillat është një ndërhyrje në mandatin ligjore te AD, dhe kjo mund të paraqesë një vështirësi të madhe në punën profesionale të AD si institucion profesional për trajnime.		
AD	I.3_Profesionalizimi		Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve në sistemin Prokurorial i kryer në 3-5 vitet e fundit.	Komenti i njëjtë si komenti më lartë.	Pranohet pjesërisht	Pas diskutimit me AD dhe KGJK, pranohet pjesërisht dhe do të adresohet gjatë hartimit të Koncept Dokumentit dhe Ligjit për AD, për t'u siguruar që të sqarohen kompetencat dhe të mos ketë mbivendosje. Në planin e veprimit parashihet AD si institucioni i parë bartës.

AD	I.3_Profesionalizimi		Hartimi i planeve të trajnimit për fushat që janë identifikuar si mangësi të zakonshme të prokurorëve gjatë vlerësimit të performancës në sektorin e drejtësisë.	Duhet të rregullohet me akt nënligjorë konform ligjit për AD, dhe atë me hartimin e rregullores për trajnime të vazhdueshme që do të përfshinte edhe komunikimin zyrtarë në bazë të kompetencës me komisionin përkatës	Pranohet pjesërisht	Pas diskutimit me AD dhe KGJK, pranohet pjesërisht dhe do të adresohet gjatë hartimit të Koncept Dokumentit dhe Ligjit për AD, për t'u siguruar që të sqarohen kompetencat dhe të mos ketë mbivendosje. Në planin e veprimit parashihet AD si institucioni i vetëm bartës.
AD	I.3_Profesionalizimi		Ofrimi i trajnimeve të specializuara për gjyqtarë në fushat e identifikuar si mangësi gjatë vlerësimit të performancës.	Komenti i njëjtë si komenti më lartë.	Pranohet pjesërisht	Pas diskutimit me AD dhe KGJK, pranohet pjesërisht dhe do të adresohet gjatë hartimit të Koncept Dokumentit dhe Ligjit për AD, për t'u siguruar që të sqarohen kompetencat dhe të mos ketë mbivendosje. Në planin e veprimit parashihet AD si institucioni i vetëm bartës.

AD	I.3_Profesionalizimi		Krijimi i burimeve online për zhvillim profesional për personelin e sektorit të drejtësisë.	Kjo tashme ekziston dhe është funksionale në AD , por nuk shfrytëzohet nga gjyqtarët.	Pranohet plotësisht	Aktiviteti është riformuluar në "avansimi dhe pasurimi i burimeve online..."
AD	I.3_Profesionalizimi	Propozim për aktivitet të ri		"Ndryshimi i ligjit për AD-në në mënyrë që të mundësoje nxjerrjen e akteve nënligjore të tjera , të rregullohet kompetenca e organeve drejtuese, komisioneve të përhershme, organizimin dhe strukturimin e brendshëm konform nevojave për trajnime kualitative , veprimtarisë botuese, veprimtarisë hulumtuese etj. Kompetencën në organizimin dhe strukturimin e brendshëm për stafin profesional , stafin teknik, trajnuesit e përhershëm , trajnuesit dhe ekspertet e përkohshëm, mentorët/tutorët. (Ndryshimet ligjore duhet të përfshijnë standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare)." Kolona si me larte , si koment është shtuar nga AD: Ndryshimi i ligjit për AD-në duhet të përfshijë dhe rregullojë në mënyrë më të qartë dhe të harmonizuar, Trajnimin Fillestar, Trajnimin i Vazhdueshëm, Trajnimet për Trajner TT, Trajnimet e Specializuara. Trajnimet për Avancim, Trajnimet për Stafin administrativ të	Pranohet plotësisht	Është shtuar aktiviteti i ri

				Gjykatave dhe Prokurorive Trajnimet për Profesionet e Lira, Trajnimet në Distance, si dhe Trajnimet e Detyrueshme (trajnimet e rekomanduara nga KGJK, KPK dhe komisioneve të performancës).		
AD	I.3_Profesionalizimi	25	Realizimi i një analize mbi nevojën për specializim të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ana e AD në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në.	Nëse nuk rregullohet me akte nënligjore kjo kompetence dhe bashkëpunim atëherë duhet të ketë një marrëveshje bashkëpunimi ku do të qartësohen obligimet dhe detyrimet e secilës palë.	Pranohet pjesërisht	Kjo çështje është adresuar bashkë me komentet e mësipërme për nevojën e sqarimit të kompetencave midis AD dhe KGJK-së e KPK-së, përmes Koncept Dokumentit dhe Ligjit të ri.
AD	I.3_Profesionalizimi	27	Përdorimi i pajisjeve moderne (panelevë inteligjente) gjatë dhe pas trajnimit për të vlerësuar njohuritë e të trajnuarve dhe aftësinë e tyre për të marrë pjesë (ose	Duhet të rregullohet me akte ligjore, ngase kjo do të ishte ndërhyrje në edukimin profesional të gjyqtarit respektivisht prokurorit. Pra, ky objektivi duhet të jetë në harmoni me Opinioneve të KKEGJ dhe KKEP së , si dhe me ligjin për gjykatat.	Pranohet pjesërisht	Nuk është e nevojshme që një gjë e tillë të jetë e rregulluar me ligj, por mund të rregullohet me aktet nënligjore të AD-së, pas miratimit të ligjit të ri.

			jo) në module më të përparuara.			
AD	I.3_Profesionalizmi	28	Zgjerimi i programit të trajnimeve për të përfshirë module në TI, gjuhën angleze, juridiksionin e GJEDNJ dhe shkencat shoqërore.	Këto trajnime janë në programin trajnues të AD së, dhe në vazhdimësi përditësohen, por gjyqtarët dhe prokurorët shumë pak i përdorin këto trajnime . Trajnimet janë vullnetare dhe si të tilla është Diskrecioni i gjyqtarit prokurorit të vendose se a donë të marr pjesëajo me lejen e mbikëqyrësit.	Pranohet pjesërisht	Kjo është shënuar edhe në dokumentet e politikave. Komenti është më shumë konstatim i tyre. Megjithatë, rekomandimi është që të zgjerohen këto programe.
AD	I.3_Profesionalizmi	29	Bordi Menaxhues i ADK dhe Bordi Programatik të shqyrtojnë situatën e mundshme të konfliktit të interesit kur vendosin për programin vjetor të trajnimit, ndërsa më vonë ligjërojnë në të njëjtat module të programit, duke përfituar financiarisht nga ai.	Plotësim dhe ndryshimi i ligjit për AD , por edhe nevoja e plotësimit të ligjit për gjykatat dhe prokurorinë është e domosdoshme. Përveç anëtarëve të Këshillit Drejtues të AD, anëtarëve të Këshillit Programor, anëtarëve të komisioneve të AD -së, anëtarëve të Këshillave si gjyqësorë dhe Prokurorial , komisioneve për trajnime të këshillave, anëtarëve të komisioneve për vlerësim të performancës, duhet të rishikohet çështja e konfliktit të interesit. Në AD si trajnerë janë të angazhuar shumë pjesëtarë të këtyre organeve, përjashtimisht të këshillit Drejtues ku	Pranohet pjesërisht	Kjo çështje do të analizohet në Koncept Dokumentin e paraparë për Akademinë e Drejtësisë.

				nuk ka angazhohen në trajnime. Pra çështja është të kompensimi ku duhet qartë të definohet se kush mund të kompozohet e kush jo , kjo çështje është jetike për AD. Andaj duhet të shikohen modelet dhe kriteret se duhet të rregullohet kompensimi.		
AD	I.3_Profesionalizmi	32	Përcaktimi i kriterëve të rrepta dhe të qarta për zgjedhjen e mentorëve.	Mentorët propozohen nga KGJK dhe KPK ndërsa miratohen nga Këshilli Drejtues i AD. Aktualisht kriteret janë rregulluar me rregullore të AD, dhe konsiderojmë se kriteret duhet të përcaktohen me ligje apo me plotësim ndryshimin e ligjit për AD .	Pranohet plotësisht	
AD	II.2_Ngritja e profesionalizmit ne luften e k.o	12	Hartimi i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për të përcaktuar arsimimin e vazhdueshëm ligjor të detyrueshëm për prokurorë dhe gjyqtarë	Do të duhej që në grupin punues për hartimin e ligjit të përfshihet edhe AD	Pranohet plotësisht	Është shtuar edhe AD tek institucionet përgjegjëse, në kuadër të PV.
AD	II.2_Ngritja e profesionalizmit ne luften e k.o	13	Zgjerim i Platformës Elektronike të AD, për të përmbajtur më shumë module	Platforma E learning apo e mësimit në distance është aktive, dhe deri më tash ka 18 kurse trajnimi online. Kjo mënyrë e të mësuarit duhet të rregullohet me akte nënligjore ndoshta në aktin nënligjor	Pranohet pjesërisht	Është pranuar por aktiviteti mbetet, meqë ai rekomandon që të bëhet "zgjerimi i Platformës"

			të trajnimeve online	respektivisht Rregulloren për trajnime të vazhdueshme e cila pritet të nxirret pas plotësimit ndryshimin e ligjit për AD.		
AD	II.2_Ngritja e profesionalizmit ne luften e k.o	Koment per masen e politikës ne pergjithesi	Masa e politikës: Forcimi i pavarësisë së institucioneve gjyqësore	Do të duhej të përfshihet edhe AD, pra fuqizimi i AD është i domosdoshëm si garanci për ngritje profesionale	Pranohet plotësisht	AD është shtuar në të gjitha aktivitetet që ndërlidhen drejtpërdrejtë me punën e saj.
AD	III.1_Qasja ne drejtesi	19	Nënshkrimi i një Memorandumi të Mirëkuptimit në mes të ANJF dhe AD për zhvillimin dhe realizimin e një programi të trajnimit të përbashkët për gjyqtarët, prokurorët dhe zyrtarët e ndihmës juridike të ANJF me qëllim të rritjes së kapaciteteve për ofrimin e ndihmës juridike falas, dhe të kuptuarit më të mirë nga ana e gjyqtarëve të nocionit të "interetit të drejtësisë" me	Përveç MM, do të ishte me efikase sikur ANJF të përfshihet në Ligjin për AD si kategori përfituese, ngase me ligjin aktual nuk janë	Pranohet pjesërisht	Në parim është pranuar. Kjo do të analizohet në fazën e Koncept Dokumentit.

			<p>rastin e caktimit të përfaqësimit juridik falas.</p>			
AD	Koment i pergjithshem			<p>Gjithashtu , ju lutem qe nëpërmes këtij emaili te pranoni edhe komentin e përgjithshëm ne lidhje me planin e veprimit i cili nuk është ne përputhje me dokumentet e 20 marsit te vitit te kaluar, ku edhe i kam bashkangjitur ne këtë email. Nga cka kemi vërejte ne është se , Plani i Veprimit nuk është ne përputhje me dokumentin Masat e Politikave i cili nga Grupi Punues ishte aprovuar ne Mars te vitit 2020 , dhe ne nuk kemi mund te kuptojmë sa çka ka ndodhe ndërkohë, pra është fjala per masat dhe politikat qe afektojnë Akademinë e Drejtësisë. Andaj ju lutemi qe te i</p>	Refuzohe t	<p>Aktivitetet e vendosura në Planin e Veprimit janë aktivitete që kanë evoluuar pas disa grupeve punuese, si dhe procesit të konsultimeve të brendshme me partnerët tanë. Gjithashtu, shumë aktivitete janë ndryshuar për t'i përditësuar ato me nevojat aktuale si dhe masat që tashmë janë</p>

				rishikoni masat dhe politikat e rekomanduara dhe mundësisht të i harmonizoni me planin e veprimit, gjithashtu shpresojmë se komentet tona do të merren në konsideratë.		ndërmarrë nga institucionet. Prandaj, rikthimi në draftin e parë nuk është i nevojshëm apo edhe i preferueshëm.
KGJK	Koment i përgjithshëm			KGJK në komentet e dërguar ka propozuar që kur të trajtohen ndryshimet ligjore të Ligjit mbi KGJK dhe Ligjit mbi Gjykata të shqyrtohen edhe çështjet e tjera të cilat e afektojnë punën e gjyqësorit, dhe u japin mundësi palëve të i realizojnë të drejtat e veta (shih propozimet plotësuese nën pikën 1.3.1.1). KGJK konsideron se përgjegjja e Ministrisë se këto çështje do të trajtohen në plane të ardhshme të veprimit është e pamjaftueshme dhe jo e arsyeshme për dy arsye. Si pikë e parë, nëse ligji amendamentohet për një çështje është me e arsyeshme që të adresohen të gjitha problemet apo paqartësitë në ligj në të njëjtën kohë, sesa të kërkohet ndryshimi apo amendamenti i ligjit me vite rradhazi. Kjo përveç se shkakton	Refuzohet	Nuk ka analizë paraprake për këtë propozim, që ka kaluar në strukturat e RFSSL. Pas diskutimeve me KGJK-në është vendosur që kjo çështje mos të adresohet në këtë fazë.

				<p>humbje kohore gjithashtu i zvarritë problemet praktike pa nevojë. Dhe nën dy, MD gjatë zhvillimit të analizave është dashur të i përfshijë të gjitha çështjet kritike në analizat e bëra në mënyrë që të sigurojë trajtimin e problemeve në mënyrë të thuktë. Këto çështje janë ngritur nga gjyqtarët në vazhdimësi, pse nuk janë përfshirë në dokumente të analizave nuk është arësytim i mjaftueshëm për të i anashkaluar ato tani. Nëse ka nevojë për informacione shtesë dhe arësytim të këtyre çështjeve ju lutem na informoni dhe KGJK është i gatshëm të i jap me shkrim arësytimet dhe shpjegimin se pse këto çështje janë problematike dhe pasojat e mostrajtitimit të tyre. KGJK synon të i trajtojë të gjitha çështjet akute në mënyrë kontinuele dhe sistematike si dhe të i ikë stuhisë së përsëritjes ciklike të problemeve.</p>		
KGJK	I.4_Integriteti	25	<p>Akti nënligjor i cili propozohet të hartohet në pikën 1.4.2.1, parasheh konceptin e lojës së roleve në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve të rinj, ku një kandidat ballafaqohet me</p>	<p>Sa i përket qëndrimit të MD-së lidhur me rekoamndimin 1.4.2.7 KGJK konsideron se propozimi i KGJK-së për ta ridefinuar aktivitetin në asnjë rast nuk e përjashton konceptin e lojës, mirëpo e bën gjuhën më fleksibile duke i dhënë mundësi Komisionit Rekrutues në raste të ndryshme të aplikojë edhe metodologji të tjera gjatë</p>	Pranohet pjesërisht	<p>është riformuluar aktiviteti dhe është sqaruar që koncepti i lojës së roleve nuk është e vetmja metodë e vlerësimit (ndër të tjera) por se intervistat duhen të jenë në përputhje me sistemin</p>

			probleme të jetës reale si pjesë e testimit të kriterëve të përzgjedhjes.	intervistimit. Insistimi se vetëm një metodologji është metodologjia e duhur për përmirësimin e procesit të intervistimit paraqet një qëndrim të ngurtë dhe jo domosdoshmërisht të arsyeshëm. Për më tepër komentet e KGJK-së në këtë dokument paraqesin qëndrimin e gjyqësorit të Republikës së Kosovës dhe paraqesin qëndrimet e të gjithë gjyqtarëve, dhe jo vetëm disa prej tyre.		'competency-based questioning'
--	--	--	---	---	--	--------------------------------

KGJK	I.4_Integriteti	33	<p>Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores (02/2013) për procesin e rekurimit, emërimit dhe rrimërimit të prokurorëve me qëllim të përcaktimit të listës objektive dhe gjithëpërfshirëse të kriterëve për vendim-marrje sipas së cilave KPK mund të refuzojë të zbatojë rekomandimet e Komisionit për Emërime dhe detyrimin të KPK-së për të arsyetuar me shkrim refuzimin e rekomandimeve të Komisionit.</p>	<p>Në lidhje me komentin e MD-së rreth propozimit të KGJK-së lidhur me rekomandimin 1.4.2.18 , KGJK konsideron se një vendim i tillë mund të hartohet. Mirëpo duhet të jetë e qartë që ai vendim nuk mund të arsyetojë votën e fshehtë, dhe si i tillë do të jetë i kufizuar dhe opinioni publik duhet të njoftohet me kohë lidhur me kufizimet në mënyrë që të mos vihet askush në lajthitje. Për më tepër, Këshilli gjatë procesit të rekrutimit plotëson shumë më tepër se standardet minimale të transparencës, për arsye se i tërë procesi i rekrutimit që nga fazat e para deri të votimi monitorohet nga partnerët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile. Çështja këtu nuk është se a dinë apo dojnë gjyqtarët të hartojnë apo arsyetojnë vendime. Esenca është se Komisioni mund të i propozojë dy kandidatë dhe Këshilli me vota të fshehta zgjedhë kandidatin. Nuk dihen arsyetimet apo arsyet se si apo pse anëtarët kanë votuar ashtu si kanë votuar. Andaj një kërkesë e tillë e Ministrisë për Këshillin dhe anëtarët e Këshillit nuk është në pajtim me ligjin si dhe me procedurat e përzgjedhjes së shumë posteve publike në vend. Këshilli në asnjë rast nuk pranon të marrë</p>	Refuzohet	<p>Aktiviteti i propozuar kërkon që KGJK të japë sqarime në rastet kur vendimi për rekrutim apo avancim shkon kundër rekomandimit të Komisionit për Emërime. KGJK ka refuzuar këtë aktivitet duke thënë se nuk mund të zbatohet në praktikë meqë votimi për këto vendime bëhet me vota të fshehta. MD ishte pergjigjur se votimi i fshehtë e bën atë më të vështirë për t'u zbatuar, por jo të pamundur. Është e kuptueshme që një rekomandim i këtillë mund të jetë i vështirë për t'u zbatuar, por jo i pamundur. Bazuar edhe në diskutimet me grupet punuese, një arsyetim i këtillë është tejet i nevojshëm dhe shihet si një standard</p>
------	-----------------	----	---	--	-----------	--

				<p>përgjegjësi të cilat nuk do të mund të i zbatojë në mënyrë të plotë. Andaj ky rekomandim duhet të rihjekur apo duhet riformuluar në tërësi.</p>		<p>minimal që duhet përmbushur drejt transparencës. Gjyqtarët tashmë kanë praktikë të përditshme të arsyetimit të vendimeve, edhe në rastet e paneleve prej më shumë gjyqtarëve. Në raste të tilla gjyqësore, edhe nëse njëri nga gjyqtarët nuk pajtohet me gjetjet e të tjerëve, megjithatë jepet arsyetimi i shumicës, pa e identifikuar gjyqtarin mospajtues. Prandaj, duke qenë rekomandim shumë i rëndësishëm dhe i cili do të ndikonte dukshëm në transparencën e KGJK-së, ky aktivitet është vendosur të mbetet.</p>
--	--	--	--	--	--	---

KGJK	I.4_Integriteti	34	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligji për KGJK ashtu që të parashihet mundësia për ankesë në Gjykatë Supreme, për kandidatët të pakënaqur me vendimin përfundimtar të emërimit nga KGJK.	Përkitazi me rekomandimin 1.4.2.20 të definohet si në vijim: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për KGJK për të paraparë një procedurë efektive dhe të shpejtë për ankesa për kandidatët të cilët nuk janë përzgjedhur nga KGJK	Pranohet plotësisht	Aktiviteti është riformuluar dhe parasheh mundësinë e ankesës me procedurë të përshpejtuar në Gjykatën Supreme.
KGJK	III.1_Qasja ne drejtesi	37	Të miratohet një ligj i veçantë për shpenzimet dhe tarifatat gjyqësore me qëllim të ngritjes së transparencës në lidhje me shpenzimet për drejtësi.	Përkitazi me komentet e MD-së lidhur me rekomandimin III.1.2.10 – KGJK dëshiron të sqarojë se është e gatshme të i trajtojë të gjitha mundësitë për të përmirësuar sigurinë juridike për të gjithë. Dhe nëse MD konsideron se rregullorja nuk mjafton për të siguruar këtë granaci atëherë ligji mund të jetë zgjidhje. Mirëpo duke sqaruar se MD është në lajthitje kur konstaton se baza ligjore nuk është e përshtatshme për arsye se Ligji mbi KGJK-në e autorizon Këshillin të nxjerrë urdhëresë administrative për të përcaktuar tarifatat gjyqësore. Për më tepër kjo është e parapraë edhe me ligjet tjera bazë. Për më tepër shih Ligjin për KGJK, Neni 7, paragrafi 1, pika 1.20., si dhe Kodin i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 450,	Pranohet pjesërisht	Pas diskutimeve me KGJK-në, është sqaruar se me legjislacionin primar do të rregullohen standardet dhe margjinat për përcaktimin e shpenzimeve dhe tarifave, kurse KGJK sërish do të ketë mundësinë me akt nënligjor të caktoj dhe ndryshoj shumën e saktë të tyre.

				<p>paragrafi 3.</p> <p>Për më tepër është me rëndësi që të përmendet se rregullimi i kësaj çështje me ligj i pamundëson gjykatave apo Këshillit të trajtojnë situata të reja të cilat nuk parashihen me ligj. Çdo risi e paraqitur në praktike do të kërkonte ndryshim të ligjit përmes Kuvendit, i cilid natyrisht do të merrë shumë më tepër kohë.</p>		
KGJK	III.5_MD	26	Aftësimi i Divizionit të TI-së për digjitalizimin e tërë sektorit të drejtësisë me qëllim të përfshirjes së Divizionit të TI-së për çështje të caktuara në implementimin e sistemeve të TI në gjyqësor.	Sa i përket rekomandimit K III.5.3.5.5.1 dhe riformulimit të propozuar nga MD, KGJK konsideron se përfshirja e MD-së në implementim të sistemeve të IT në gjyqësor është e panevojshme. MD mund të jetë e informuar lidhur me këto procese mirëpo praktikisht nuk do të mund të ketë rol aktiv në implementim. Përveç kur është fjala tek ndërlidhja e bazës së të dhënave me institucione të tjera.	Pranohet plotësisht	Aktiviteti është riformuluar. MD do të ketë vetëm kompetenca dhe qasje të kufizuar.
KGJK	III.5_MD	28	Ndryshimi i Ligjit për KGJK-në dhe hartimi i Ligjit për Evidencë Qendrore Penale në atë mënyrë që siguron funksionalizimin e plotë të Sistemit për Menaxhimin	Dhë krejt në fund sa i përket rekomandimit 3.5.5.3 dhe zëvendësimit të fjalës “qasje të hapur” me “qasje të kufizuar” nuk është i majftueshem dhe duhet zgjeruar më tej për të shpjeguar se qasja ka të bëjë vetëm me qasjen në shikimin e të dhënave statistikore e	Pranohet plotësisht	Kjo është sqaruar gjatë takimeve bilaterale me KGJK-në.

			Informativ të Lëndëve dhe garanton qasje të caktuar për MD-në	cila nuk cenon punën dhe pavarësinë e gjyqësorit		
KGJK	Koment i përgjithshëm	Koment në pjesën narrative të Strategjisë		Në takimin e mbajtur me datën 29 dhjetor, 2021 në mes të përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, KPK -së dhe KGJK-së, u vendos që të caktohet një grup si bashkëudheheqës (co-heads) pjesë e të cilit do të ishin Ministri i Drejtësisë, Kryesuesi i KGJK-së dhe ai i KPK-së. Presim që kjo çështje të trajtohet në dokumentin e strategjise finale	Pranohet plotësisht	Tashmë është reflektuar.
KGJK	Koment i përgjithshëm	Koment në pjesën narrative të Strategjisë		Në faqen 8 të strategjisë ceket si qësthje problematike ndarja e lëndëve dhe mungesa e kriterëve për ndarjen e lëndëve. Duhet reflektuar puna të cilën gjyqësori e ka realizuar gjatë vitit 2020 përmes së cilës është adaptuar shpërndarja automatike e lëndëve. Mendojme se për të hartuar një strategji të zbatueshme duhet të njihen dhe pranohen edhe sukseset e realizuara në ndërkohë si dhe progresi i shënuar në lëmi të caktuara. Kjo e bën strategjinë një dokument të kohshëm	Pranohet plotësisht	Është reflektuar në pjesën narrative.

				dhe aktual. Ju lutëm referojuni dokumentit të hartuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë në shpërndarjen automatikë të lëndëve dhe përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e lëndëve.		
KGJK	Koment i përgjithshëm	Koment në pjesën narrative të Strategjisë		Në faqen 10 të stegjisë thuhet se “Uebfaqet e institucioneve nuk janë të plota dhe të dhënat kontaktuese të paraqitura në to, shpesh nuk janë të qasshme. Dëshirojmë të cekim se një konstatim i tillë është i pasaktë dhe si i tillë duhet të mënjanohet për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Fajqa e KGJK-se dhe gjykatave është e përditësuar në të shumtën e rasteve, publikohet një numër i madh i të dhënave dhe informacioni kontaktues për gjykata është i përditësuar. Fajqa e KGJK-se prinë sa i përket funksionalitetit, përdorueshmërisë dhe informacionit të përditësuar.	Pranohet plotësisht	Ndërkaq, komentet e UE-së më sipër përmendin faktin se informatat në gjuhët tjera mungojnë ose janë të pasakta. Prandaj, ky propozim duhet vënë në përputhje edhe me komentet e UE-së për versionet në gjuhët tjera.

KGJK	Koment i përgjithshëm	Koment në pjesën narrative të Strategjisë		<p>Në faqen e 11 të strategjisë, ceket siq vijon, “Planifikimi i justifikuar për transferim të gjyqtarëve nuk bëhet dhe metodologjia e vlerësimit të gjyqtarëve për promovimin e tyre nuk është e qartë. KGJK-së, në procesin e promovimit të gjyqtarëve, me rregulla i mundësohet diskrecion i pa-arsyeshëm të zgjedh kandidatët të cilat janë vlerësuar më ulët”.</p> <p>Shumica e thënjëve të përmbledhura në këtë fjali janë jo të sakta. KGJK qartazi vendosë mbi transferimin e gjyqtarëve nga një gjykatë në tjetrën. Transferimi i përkohshëm bëhet për qëllim të përmirësimit të efikasitetit, ndërsa transferimi i përhershëm në bazë të kërkesës së gjyqtarëve duke pasur parasysh nevojat e asaj gjykate. Për më tej duket skjaruar se transferimi nuk është promovim mirëpo është lëvizje horizontale nga një gjykatë në tjetrën. Cdo promovim bëhet përmes një procesi të hapur dhe konkurrues. Andaj praktikën dhe rregullat duhet reflektuar në dokument të strategjise. Konstatime të pasakta vëjnë në lajthitje opinionin publik. Gjyqësori ka mjet probleme egzsituose dhe nuk ka nevojë të sajohen të reja.</p>	Pranohet plotësisht	<p>Është pranuar dhe reflektuar në tekst. Komentin është bazuar në dokumentin e poliikave mbi Integritetin, në të cilin shpalosen brengat për mungesë të transparencës në këto procese. Megjithatë, shumica e ketyre janë spjeguar nga KGJK dhe janë rregulluar me rregulloret e brendshme.</p>
------	-----------------------	---	--	---	---------------------	---

KGJK	Koment i pergjithshem	Koment në pjesën narrative të Strategjisë		<p>KGJK në komentet e dërguar ka propozuar që kur të trajtohen ndryshimet ligjore të Ligjit mbi KGJK dhe Ligjit mbi Gjykata të shqyrtohen edhe çështjet e tjera të cilat e afektojnë punën e gjyqësorit, dhe u japin mundësi palëve të i realizojnë të drejtat e veta (shih propozimet plotësuese nën pikën 1.3.1.1). KGJK konsideron se përgjegjja e Ministrisë se këto çështje do të trajtohen në plane të ardhshme të veprimit është e pamjaftueshme dhe jo e arsyeshme për dy arsye. Si pikë e parë, nëse ligji amendamentohet për një çështje është me e arsyeshme që të adresohen të gjitha problemet apo paqartësitë në ligj në të njëjtën kohë, sesa të kërkohet ndryshimi apo amendamenti i ligjit me vite rradhazi. Kjo përveq se shkakton humbje kohore gjithashtu i zvarritë problemet praktike pa nevojë. Dhe nën dy, MD gjatë zhvillimit të analizave është dashur të i përfshijë të gjitha çështjet kritike në analizat e bëra në mënyrë që të sigurojë trajtimin e problemeve në mënyrë të thuktë. Këto çështje janë ngritur nga gjyqtarët në vazhdimësi, pse nuk janë përfshirë në dokumente të analizave nuk është arësytim i mjaftueshëm për të i anashkaluar ato tani. Nëse ka</p>	Refuzohe t	Komenti i njëjtë me atë më sipër për çështjen e pagave.
------	-----------------------	---	--	--	------------	---

				<p>nevojë për informacione shtesë dhe arësytetim të këtyre çështjeve ju lutem na informoni dhe KGJK është i gatshëm të i jap me shkrim arësytetimet dhe shpjegimin se pse këto çështje janë problematike dhe pasojat e mostrajtimin të tyre. KGJK synon të i trajtojë të gjitha çështjet akute në mënyrë kontinuele dhe sistematike si dhe të i ikë stuhisë së përsëritjes ciklike të problemeve.</p>		
KGJK	I.2_Efikasiteti	25	<p>Hartimi i planit për të adresuar vonesat në procedura dhe periudhat e pasivitetit tek gjyqtarët.</p>	<p>Më tej tëk Plani i Veprimit, Kapitulli I (1.2) qëndron kjoë fjali: “Hartimi i planit për të adresuar vonesat në procedura dhe periudhat e pasivitetit tek gjyqtarët.” Ju lutemi që fjalia të riformulohet dhe të mënjanohet pjesa ku thuhet “periudha e pasivitetit tëk gjyqtari”. Kjo pjesë e fjalisë është e paqarte dhe thjeshtë tendencioze. Mekanizmat e monitorimit, përfshirë zbatimin e normës orientuese dhe monitorimi i performancës masin produktivitetin e gjyqtarit. Andaj kjo pjesë nuk ka asnjë lloj sensi logjik për të mbetur në strategji. Për më tepër KGJK përmes SMIL-it është dukë e zhvilluar Dabsboardin apo pasqyrën e</p>	Pranohet plotësisht	<p>Aktiviteti është riformuluar duke thënë "pasiviteti I lëndës" në vend të pasivitetit të gjyqtarit.</p>

				performancës dhe produktivitetit për cdo gjytarë të gjykatës përkatëse e cila do të shërbejë si mjet për monitorim të performancës.		
KGJK	I.4_Integriteti	Masa e Politikës: Aftësimi i KGJK-së dhe KPK-së për ruajtjen e integritetit gjyqësor		Tek Masa e politikës: Aftësimi i KGJK-së dhe KPK-së për ruajtjen e integritetit gjyqësor. Këshilli Gjyqësor qendron prapa propozimit të dhënë më herët që në rregullore mos të definohet vetëm një lloj i metodologjisë dhe që të ridefinohet gjuha. Në këtë rast rregullorja len hapësirë për aplikimin e metodologjive të tjera interaktive të cilat kanë për qëllim matjen e pregaditjes së kandidatit për të qenë gjyqtarë. Insistimi se vetëm një metodologji është metodologjia e duhur për përmirësimin e procesit të intervistimit paraqet një qëndrim të ngurtë dhe jo domosdoshmërisht të arsyeshëm. Për më tepër komentet e KGJK-së në këtë dokument paraqesin qëndrimin e gjyqësorit të Republikës së Kosovës dhe paraqesin qëndrimet e të gjithë gjyqtarëve, dhe jo vetem disa prej tyre	Pranohet plotësisht	Komenti I njëjtë me më sipër. Pranohet dhe riformulohet për të sqarur "competency based".

KGJK	I.4_Integriteti	41	<p>Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores (15/2016) për transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve me qëllim të prezantimit të detyrimit për intervistim të të gjithë kandidateve për transferim të përhershëm dhe detyrimit për mbajtjen e intervistës edhe në rrethanat kur ekziston vetëm një kandidat.</p>	<p>Nën kapitullin 1.4. të strategise është paraqitur ky rekomandim, Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores (15/2016) për transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve me qëllim të prezantimit të detyrimit për intervistim të të gjithë kandidateve për transferim të përhershëm dhe detyrimit për mbajtjen e intervistës edhe në rrethanat kur ekziston vetëm një kandidat.” Ajo që shpërfaqet në këtë pikë është mungesa e informacionit të hartuesve të strategjisë. Natyrisht që intervistat mbahen vetëm kur ka më tepër kandidatë dhe kërkesa për të pasur intervista për transfer është e paevojshme kur egziston vetëm një kandidatë. Kandidati i interesuar lëvize në formë horizontale nga e njëjta pozitë në të njëjtën, dhe në asnjë rast nuk mund të jetë promovim. Intervistat mbahen vetëm atëherë kur ka më tepër kandidatë për të ju mundësuar kandidatit më të mirë që të zgjedhet. Natyrisht se të gjitha transferet shpallen dhe lidhur me transfere informohen të gjithë kandidatët. Mirëpo nuk ka nevojë për të zhvilluar procese administrative të cilat në esencë janë të panevojshme.</p>	Pranohet plotësisht	<p>Pranohet dhe do të fshihet. Komenti është bazuar në dokumentin e poliikave mbi Integritetin, në të cilin shpalosen brengat për mungesë të transparencës në këto procese. Megjithatë, shumica e ketyre janë spjeguar nga KGJK dhe janë rregulluar me brendshme.</p>
------	-----------------	----	---	--	---------------------	---

KGJK	III.2_Mjetet juridike	10	Hartimi i analizës për format për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme për të përcaktuar mjete juridike efektive për çështjet që përfshijnë vonesa në procedimet gjyqësore, ku do të analizohen mundësi si ankesa në Gjykatën Kushtetuese, ankesa në gjykatën e shkallës më të lartë, mjetet juridike përshpejtuese dhe kompensuese dhe mjetet juridike specifike në fushën e gjyqësisë penale, si dhe kompetencat ligjore të Avokatit të Popullit për të filluar procedurë gjyqësore në rastet kur mjetet juridike janë joefektive, drejtpërdrejt në	Ne Kapitullin e III (3.2) rekomandimi është pak I stejzgjeruar dhe konfuz, nuk sqaron se cka duhet të përfshihet në rekomandim. Andaj do të ishte mirë që si I tillë të rishikohet dhe skjarohet.	Pranohet plotësisht	Rezultati i aktivitetit është riformuluar duke theksuar se do të hartohet një Koncept Dokument për këtë çështje.
------	-----------------------	----	---	---	---------------------	--

			Gjykatën Kushtetuese			
--	--	--	-------------------------	--	--	--

KGJK	III.2_Mjetet juridike	11	Miratimi i Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që të avancohen të drejtat për informim dhe interpretim në fushën e gjyqësisë penale, në përputhje me standardet e BE-së, si dhe të bëhet rritja e numrit të mjeteve juridike në dispozicion dhe efektivitetit të shtuar të mjeteve juridike për mosfunksionimet e sistemit të drejtësisë lidhur me të drejtat e të pandehurve në procedurë penal	Situatë e ngjashme është me rekomandimin në vijim në të njëjtin kapitull. Rekomandimi thotë si në vijim	Refuzohet	Drafti aktual nuk e ka përfshirë këtë rekomandim mbi kartën e të drejtave që duhet të jetë në dispozicion për qytetarë. Rekomandimi është i qartë dhe konkret, dhe është në përputhje me kërkesat e <i>acquis</i> .
KGJK	III.5_MD	13	Ndryshimi i Rregullores Nr.31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë ashtu që të parashihet themelimi i	Në këtë rekomandim duhet cekur qartë se është fjala për hartimin e ligjeve dhe në asnjë mënyrë ky rekomandim nuk ka të bëjë me hartimin, shqyrtimin apo ndryshimin e rregulloreve, udhëzimeve administrative apo vendimeve të Këshillit. Mekanizmat për shqyrtimin	Pranohet plotësisht	Një gjë e tillë është e qartë nga kompetencat e Ministrisë, por do të qartësohet edhe një herë në momentin ndryshimit të Rregullores në fjalë.

			Departamentit për Politikat legislative të gjyqësorit	e legjislacionit sekondar janë të parapara me legjislacionin në fuqi.		
KGJK	III.5_MD	26	Aftësimi i Divizionit të TI-së për digjitalizimin e tërë sektorit të drejtësisë me qëllim të përfshirjes së Divizionit të TI-së për çështje të caktuara në implementimin e sistemeve të TI në gjyqësor.	Siq e kemi cekur edhe më herët dhe po e ripërsërisim se rekomandimet në kaputillin III.5. 3.5.5. konsiderojme se përfshirja e MD-së në implementim të sistemeve të IT në gjyqësor është e panevojshme. MD mund të jetë e informuar lidhur me këto procese mirëpo praktikisht nuk do të mund të ketë rol aktiv në implementim. Përveç kur është fjala tek ndërlidhja e bazës së të dhënave me institucione të tjera.	Pranohet plotësisht	Kjo është sqaruar dhe specifikuar gjatë takimeve bilaterale me KGJK-në.
KGJK	III.5_MD	28	Ndryshimi i Ligjit për KGJK-në dhe hartimi i Ligjit për Evidencë Qendrore Penale në atë mënyrë që siguron funksionalizimin e plotë të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve dhe garanton qasje të caktuar për MD-në	Objektivi për ndryshimin e ligjit supozohet të jetë bartja e Evidencës Qendrore Penale tek Ministria e Drejtësisë. KGJK nuk është në pajtim me këtë rekomandim. Asgjë në Ligj tani nuk e kufizon funksionalizimin e plotë të sistemit për menaxhimin Informativ të Lëndëve. E as qasjen e limituar për Ministrinë e Drejtësisë. Duke pasur parasysh këtë KGJK konsideron se ky rekomandim duhet mënjanuar.	Refuzohet	Koncept Dokumenti i cili tashmë është aprovuar në Qeveri, në lidhje me themelimit të Sistemit të Evidencës Qendrore Penale (SEQP), rekomandon që të bartet ky sistem nën ombrellën e MD-së. Kjo mbështetet nga fakti se edhe 25 shtete të tjera të BE-

						së e kanë këtë sistem nën menaxhimin e MD-së dhe është i rëndësishëm ndër të tjera për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështje penale, që është kompetencë koordinuese e MD-së.
GLPS	Koment i përgjithshëm			Ne SSSL mungon një lidhje në mes të institucioneve tjera të cilat janë përgjegjëse në sundimin e ligjit në vend. Këto institucione paraqesin hallka kryesore në këtë sektor. Bëhet fjalë për Doganën e Kosovës, Agjencia për Intelegjencë Financiare, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Agjencinë Kosovare të Intelegjencës. Propozim: Dy opsione: 1) SSSL të jetë e fokusuar dhe të përfshijë vetëm Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, gjykatat dhe prokuroritë, Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Akademinë e Drejtësisë, ndërsa të draftohen strategji tjera në kuadër të funksionimit të institucioneve tjera për sundimin e ligjit 2) SSSL të jetë	Refuzohet	Strategjia është dizajnuar në atë formë për të ofruar analizë të detajuar të probleme në fushën e sundimit të ligjit dhe insitucioneve përgjegjëse përmes hartimit të dokumenteve të politikave të cilave i'u kanë paraprirë një mori konsultimesh. Duke marrë për bazë gjetjet dhe rekomandimet e dala nga Dokumentet e Politikave dhe pjesëmarrjen aktive të të gjitha

				<p>gjithpërfshirëse dhe të përfshijë edhe institucionet tjera përgjegjëse në këtë sektor, siç janë Dogana e Kosovës, Agjencia për Intelegjencë Financiare, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Intelegjencës, dhe në këtë mënyrë të kemi një strategji gjithëpërfshirëse për të gjitha institucionet që i përkasin këtij sektorimungon një lidhje në mes të institucioneve tjera të cilat janë përgjegjëse në sundimin e ligjit në vend.</p>		<p>insitucioneve që mirren me fushën e Sundimit të Ligjit, dokumentet e politikave nuk kane identifikuar probleme për të cilat mund të ndër marrin aktivitetet dhe masa lidhur me insitucionet e përmendura nga GLPS</p>
--	--	--	--	--	--	--

GLPS	I.2_Efikasiteti	32	Hartimi i Ligjit për Gjykatën Komeriale	Krijimi i një mekanizmi të ri si Gjykata Ekonomike, është i panevojshëm si mjet për qartësimin e kompetencave në mes të departamentit Ekonomik dhe atij Administrativ ekzistues. Për më tepër, krijimi i kësaj gjykate do të duplikonte punën e departamenteve ekzistues dhe në praktikë do të krijonte më shumë probleme në zgjidhjen e kontesteve. GLPS propozon miratimin dhe zbatimin e projektligjit për Zgjidhjen e Konflikteve Administrative në vend të krijimit të Gjykatës Komeriale	Pranohet pjesërisht	Krijimi i Gjykatës Komeriale nuk e duplikon punën e departamenteve ekzistuese (Ekonomik dhe Administrativ) dhe nuk e ngarkon sistemin e drejtësisë por e e profilizon edhe më tutje të njëjtin. Për më tepër do të paraqes garancë dhe siguri juridike për investitorët e jashtëm dhe benefetiet që kemi me I pasë prej themelimit të kësaj Gjykatë, e arsyetojnë krijimin e një mekanizmi të tillë. Vecse është miratuar nga USAIDI dhe përkrahur nga donatorët e tjerë të huaj, përfshirë edhe Odat Ekonomike Sa I përket komentit për Ligjin për Konfliktet Administrative, i njëjti pranohet dhe është reflektuar në Strategji dhe Plan të Veprimit
------	-----------------	----	---	--	---------------------	---

GLPS	I.3_Profesionaliz mi	10	Hartimi i ligjit të veçantë për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të gjitha instrumentet dhe mundësitë e zhvillimit në karrierë, dhe qartëson kompetencat në mes të KGJK-së, KPK-së dhe AD-së.	GLPS propozon dy opsione: 1) Draftimi dhe miratimi i ligjeve të veçanta të cilët do të rregullonin të gjitha elementet që lidhen me stausin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këto ligje do të përfshinin: procedurën dhe kriteret e rishikuara të rekrutimit, procedurën dhe kriteret për transferim, procedurën dhe kriteret për avancim, procedurën e vlerësimit të performancës, procedurën dhe kriteret për pezullim, procedurën dhe kriteret për përfundimin e mandatit, procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. 2) Të plotësohet dhe ndryshohet korniza aktuale ligjore ashtuqë të forcohen dhe të rishikohen elementet e cekura në opsionin e parë, mirëpo në legjislacionin ekzistues duke mos miratuar ligje të reja.	Pranohet plotësisht	Strategjia dhe Plani i Veprimit kanë paraparë fillimisht hartimin e një koncept dokumenti i cili do të shërbejë si bazë për miratimin e një ligji të veçantë për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili do të unifikonte dhe qartësonte dispozitat mbi statusin, instrumentet dhe mundësitë për zhvillim në karrierë, dhe përgjegjësitë specifike të institucioneve karrshi këtyre profesionistëve.
------	----------------------	----	---	---	---------------------	--

	I.3_Profesionalizmi			<p>SSSL nuk trajton çështjen e trajnimeve të obligueshme dhe impaktin e tyre nëse të njëjtat nuk vijohen rregullisht siç është përcaktuar me Rregullore të KGJK-së, dhe propozimet alternative për ndryshimin e sistemit ekzistues për trajnimin e vazhdueshëm dhe të detyrueshëm të gjyqtarëve.</p> <p>Strategjia injoron në tërësi nevojën e trajnimeve për prokurorët. Në SSSL nuk permendet as elementi i mbajtjes dhe dëshmimit të standardit profesional për ruajtjen e statusit të gjyqtarit dhe prokurorit dhe pasojat e mos ruajtjes se këtij standardi.Propozim: krijimin e një sistemi për indetifikimin e nevojave për trajnime specifike duke u mbështetur në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe në vlerësime të rregullta për trajnime specifike që dalin si nevojë e miratimit të legjislacioni të ri në nivel nacional dhe ndërkombëtarë.</p>	Refuzohet	<p>Strategjia qartazi thekson përshtatjen dhe dizajnimin e programeve të tranimit profesional me nevojat specifike të sektorit e cila do të mundësohej përmes përdorimit të të dhënave nga vlersimet e performancës, duke identifikuar kështu mangësitë profesionale, reformimit dhe rishikimit të vazhdueshëm të kurrikulave nga Akademia e Drejtësisë, dhe bashkëpunimit të KGJK-së, KPK-së dhe Akademisë në hartimin e kurrikulave moderne. Për më tepër plani i veprimit dhe Dokumentet e Politikave i kane paraparë veprimet konkrete që synojnë trajnimin e vazhdueshëm të</p>
--	---------------------	--	--	---	-----------	--

						gjyqtarëve dhe prokurorëve. Plani i veprimit dhe dokumentet e politikave elaborojnë edhe më tutje këto nevoja
GLPS	I.3_Profesionalizmi	18,19,20 - Masat që kanë të bëjnë me performancën e gjyqtarëve dhe prokurorëve		SSSL dështon ta identifikojë se cilat janë mekanizmat e vlerësimit të performancës dhe cilat janë pasojat kur performanca është e dobët, në linjë me Rregulloren e re të miratuar nga KGJK në vitin 2021. Propozim: forcimi i mekanizmave për vlerësimin e performancës dhe vendosja e një sistemi të vlerësimit i cili bazohet në indikatorë jo vetëm sasior po edhe cilësor i cili ofron një pasqyrë të qartë të punës profesionale të gjyqtarit dhe	Refuzohet	ekzitojne masa dhe gjitahshtu rregulloret e reja te KGJK-se dhe KPK-se per matjen e performances I reflektojne keto standarde

				prokurorit të përcjellur edhe me pasoja juridike nëse performanca është e dobët dhe negative, dhe i cili avancohet sistemin aktual.		
GLPS	I.4_Integriteti			SSSL ka dështuar të tregojë se si ndryshimi i përzgjedhjes së anëtarëve të këshillave, me mandat të përhershëm dhe më me përvojë, do të ndikojë në rritjen e integritetit të gjyqësorit. sistemi i vetingut i paraparë dështon të përfshijë edhe anëtarët aktual të këshillave, si gardian mbrojtës të integritetit të gjyqësorit. Strategjia nuk parasheh pasoja për persona që dështojnë të kalojnë këtë proces verifikimi si dhe pasoja për personat të cilët nuk i nënshtrohen të nejjtit. SSSL nuk ofron qartësi për pastërtinë e vet ekspertëve të cilët do të ishin bartës të këtij procesi, si dhe mënyrën e përzgjedhjes së tyre. SSSL nuk e përcakton nëse barra e provës do të bie mbi këtë mekanizëm, prokurorinë apo subjektin e procesit (gjyqtarin apo prokurorin). Propozim:	Pranohet pjesërisht	Aktivitetet që janë përfshirë në Strategji nuk e japin përgjigjen finale për modalitetet e vetingut, por bën thirrje që të disejnohet një sistem për verifikim të vazhdueshëm dhe të rregullt të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe stafit mbështetës. Aktivitetet specifike do të vendosen në Plan të Veprimit në përputhje me Koncept Dokumentin që është duke u zhvilluar për vetingun në sistemin e drejtësisë.

				<p>vetimin/verifikimin e të gjithë personave që janë pjesë e institucioneve të sektorit të sundimit të ligjit dhe që kanë rrezik të lartë për vepra penale të korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, për të i'u nënshtruar sistemit të vetingut. Të miratohet një bazë e veçantë kushtetuese/ligjore e cila do të përcaktonte mekanizmat, përbërjen, kompetencat, modelin dhe pasojat juridike të procesit të vetingut. Ky proces do të duhej zhvilluar në disa faza ku faza e pare do të përfshijë riskun më të lartë tek subjektet që i nënshtrohen vetingut, dhe pastaj të vazhdojë me pjesën e mbetur në mënyrë konsistente dhe periodike. Nje sistem vettingu do të ishte i domosdoshëm edhe në fazen e hershme të pranimin të subjektve që do të bëhen pjesë e institucioneve të sektorit të sundimit të ligjit. këtij procesi duhet t'i nënshtrohen edhe vet anëtarët aktual të këshillave. Përveç vendosjes së sistemit të vetingut, duhet te rregullohen edhe pasojat juridike që i bartin subjektet të cilët dështojnë të kalojnë të njejtin dhe apo refuzojnë t'i nënshtrohen këtij procesi. Përsonat të cilët supozohet të jenë bartës të procesit</p>	
--	--	--	--	--	--

				të vetingut duhet të jenë verifikuar para sa të marrin një funksion të tillë.		
GLPS	IV.2_Deklarimi i pasurise			SSSR dështon të ofrojë argumente dekriminalizimin e mosraportimit të pasurisë duke parashikuar të njejtën si shkelje administrative/disiplinore. Dështimi i prokurorisë në ndjekjen e kësaj vepre dhe dështimi i gjyqësorit në dënimin e saj nuk ofron argument të qëndrueshëm për dekriminalizimin e saj. Ky veprim incentivon zyrtarët që të mos e respektojnë obligimin e deklaramit të pasurisë së tyre duke pranuar cilëndo gjobë apo masë disiplinore. Për më tepër, gjykatave gjithmonë u është rekomanduar të i	Refuzohet	nuk është synimi të ndryshohet Kodi Penal por të ofrohen sanksione Administrative për të cilën ka hapësira ligjorë që lejojnë rikualifikimin e mosraportimit të pasurisë si shkelje administrative dhe/ose disiplinore

				<p>shqyrtojnë me prioritet këto lëndë meqenëse lidhen direkt me korrupsionin, dhe për të njejtat të shqiptohen dënime efektive.</p> <p>Propozim: Veprat penale lidhur me deklarimin e rreme dhe mosdeklarimin e pasurisë duhet të qëndrojnë dhe duhen ndjekur nga prokuroria me seriozitet. Të njejtat duhet të shqyrtohen me prioritet dhe të dënohen shkelësit.</p>		
GLPS	III.3_Profesionet e lira			<p>SSRL nuk ka ofruar asnjë opsion lidhur me zingjirin llogaridhënës në mes të MD, odave dhe vetë profesionistëve të licencuar duke mos ofruar zgjidhje konsistente tek profesionet e lira. Në startegji aspak nuk diskutohen mekanizmat e vlerësimit për licencim nga ana e MD-së (procedura e provimit me shkrim dhe me gojë, kriteret e vlerësimit, objektiviteti i komisionit vlerësues, etj.). Propozim: 1) vendosjen e mekanizmave të qartë të llogaridhënies në MD (sipas standardeve që përcaktohen nga odat ndërkombëtare të profesioneve të lira), odave dhe vetë profesionistëve të licencuar duke vendosur edhe mekanizmin e inspektimit të tyre; 2) vendosjen e kriterëve dhe procedurave objektive dhe të bazuara në meritë me rastin e</p>	Pranohet plotësisht	<p>Pavarësisht aktiviteteve në Planin e Veprimit lidhur me profesionet e lira që kontribuojnë në propozimet e GLPS-së, Ministria pajtohet që këto çështje duhet të analizohen tutje dhe aktivitetet konkrete do të reflektohen në planin e veprimit në vitet në vijim.</p>

				licencimit nga MD të bartësve të cilët ushtrojnë profesionet e lira.		
GLPS	III.5_MD	27	Ndryshimi i Rregullores Nr.31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë ashtu që të parashihet themelimi i Divizionit të Analitikës dhe Monitorimit Statistikor.	SSSL ka propozuar krijimin e një Divizioni të Analitikës dhe Monitorimit statistikor brenda MD me qëllim të pajisjes së Ministrisë me të dhëna empirike, të nxjerra me metoda të mirëfillta shkencore, të cilat do t'i ndihmojnë asaj në politikbërje më të mirë si për gjyqësorin ashtu edhe për të gjithë sistemin e drejtësisë. Një përgjegjësi e tillë veçse është nën kompetencën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili është institucion që përmban në vete Njësinë e Statistikave me përgjegjësi të njejtë. Krijimi i një mekanizmi të tillë brenda MD vetëm do të duplikonte një kompetencë të tillë. Për më tepër, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucioni i specializuar me këtë përgjegjësi, si formë e ushtrimit të funksionit të administrimit dhe mbikqyrjes. Ndërsa, MD është institucion përgjegjës në politikbërje dhe i njejt mund të i shfrytëzojë informatat e	Refuzohe t	Koncept Dokumenti i cili tashmë është aprovuar në Qeveri, në lidhje me themelimin e Sistemit të Evidencës Qëndrore Penale (SEQP), rekomandon që të bartet ky sistem nën ombrellën e MD-së, për arsytet e theksuara aty.

				<p>mbledhura në formë zyrtare nga KGJK dhe të i raportojë tek palët e treta, përfshirë dhe institucionet ndërkombëtare. Propozim:të forcohet komunikimi dhe shkëmbimi i obligueshëm i informatave në mes të këtyre institucioneve (KGJK, KPK dhe MD) dhe të ketë afate të përcaktuara qartësisht në ligj për raportimin dhe publikim e statistikave që mund të i shërbejnë MD, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme, etj. për politikbërje dhe raportim tek institucionet tjera ndërkombëtare, ose çështje tjera të ngjashme.</p>		
Policia	II.4_Policia	10	Amandamenti i Ligjit për Policinë ashtu që të përfshihet Sigurimi i jetës dhe shëndetit për zyrtarët policor	<p>Të merret vendim nga Qeveria i cili ofron sigurimin jetësor dhe Shëndetësor për Zyrtarët Policor. Qeveria e Republikës së Kosovës të angazhohet për gjetjen dhe miratimin e një sistemi adekuat të sigurimit jetësor dhe shëndetësorë për zyrtarët policor</p>	Refuzohet	<p>Sigurimi jetësor dhe shëndetësor për zyrtarët Policorë duhet të rregullohet me Ligj në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia dhe qendrueshmëria e sigurimit të jetës dhe shëndetit. Rregullimi me Ligj i skemës së sigurimit jetësor dhe shëndetësor për zyrtarët policor ofron garanci më të madhe juridike.</p>

Policia	II.4_Policia	13	Përmirësimi i mekanizmave koordinues në mes të PK dhe IPK lidhur me auditimin e brendshëm, vlerësimin e rrezikshmërisë, parregullsive të dokumenteve identifikuese	te largohet fjala auditim ashtu që në vend të auditimit të brendshëm të zëvendësohet me fjalën inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme si dhe nuk ka kuptim fjalia shtesë lidhur me dokumentet identifikuese andaj propozojmë të heqet ky pasus.	Pranohet plotësisht	Pranohet komenti dhe është reflektuar në Planin e Veprimit
Policia	II.4_Policia	12	Përditësimi i strategjisë për marrëdhënie me publikun për përdorim më të mirë të mediave sociale në ndërtimin e raporteve me publikun	të zëvendësohet me fjaline "Hartimi dhe përditësimi i strategjisë..."	Pranohet plotësisht	Pranohet komenti dhe do të reflektohet në Planin e Veprimit
Policia	II.4_Policia	15	Ndërmarrja e Inspektimeve nga IPK/PK në policinë e zonës së Ferizajit lidhur me sjelljet e pahijshme në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen siç duhet shkaktarët kryesor.	të hiqet në tërësi ky objektiv sepse mendojmë se është temë e tejkaluar.	Pranohet plotësisht	Pranohet komenti dhe do të reflektohet në Planin e Veprimit

Policia	II.4_Policia	16	Amandamentimi i Ligjit për Policinë që autorizon DSP të ndërmerr testimet të integritetit për policinë.	Nuk ka të bëjë me amandamentimin e Ligjit për Policinë sepse kjo ka të bëjë direkt me stafin/ personelin e IPK-së. Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Neni 20 parasheh Masat e veçanta për mbledhjen e të dhënave. Njëra ndër masat e parapara në këtë Ligj është edhe hetimi i integritetit, prandaj kjo qështje është e paraparë më Ligjin për IPK-në dhe se është e gabuar kjo të parashihet të rregullohet me plotësim ndryshim të Ligjit të Policisë.	Refuzohet	Për diskutimet me Policinë, aktiviteti ka mbetur meqë është konstatuar se ndërmarrja e testeve të integritetit nga vetë Policia është i nevojshëm.
Policia	II.4_Policia	20	Hartimi i Udhëzimit Administrativ i cili përcakton procedurën për punë të përbashkët, përfshirë këtu zhvillimin e hetimeve të përbashkëta, brenda drejtorateve të Policisë dhe zhvillimin e hetimeve të përbashkëta ndërkombëtare.	Hartimi i udhëzimit administrativ të përfshij edhe agjencitë tjera dhe po ashtu të parashikoj hetimin dhe bashkëpunimin edhe brenda vendit dhe po ashtu edhe ndërkombëtar. Hartimi i akteve juridike i cili parasheh themelimin dhe funksionimin e ekipeve të përbashkëta të hetimeve në nivel ndërinstitucional por edhe ndërkombëtarë.	Pranohet plotësisht	Pranohet komenti dhe do të reflektohet në Planin e Veprimit

Policia	II.4_Policia	21	Veting i përmirësuar dhe përputhshmëri me kodin e etikës	<p>kur të vendoset për këtë koncept të zbatohet sipas Koncept dokumentit dhe Ligjit - ose të fshihet në tërësi. Stafi i Policisë i nënshtrohet dy lloje të verifikimit/ vetingut:</p> <p>A) Verifikimit të së kaluarës dhe</p> <p>B) Verifikimit të Sigurisë</p> <p>A) VERIFIKIMI I SË KALUARËS- është një proces i verifikimit i cili kryhet nga vet Policia respektivisht Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së kaluarës. Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së kaluarës është e autorizuar të bëjë këto verifikime të së kaluarës për Policinë e Kosovës në këto 9 raste – situata:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.) Per punësim – rekrutim seleksionim; 2.) Për rikthim në punë; 3.) Për promovim (në secilën gradë) 4.) Për avancim në detyrë dhe sistemim përmes procesit të konkursit, njësi te specializuara. 5.) Për anëtarët e Komisioneve të brendshme (të gjitha, disiplinor/ ankesave) 6.) Për trajnim dhe shkollim jashtë vendit? (është bërë me heret, është rast i rralë) 7.) <p>Për shkollim të lartë në Fakultetin e</p>	Refuzohet	Pas diskutimit me Policinë është vendur që testimi i integritetit nga vet Policia është i nevojshëm.
---------	--------------	----	--	--	-----------	--

				<p>Sigurisë-AKSP;</p> <p>8.) Për shkollim dhe specializim me marrëveshje të organizatës;</p> <p>9.) Me kërkesë të drejtorit të Përgjithshëm për verifikime të veçanta.</p> <p>B) Verifikimi i Sigurisë: Kryhet nga AKI sipas Legjislacionit në fuqi dhe këtij verifikimi/ vetingu i nënshtrohen të gjithë zyrtarët të cilët kanë qasje në informacione të klasifikuara pavarësisht pozitës dhe rankut. Ky lloj verifikimi zakonisht zhvillohet për nivelin konfidencial I cili kryhet çdo 10 vite dhe verifikimi i nivelit sekret i cili kryhet çdo 5 vite.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

Policia	II.4_Policia	22	Ndryshimi i Ligjit për Policinë për themelimin e Këshillit të Etikës	Të fshihet në tërësi. E paqartë Këshilli I etikës si koncept.	Refuzohet	Dokumenti i politkavembi Policinë (nr.8) e shtjellon më në detaje idenë e themelimit të një Këshilli të Etikës, i cili do të funksiononte si një trup këshillëdhënës për dilemat etike të policëve. I njëjti Këshill, në formate të ndryshme, do të shërbejë edhe për dilemat etike të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Policët, të cilët mund të hasin në një dilemë etike në punën e tyre të përditshme, mund t'i drejtohen këtij Këshilli për një opinion paraprak, në mënyrë që të mund të parandalohet shkelja e Kodit të Etikës. Në të njëjtën kohë, kjo do të ofronte siguri për policin i cili ka marrë një opinion paraprak nga Këshilli për dilemën specifike etike.
---------	--------------	----	--	---	-----------	--

Policia	II.4_Policia	23	Trajnime të etikës nga AKSP për anëtarët e PK-së, që përfshijnë simulime të dilemave etike	Fjala nga propozojmë fjalën NË AKSP, sepse trajnimet mbahen nga Policia e jo nga AKSP.	Pranohet plotësisht	Pranohet komenti dhe do të reflektohet në Planin e Veprimit.
Policia	II.4_Policia	26	Ndryshimi i Ligjit për Policinë për përcaktimin e masave për zyrtarët policorë që dështojnë në verifikim.	Nuk ka nevojë për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të Policisë, ne propozojmë vetëm që të zbatohet Ligji për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë	Refuzohet	Pas diskutimit me Policinë është konstatuar se testimet e integritetit duhet të bëhen nga Policia dhe ndaj zyrtarëve që dështojnë në verifikim duhet të zbatohen këto masa.
Policia	II.4_Policia	27	Ndryshimi i Ligjit për Policinë për përcaktimin e kontrollin të integritetit për anëtarët e Policisë që parasheh ndërmarrjen e kontrolleve të rregullta pesë-vjeçare të integritetit pas vetingut fillestar.	të fshihet në tërësi sepse nuk ka nevojë të bëhet plotësim ndryshim i Ligjit për Policinë sepse kjo është e paraparë me Planin e Integritetit në Policinë e Kosovës 2021-2025.	Refuzohet	Shih arsyetimin në komentin paraprak.

Policia	Koment i pergjithshem		Përmirësimi i punës së Departamentit Special Antikorrupsion (DSAK) në Policinë e Kosovës.	Kjo njësi është shuar me vendim të Qeverisë dhe në vend të saj është themeluar Njësia e Veçantë e Hetimeve.	Pranohet plotësisht	Pranohet komenti dhe do të reflektohet në Planin e Veprimit
NjIF	Koment i pergjithshem			Qeveria e Republikës së Kosovës në dhjetor 2020 ka aprovuar Planin e Veprimit të rekomanduar për përmirësimin e Sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave/ Luftimit e Financimit të Terrorizmit. Me qëllim të adresimit të disa nga aktivitetet e këtij Plani të Veprimit, të cilat ndërlidhen me sundimin e ligjit, rekomandojmë që të njëjtat të shqyrtohen dhe të vlerësohet nëse janë adekuate për përfshirje në Planin e Veprimit të Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit.	Refuzohet	PV i NjIF është tashmë i miratuar nga Qeveria dhe prandaj nuk është e nevojshme që të integrohet në një Strategji tjetër.
Advancing Together	Koment i pergjithshem			Të konsiderohen si grupe të cenuara të kthyerit/personat e zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës.	Refuzohet	është e vërtetë që kjo kategori ka nevojë për vëmendje dhe masa të veçanta për realizimin e të drejtave të tyre, mirëpo procesi i RFSSL nuk e ka pasur në fushëveprimin e saj të drejtpërdrejtë këtë kategori. Masat që do të ndërmerren do të trajtohen me

						dokumente të tjera të politikave dhe ligjore të Qeverisë.
Advancing Together	Koment i pergjithshem			- Qasja në drejtësi: Çështja e njoftimit është shqetësuese në shumë procedura dhe institucione ligjore në lidhje me procedurat gjyqësore, legalizimin, privatizimin, likuidimin dhe shpronësimin e tokës, siç është theksuar në Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Pronësore. Shumica e anëtarëve të komuniteteve pakicë, personat e zhvendosur dhe të kthyerit nuk janë në gjendje të marrin informacionet e publikuara mbi këto procese. Si pasojë, vjen deri te humbja e afateve të caktuara për ankesa dhe padi, duke rezultuar në mos arritjen e të drejtave pronësore.	Refuzohet	Kjo çështje nuk është analizuar në kudër të procesit të RFSSL. E njehta do të trajtohet në raport me politikën e ardhshme të Qeverisë për të drejtat pronësore.

Advancing Together	Koment i pergjithshem			<p>Qasja në drejtësi: procedurat në të cilat personat e zhvendosur jashtë Kosovës janë të pandehur para gjykatave në Kosovë shpesh kryhen në mungesë të tyre, me emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm. Cilësia e përfaqësimit të përkohshëm të personave të zhvendosur nuk është në një nivel të kënaqshëm, pasi shumica e vendimeve nuk janë në favor të tyre. në këtë drejtim, rekomandohet të zvogëlohen rastet kur përfaqësuesit e përkohshëm caktohen për të përfaqësuar interesat e personave të zhvendosur në procedurat gjyqësore dhe të krijohet një mekanizëm i përgjegjësishëm për të siguruar që, në rastet kur duhet të emërohen përfaqësues të përkohshëm, përfaqësimi që ata ofrojnë është i një cilësie të mjaftueshme për të mbrojtur të drejtat e këtyre</p>	Refuzohet	Shih komentin paraprak.
Advancing Together	Koment i pergjithshem			<p>Në mënyrë që të sigurohet e drejta për gjykim brenda një kohe të arsyeshme për çështjet e pronës civile të anëtarëve të komunitetit të kthyer, personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, është e nevojshme të themelohet departament i veçantë (brenda Gjykatës Themelore të Prishtinës) që do të merret vetëm me këto çështje.</p>	Refuzohet	Shih komentin paraprak.

				Gjyqtarët mund të trajnohen në mënyrë shtesë për të sjellë efikasitet dhe cilësi në procesin e vendimmarrjes. Me zgjidhjen e këtyre lëndëve do të lehtësoheshin edhe procedurat për kthim sipas Rregullores (QRK)-NR.01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme.		
Advancing Together	Koment i pergjithshem			Një seri masash janë të nevojshme gjithashtu për të siguruar që të kthyerit, personat e zhvendosur dhe komunitetet jo-shumicë të kenë qasje në drejtësi: a. Të korrigjohen kriteret e pranueshmërisë për ndihmën juridike falas nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, për të përfshirë personat e zhvendosur dhe personat që jetojnë në vendbanimet joformale, siç është rekomanduar edhe nga Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore; b. Të rritet numri i përkthyesve dhe cilësia përkthimit; c. Të rritet cilësia e përfaqësimit të përkohshëm për personat e zhvendosur dhe të sigurohet që gjykatat të zbatojnë Manualin për Zbatimin e Procedurave Kontestimore dhe të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse në përcaktimin e adresave të të zhvendosurve jashtë Kosovës para emërimit të përfaqësuesve të	Pranohet pjesërisht	çështja (a) pritet të shqyrtohet në Koncept Dokumentin e planifikuar për ndihmën juridike falas; për çështjen (b) janë paraparë aktivitete në Planin e Veprimit të Strategjisë që synojnë rritjen e kualitetit të përkthimit; ndërsa çështjet tjera të ngritura do të trajtohen në politikën e ardhshme të Qeverisë për të drejtat pronësore.

				<p>përkohshëm; d. Ministria e Drejtësisë të ndryshojë Nenin 7.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/02 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, përmes së cilës personat e zhvendosur në kushte të vështira ekonomike të lirohen nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore, siç është rekomanduar edhe nga Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore; e. Të përmirësohen procedurat e njoftimit për procedurat gjyqësore për personat e zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës në mënyrë që ata të mos humbin afatet e caktuara për ankesa dhe padi.</p>		
RrGK	Koment i përgjithshëm			<p>Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, dhe Planin e Veprimit të BE-së për Barazi Gjinore, rekomandojmë që të gjithë indikatorët e hartuar në planin e veprimit, të ndahen sipas gjinisë (Referencat si qytetarëve ose qytetare, të jenë të ndara në burra dhe gra). Rrjedhimisht, sipas gjinisë duhet të ndahet edhe baza e të dhënave, targeted dhe synimet afatmesme, psh, në vend të - Numri i prokurorëve, të ndahet në - Numri i prokurorëve gra dhe burra, apo në rastin e gjykatësve.</p>	Pranohet pjesërisht	Pranohet pjesërisht sa i përket bazës së të dhënave dhe është reflektuar në Plan të Veprimit.

RrGK	Koment i pergjithshem			Nje theks më i thellë duhet të shtohet pergjatë tërë strategjisë dhe logjikës së intervenimit, kundrejt viktimave te dhunes ne baza gjinore dhe qasjes se tyre ne drejtesi. Ne vijim, ne kemi dhene disa rekomandime mirepo per te dhena dhe perfshirje me substanciale, ju rekomandojme qe te bazoheni ne linqet te cilat ju kemi bashkangjitur.	Pranohet plotësisht	Do të shtohet theksi në këto kategori.
RrGK	Koment i pergjithshem			Në dokumentin e Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit, faqe 3, pas tekstit <i>“Në mënyrë specifike, hartimi i kësaj Strategjie është paraparë në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë, Planin e Dokumenteve Strategjike, Agjendën për Reforma Evropiane dhe Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së”</i> të shtohet: <i>“I njejt i do t’i kontribuojë zbatimit te Planit Kombetar per Barazi Gjinore, perkatesisht ne zbatimin e objektives specifike 3.1. Perforcimi i mekanizmave institucionale dhe ngritja e vetedijes shoqerore per qasjen ne drejtesi”</i> .	Pranohet plotësisht	Pranohet dhe pjesa e cekur do të shtohet në tekst.
RrGK	Koment i pergjithshem			Sipas Ligjit per Barazi Gjinore, grate dhe burrat duhet te marrin pjese ne menyre te barabarte ne procese te politike-berjes. Në faqen 4 të Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit theksohet: <i>“...Kështu, janë mbajtur mbi 45 punëtori dhe takime publike,</i>	Pranohet plotësisht	Do të ndahen statistikat sipas gjinisë lidhur me konsultimin e draft Strategjisë.

				që kanë tërhequr mbi 1,000 pjesëmarrës ...” Si rrjedhojë, dhe kerkese direkte për të dhëna të ndara sipas gjinise nga LBGJ, sygjerojme që edhe shifa e theksuar të jetë e ndare sipas gjinise, p.sh: numri i grave dhe burrave që kanë marrë pjesë në këto takime publike dhe procese konsultative.		
RrGK	Koment i përgjithshëm			<u>Në dokumentin e PSSSL, faqe 6, pas tekstit “Problemet në sundimin e ligjit kanë efekte mjaft negative për shoqërinë e Kosovës... mundësi më të vogla të aktivitetit për sektorin privat dhe shumë të tjera.” të shtohet: “Në aspektin e përfaqësimit të barabartë dhe respektimit të Ligjit për Barazi Gjinore, gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në sistemin gjyqësor, sidomos në nivel të vendim-marrjes në pozita të prokurorëve dhe gjyqtarëve.”</u> Per të dhëna më të sakta, shih Analizen Gjinore të RrGK: <u>https://ëomensnetëork.org/ëp-content/uploads/2018/10/ëomens-netëork.pdf</u> .	Pranohet plotësisht	Kjo pjesë do të shtohet, ashtu siç është sugjeruar.

RrGK	Koment i pergjithshem			<p>Në dokumentin e Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit, faqe 16, të shtohen pjesët me bold: “Kjo është rezultat i faktorëve të mungesës së mjeteve financiare, fajesimit te viktimat nga ana e institucioneve, stigmes se perhapur per viktimat e dhunes ne familje, nivelit te ulet te raportimit te dhunes ne familje, mungeses se informimit, pozitës shoqërore dhe nivelit të ulët të besimit në sistem... nuk është ende në nivelin e kënaqshëm. Raporti i fundit i BE-se per Kosoven thekson se Kosova ka ende probleme ne adresimin e dhunes ne baza gjinore e cila mbetet prevalente dhe se “Duhet te fuqizohet implementimi i ligjit per barazi gjinore ne menyre qe te ndermirren veprime konkrete per te permiresuar situaten e viktimave te dhunes me baza gjinore”. Së dyti, ofrimi i ndihmës juridike, dhe sidomos asaj falas, mbetet sfidues..., veçanërisht në procedurë penale, ose ajo është e cilësisë së dobët. Kjo situatë me se shumti i prek qytetaret me vulnerabel, duke perfshire sidomos grate, femijet, viktimat e dhunes ne familje dhe viktimat e dhunes seksuale.”</p>	Pranohet pjesërisht	Do të riformulohet teksti, por me gjuhë më të kujdesshme dhe jo-konkluzive pa mbështetje të caktuar.
------	-----------------------	--	--	--	---------------------	--

RrGK	Koment i pergjithshem			Në dokumentin e Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit, faqe 20, të shtohet teksti me bold: “Kështu, në përbërje të këtyre dy institucioneve do të shtohen përfaqësues të akademisë dhe avokatisë e shoqërisë civile, përfshirë përfaqësues të organizatave që punojnë për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore,... ”	Refuzohe t	Nuk është qëlimi i kësaj fjalie në draft Strategji që të specifikohen OSHC-të në kuadër të vetëm një fushe specifike.
RrGK	Koment i pergjithshem			Ne masat dhe planifikimin për ngritjen e profesionalizmit dhe kompetencës së personelit gjyqësor dhe privat, sygjerojmë që në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtareve dhe prokuroreve, fokusi të vihet sidomos në ngritjen e profesionalizmit sa i përket trajtimit të rasteve të dhunës me baza gjinore. Aktualisht, Kosova ka mungesë të prokuroreve dhe gjyqtareve të specializuar që punojnë në rastet e dhunës seksuale, duke ndjekur procedurë me ndjeshmëri gjinore.	Pranohet plotësisht	Pas diskutimeve me AD, është shtuar një aktivitet me të cilin parashihet rishikimi i programit aktual trajnues me qëllim të avansimit të tij.
RrGK	Koment i pergjithshem			Objektiva specifike “Integriteti i Policisë së Kosovës” në kuadër të fuqizimit të sistemit të drejtësisë penale të ndryshohet në “Integriteti i Policisë së Kosovës, sidomos në luftimin e dhunës me baza gjinore”	Refuzohe t	Nuk mund të specifikohet në objektiv, vetëm një aspekt ngase integriteti duhet të jetë gjithëpërfshirës.

RrGK	Koment i pergjithshem			<p>Në dokumentin e Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit, faqe 26, të shtohet teksti me bold: “Policia e Kosovës është e mirëpajisur ... rregullave dhe korrupsionin, sjelljet e raportuara dhe fajesimin e viktimes ne raport me rastet e dhunes ne baza gjinore, sidomos dhunes seksuale. Për këtë arsye shkeljet e zyrtarëve policor duhet që të adresohen institucionalisht për rritur besueshmërinë e publikut dhe per te inkurajuar qytetaret burra dhe gra, te drejtohen per raportim te rasteve tek Policia e Kosoves, duke qene te sigurte se do te kene trajtim te barabarte, edhe pse Policia e Kosovës...Policia e Kosovës dhe IPK kanë shfaqur gatishmëri për të bashkëpunuar për të luftuar korrupsionin dhe shkeljet ligjore, diciplinore apo procedurale te zyrtareve policore.” Sic shihet, rekomandohet që të përdoret termi ‘shkelje’ në vend të referimit ‘sjellje të pahijshme’.</p>	Pranohet pjesërisht	Pranohet pjesërisht. Nuk pranohet pjesa specifike për vepra penale specifike, ngase fokusi nuk është vetëm aty.
RrGK	Koment i pergjithshem			<p>Në dokumentin e Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit, faqe 27, të shtohet teksti me bold: “Po ashtu, duhet të mbështeten trajnime të ...lëndët për policinë, prokurorinë dhe gjykatën, duke mbajtur dhe raportur me te dhena te ndara ne</p>	Pranohet plotësisht	Kjo do të adresohet në tekst dhe do të parashihet aktivitetet i ri për statistikatat.

				baza gjinore ne kuader te ketij sistemi kompjuterik.”		
RrGK	Koment i pergjithshem			Objektiva specifike 5.3.4 -“Rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile” në kuadër të fuqizimit të qasjes në drejtësi të ndryshohet në “Rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile, përfshirë organizata e grave”.	Refuzohet	Nuk është qëllimi të specifikohen organizatat e fushave të caktuara në objektiv.
RrGK	Koment i pergjithshem			Në dokumentin e Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit, faqe 30, kur flitet për transpozimin e dispozitave të Konventës së KiE për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, rekomandohet të precizohet se për cilat dispozita është fjala dhe në cilat ligje vendore.	Pranohet plotësisht	Do të riformulohet në mënyrë që ta parashihet zbatimi i Nenit 22 të ndryshuar të Kushtetutës.
RrGK	Koment i pergjithshem			Në dokumentin e Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit, faqe 32, të shtohet teksti me bold: “Objektiva e katërt specifike ...transparencës së këtyre institucioneve, sidomos me organizatat e grave te cilat kane ekspertizen e duhur ne monitorimin dhe trajtimin e rasteve te dhunes ne baza gjinore dhe dhunes seksuale, mes tjerash.”	Refuzohet	Nuk është qëllimi të specifikohen organizatat e fushave të caktuara në objektiv.
RrGK	Koment i pergjithshem			Në dokumentin e Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit, faqe 32, të shtohet teksti me bold: “Objektiva e katërt specifike ...transparencës së	Refuzohet	Nuk është qëllimi të specifikohen organizatat e fushave

				këtyre institucioneve, sidomos me organizatat e grave te cilat kane ekspertizen e duhur ne monitorimin dhe trajtimin e rasteve te dhunes ne baza gjinore dhe dhunes seksuale, mes tjerash."		të caktuara në objektiv.
RrGK	Koment i pergjithshem			Në dokumentin e Projekt Strategjisë për Sundimin e Ligjit, faqe 33, të shtohet teksti me bold: "Masë tjetër e këtij objektiv strategjik...të dhëna dhe statistika në lidhje me funksionimin dhe operimin e tyre institucional, dhe te hapin dokumentet e tyre rregullative per konsultim publik."	Refuzohe t	Aktet e tyre rregullative tanimë publikohen për konsultim.
RrGK	Koment i pergjithshem			Rekomandojme qe ne procesin e monitorimit dhe zbatimit te kesaj strategjie, te perfshihet edhe Agjencia per Barazi Gjinore, ne kuader te zyres se Kryeministrit, pasiqe ABGJ eshte pergjegjese per te monitoruar implementimin e Programit te Kosoves per Barazi Gjinore dhe Ligjit per Mbrojtje nga Dhuna ne Familje, me c' rast te dyja keto te fundit jane tejet te peraferta me ojektivat kryesore te kesaj strategjie.	Refuzohe t	Për vendim të menaxhmentit të MD-së.

OSCE	Koment i pergjithshem			<p>PSSL dhe Plani i Veprimit janë vlerësuar nga pikëpamja e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe parimet e sundimit të ligjit. OSBE e mirëpret projektstrategjinë si hap pozitiv në drejtim të përmirësimit të sundimit të ligjit në Kosovë. Megjithatë, kemi vërejtur që Projektstrategjia nuk përmend integrimin e profesioneve të gjyqësorit dhe ligjore në Kosovën veriore në sistemin ligjor të Kosovës (Në përputhje me 'Marrëveshjen e Brukselit'). Gjyqësori i integruar vazhdon të përballet me një numër sfidash, duke përfshirë: i. Mospërputhjet ndërmjet dy versioneve në gjuhën zyrtare (shqipe dhe serbe) të legjislacionit të Kosovës e bëjnë të vështirë që folësit jo-shqiptarë të praktikojnë avokatinë në sistemin e Kosovës (shih Raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë “Legjislacioni dygjuhësh në Kosovë,);</p> <p>ii. Mungesa e përkthyesve dhe interpretëve zyrtarë; iii. Pengesat për anëtarët e komuniteteve jo-shumicë që kualifikohen si profesionistë ligjorë në Kosovë (Pengesat përfshijnë: vështirësi me versionet zyrtare të legjislacionit dhe politikës kryesore që nuk janë në dispozicion në versionet serbe dhe / ose që nuk</p>	Pranohet plotësisht	<p>është shtuar një aktivitet që kërkon një analizë për të identifikuar konfliktet në verzionet e ndryshme gjuhësore dhe mënyra se si duhet të adresohen ato.</p>
------	-----------------------	--	--	--	---------------------	---

				<p>janë në përputhje me versionet në gjuhen shqipe. Për shembull, në vitin 2019, Misioni përktheu dy aktet nënligjore në Serbisht: Kodin e Etikës Profesionale të Avokatëve dhe Statutin e OAK. Dokumentet kishin qenë më parë të disponueshme vetëm në shqip dhe anglisht, gjë që i kishte vendosur folësit serbë në disavantazh kur aplikonin dhe praktikonin në Odën e Kosovës). Disa nga këto çështje adresohen në pjesë të tjera të projektstrategjisë (Të tilla si nën seksionin mbi 'Problemet me qasjen në gjykata dhe prokurori' në faqen 16 dhe, 'Vonesat në sistemin gjyqësor dhe prokurorial' në faqen 7 të versionit në gjuhën angleze të projektstrategjisë). Sidoqoftë, meqenëse integrimi është relativisht i ri dhe mbetet thelbësor për sundimin e ligjit për të gjitha komunitetet në Kosovë, ne konsiderojmë se integrimi meriton një konsideratë të veçantë në projektstrategji.</p>	
--	--	--	--	---	--

OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Sipas mendimit tonë, roli i avokatëve mbrojtës në procesin e drejtësisë penale ka nevojë për shqyrtim më të detajuar. Barazia e palëve është thelbësore për një gjykim të drejtë dhe shtetin e së drejtës (Shih Udhëzuesin për nenin 6 të KEDNj për një gjykim të drejtë, GjEDNj, faqe 33). Kjo do të thotë që avokatët mbrojtës duhet të trajnohen dhe të marrin burime të mira, në mënyrë që ata të barazohen me homologët e tyre prokurorë. Një profesion i mbrojtjes kompetent e i qëndrueshëm do të përmirësojë standardet e drejtësisë dhe të sigurojë përgjegjësinë e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit. Projekt Strategjia u kushton vetëm pak vëmendje avokatëve mbrojtës në pjesën "Profesionet e lira ligjore". Është e paqartë nëse projektstrategjia i referohet profesionit të pavarur juridik, d.m.th. anëtarëve të OAK-së, ose ANJF-së. Nëse bëhet investim i gjerë në burime dhe trajnime për prokurorët, rreziku është që të krijojë një sistem që është thelbësisht i paekuilibruar, duke minuar kështu sundimin e ligjit. Prandaj, ne sugjerojmë që hartuesit ta marrin në konsideratë këtë çështje.</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Roli i avokatëve është i diskutuar më në detaje në dokumentin mbi Qasjen në gjykata e prokurori (III.1) dhe atë për mjete juridike gjithashtu. Megjithatë, edhe në pjesën narrative të Strategjisë pas konsultimit publik është reflektuar roli i avokatëve.</p>
------	-----------------------	--	--	--	---------------------	---

OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Lidhur me barazinë e palëve, ne sugjerojmë që projektstrategjia duhet të adresojë faktin se korniza ligjore për zbulimin e provave, përfshirë materialin e papërdorur, në çështjet penale nuk është zhvilluar mjaftueshëm. Dispozitat e KPP vendosin barrën apo përgjegjësinë tek mbrojtja për 't'iu qasur dosjes së çështjes'(neni 164(9)), apo që, '[atyre] të përmendur në aktakuzë të mund t'ju sigurohet një kopje ose përkatësisht kopjet e dosjes së çështjes'(213 (5)). Duhet të jetë detyrë e prokurorisë për të siguruar zbulimin e plotë të çështjes dhe provat e mundshme shfajësuese, pavarësisht nëse ato kërkohen nga mbrojtja. Kjo, së bashku me faktin se KPP nuk përcakton afatet për dërgimin e provave, çon në pasiguri në zbatimin e regjimit të zbulimit.</p>	Pranohet plotësisht	OSBE është udhëzuar që ta propozoj këtë çështje tek grupi punues për draft Kodin e Procedurës Penale.
------	-----------------------	--	--	--	---------------------	---

OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Projektstrategjia nuk merr në konsideratë rolin e dëshmitarëve, mbrojtjen e dëshmitarëve ose mjediset / kornizën legjislative për dëshmitarët e cenueshëm. Kjo është një fushë ku ka mungesa në Kosovë; shumica e gjykatave nuk janë të pajisura me pajisje që ua mundësojnë dëshmitarëve të cenueshëm ose të frikësuar të paraqiten përveçse personalisht dhe korniza legjislative nuk është zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme për të siguruar kompetenca dhe detyra të qarta për gjyqësorin kur merren me dëshmitarë të cenueshëm/ të frikësuar.* Prandaj, ne sugjerojmë që hartuesit të marrin në konsideratë këtë çështje.</p> <p><i>* Kapitulli XIII i KPP ka të bëjë me 'Mbrojtjen e Palëve të Dëmtuara dhe Dëshmitarëve'. Kapitulli parasheh masa të ndryshme për palët që janë në 'rrezik serioz' duke përfshirë dhënien e dëshmive përmes videolidhjes, përdorimin e ekraneve dhe madje dëshminë e para-regjistruar. Sidoqoftë, sipas Raportit të Monitorimit të Drejtësisë 2020, EULEX në faqen 10, "sa herë që ka nevojë për të pyetur një dëshmitar në Pallatin e Drejtësisë], me anë të thirrjes video, për shembull, gjykata duhet të zhvendosë seancën</i></p>	Pranohet pjesërisht	Kjo çështje do të adresohet gjatë rishikimit të Planit Vjetor, në përputhje me aktivitetet që janë duke u zhvilluar nga donatorët në këtë fushë tashmë.
------	-----------------------	--	--	---	---------------------	---

				<p><i>gjqësore në Pejë, e cila është një nga gjykatat e pakta në të cilat është e mundur marrja në pyetje e dëshmitarëve të mbrojtur”. KPP-ja nuk flet mbi dëshmitarët ‘e cenueshëm’ ose atyre dëshmia e të cilëve mund të zvogëlohet sepse frikësohen edhe nëse nuk janë në ‘rrezik serioz’ siç përcaktohet nga ligji. Për shembull, dëshmitarët fëmijë dhe ata me shëndet mendor ose aftësi të kufizuara në të mësuar janë dëshmitarë të cenueshëm, viktimat të llojeve të caktuara të veprave penale siç janë veprat penale seksuale, dhuna në familje etj. ka të ngjarë të frikësohen dhe të përballen me vështirësi shtesë për të dhënë dëshmi, por jo domosdoshmërisht plotësojnë përkufizimin e të qenurit në ‘rrezik serioz’. Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R (97) 13 (1997), Kapitulli IV mbi ‘Masat që duhen marrë në lidhje me dëshmitarët e cenueshëm, veçanërisht në rastet e krimet brenda familjes’ nga paragrafi 25 thotë: “25. Dëshmitarët e cenueshëm duhet, sa herë që të jetë e mundur, të merren në pyetje në fazën më të hershme të procedimit penal, sa më shpejt të jetë e mundur pasi të jenë raportuar faktet. Ekzaminimet e tilla duhet të kryhen në mënyrë</i></p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p><i>veçanërisht të kujdesshme, të respektueshme dhe të plotë. 26. Ekzaminime të tilla nuk duhet të përsëriten. Ekzaminimet duhet të kryhen nga, ose në prani të një autoriteti gjyqësor, dhe mbrojtja duhet të ketë mundësi të mjaftueshme për të kundërshtuar këtë dëshmi. 27. Nëse është e përshtatshme, deklaratat e bëra në fazën paragjyqësore duhet të regjistrohen me video për të shmangur ballafaqimin ballë për ballë dhe ekzaminimet e panevojshme të përsëritura që mund të shkaktojnë trauma. Gjatë gjykimit, teknikat audiovizive mund të përdoren në mënyrë që t'i mundësojnë autoritetit kompetent të dëgjojë personat në fjalë pa praninë fizike të njërit apo tjetrit. 28. Në seancën gjyqësore, marrja në pyetje e dëshmitarit duhet të mbikëqyret nga afër nga gjyqtari. Kur marrja në pyetje e tërthortë, veçanërisht në çështjet në lidhje me akuzat për vepra seksuale, mund të ketë një efekt traumatik të padrejtë mbi dëshmitarin, gjykatësi duhet të konsiderojë marrjen e masave të duhura për të kontrolluar mënyrën e marrjes në pyetje. " Në lidhje me viktimat e dhunës në familje, neni 228, KPP i referohet LMDhF por ai ligj</i></p>	
--	--	--	--	---	--

				<p><i>thotë vetëm se Policia e Kosovës duhet të sigurojë mbrojtje të dëshmitarëve në përputhje me ligjin.</i></p>		
--	--	--	--	---	--	--

OSCE	Koment i pergjithshem			Projektstrategjia i referohet përfaqësimit të grave në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, dhe në pozitën menaxheriale në veçanti. Megjithatë, duke marrë parasysh që është "dukshëm më e ulët se burrat" (faqe 29, paragrafi 4 i versionit në anglisht), kësaj çështjeje të rëndësishme nuk iu dha vëmendja e duhur. Ne sugjerojmë që kjo çështje të trajtohet më gjerësisht, dhe që faktorët që ndikojnë në nivelet e përfaqësimit të identifikohen, së bashku me rekomandimet konkrete se si të përmirësohet përfaqësimi i grave në nivele të larta/menaxheriale brenda sistemit të drejtësisë.	Pranohet pjesërisht	Kjo çështje do të analizohet tutje dhe do të reflektohet në Planin e Veprimit në vitet e ardhshme, në raport edhe me aktivitetet e vazhdueshme që janë duke u ndërmarrë nga institucionet publike dhe donatorët në këtë drejtim.
OSCE	Koment i pergjithshem			Ne sugjerojmë që t'i kushtohet më shumë vëmendje mënyrës se si sistemi i drejtësisë mund t'i marrë më së miri parasysh pikëpamjet e viktimave dhe të sigurojë që të drejtat e viktimave të realizohen plotësisht. Kosova përfiton nga një Zyrë e themeluar për Ndihmë dhe Mbrojtje të Viktimave. Sidoqoftë, zyra nuk ka burime të mjaftueshme dhe nuk është në gjendje të përfaqësojë viktimat në të gjitha kategoritë e çështjeve (Shih "Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje	Pranohet pjesërisht	Kjo çështje do të analizohet tutje dhe do të reflektohet në Planin e Veprimit në vitet e ardhshme.

				në Kosovë”, shtator 2019,f.136). Mbrojtësit e viktimave janë të vetmit profesionistë ligjorë që paraqiten para gjykatave nga të cilët nuk kërkohet ta kenë kaluar provimin e jurisprudencës, prandaj duhet të merret parasysh se si të forcohen kapacitetet e tyre profesionale.		
OSCE	Koment i përgjithshëm			Projekt Strategjia, faqe 6 – Funksionimi i gjyqësorit: <i>Të merret parasysh shtimi i “pavarësisë dhe paanësisë të gjyqësorit” në mesin e elementëve kryesorë për funksionimin e drejt të tij.</i> Projektstrategjia parasheh ekzistimin e katër elementëve kryesorë për funksionimin e duhur të gjyqësorit: “efikasiteti, profesionalizmi, llogaridhënia dhe integriteti”. Ne konsiderojmë që "pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit" duhet të renditen gjithashtu në mesin e këtyre elementëve kryesorë.	Pranohet plotësisht	Do të reflektohet në tekstin e Strategjisë, në pjesën narrative.

OSCE	Koment i përgjithshëm			<p>Projekt Strategjia, faqe 7- Vonesat në sistemin gjyqësor dhe prokurorial: <i>Të merret parasysh shtjellimi i dështimit të gjykatave për të vendosur, gjegjësisht shqiptuar sanksione të duhura për vonesat apo rigjykimet që mund të ishin shmangur.</i> Në paragrafin 3 në faqen 8, projektstrategjia detajon faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurave dhe përfshin disa çështje, të gjitha të vlefshme. Sidoqoftë, ne konsiderojmë se këto çështje meritojnë shqyrtim dhe përqendrim më të detajuar. Një shembull i tillë është dështimi i gjykatave për të vendosur sanksione të përshtatshme për vonesat e shkaktuara nga palët. (shih Raporti i Monitorimit të Drejtësisë, EULEX). Monitorimi i gjykimeve nga Misioni ka vërejtur se gjykatat rrallë ushtrojnë fuqinë e tyre për të sanksionuar palët që shkaktojnë vonesa të shmangshme. Sanksionet ligjore për mos pjesëmarrje dhe shkelje të tjera të rregullave procedurale janë një mjet i rëndësishëm për gjyqësorin për të siguruar autoritetin e tij dhe për të krijuar respekt për procesin gjyqësor. Vendosija e sanksioneve në rastet e duhura ka një efekt parandalues duke</p>	Pranohet plotësisht	<p>Pas diskutimit të këtij komenti me KGJK-në, është dakordar që të futen tri aktivitete të reja në kuadër të dokumentit të efikasitetit. Këto aktivitete tani kërkojnë që të bëhet e detyrueshme nga SMIL që gjyqtari të fusë në SMIL arsyejen për vonesën/shtyerjen e seancës; që këto arsyetime të bëhen pjesë e raporteve tremujore të Kryetarëve të Gjykatave; dhe që Kryetarët e Gjykatave të vlerësohen edhe për menaxhimin e këtyre vonesave gjatë matjes së performancës së tyre si kryetarë.</p>
------	-----------------------	--	--	--	---------------------	--

				<p>parandaluar shkelje të mëtejshme të ngjashme dhe në këtë mënyrë përmirëson afatet kohore dhe efikasitetin e procedurave.</p> <p>Gjithashtu, shtjelluar në hollësi nën 'faktorin e dytë' është "praktika e zakonshme që çështjet të kthehen në rigjykim nga gjykatat më të larta". Gjetjet nga monitorimi i gjykimeve nga Misioni mbështesin konkluzionin që kjo është shkak i rëndësishëm i vonesave. Përsëri, kjo është një çështje e rëndësishme për të cilën konsiderojmë se meriton shqyrtim më të gjerë.</p>		
OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Projekt Strategjia, faqe 7- Vonesat në sistemin gjyqësor dhe prokurorial: <i>Të merret parasysh shtjellimi i mëtejme i "faktorit të tretë" në mënyrë që të sigurohen mënyra se si të inkurajohen palët në konteste civile të provojnë ZAK para procesit gjyqësor, gjegjësisht si të bëhet procesi gjyqësor masë e fundit që ndërmerret në kategori të duhura të rasteve - Projektstrategjia me të drejtë flet për përdorimin e ulët të mundësive për ZAK dhe identifikon mungesën e informacionit mbi mundësinë e përdorimit të ZAK për zgjidhjen efikase të mosmarrëveshjeve, si një faktor, i cili</i></p>	Refuzohet	<p>Me Ligjin për Ndërmetjesimin është paraparë ndërmjetësimi i detyrueshëm për disa raste të caktuara. Përveç kësaj, PV përmbanë shumë aktivitete të tjera në lidhje me mekanizmat për ZAK.</p>

				rezulton në këtë përdorim të ulët. Sidoqoftë, ne konsiderojmë që projektstrategjia duhet të përfshijë gjithashtu elementin e një obligimi mbi gjykatat për t'i këshilluar palët për mundësitë për ZAK dhe avantazhet e mundshme që ato kanë krahasuar me proceset gjyqësore, pasi mund të ndikojë pozitivisht në përdorimin e ZAK.		
OSCE	Koment i përgjithshëm			Sistemi i cenueshëm ndaj akterëve të jashtëm (Projekt Strategjia, faqe 11): <i>Të merret parasysh ofrimi i më shumë hollësive lidhur me rolin e Policisë.</i> Nën "Sistemin e cenueshëm ndaj akterëve të jashtëm" (faqe 11, paragrafi i fundit i versionit në anglisht), projektstrategjia thotë: "Gjithashtu sistemi tek policët mund të konsiderohet i cenueshëm. Ka mungesë të trajnimeve adekuate për integritet dhe etikë, si dhe verifikimi i sigurisë për të gjithë pjesëtarët e policisë, nuk bëhet. Faktor tjetër për cenimin e integritetit është edhe mos-vendosja e kamerave në trup, që tani më zbatohet në disa vende të zhvilluara". Ne konsiderojmë se duhet dhënë më shumë detaje në lidhje me rolin e Policisë. Ka çështje të tjera, shumë më të ngutshme në këtë fushë që duhet të trajtohen si përparësi, për shembull, fakti që	Pranohet plotësisht	Një masë e këtillë specifike tashmë është paraparë në PV, por do të kujdesemi që kjo të reflektohet edhe në pjesën narrative të Strategjisë

				<p>policia nuk bën intervista me video ose audio-regjistrim me të dyshuar. Ne besojmë që kjo duhet të jetë standarde. Prandaj, ne sugjerojmë që hartuesit t'i japin konsideratë të mëtejme kësaj pjesë.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Problemet në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit (Projekt Strategjia, faqe 12): <i>Të merret parasysh qartësimi nëse afatet procedurale janë të pamjaftueshme vetëm për rastet kur kërkohet bashkëpunimi juridik ndërkombëtar/asistencë e ndërsjellë juridike, apo në të gjitha rastet - Nën pjesën “Problemet në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit” (faqe 13, paragrafi 5), projektstrategjia thotë: “Mangësitë procedurale për hetim adekuat të këtyre veprave janë faktori i dytë evident. Afati për hetim mund të konsiderohet i shkurtër për raste më të ndërlikuara, veçanërisht duke marr parasysh se veprimet hetimore pezullohen, ndërsa afati i përgjithshëm jo, në rast të përfshirjes së elementit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtare në to”.* Pjesa e këtij paragrafi (me shkronja të pjerrëta) është e paqartë dhe sipas mendimit tonë ka nevojë për sqarime të mëtejshme. Është e paqartë nëse hartuesi i referohet afateve procedurale që janë të pamjaftueshme në rastet kur bashkëpunimi juridik ndërkombëtar/ndihma e ndërsjellë juridike, ose në të gjitha rastet. Në</i></p>	Pranohet plotësisht	Kjo çështje është analizuar në detaje në dokumentet e politikave, ndërkaq është paraqitur në mënyrë më të shkurtër në tekst të strategjisë. Më shumë detaje janë dhënë në draft Kodin e Procedurës Penale.
------	-----------------------	--	--	---	---------------------	--

				<p>përputhje me Kodin e Procedurës Penale, hetimet penale duhet të përfundojnë brenda dy viteve nga data e fillimit të hetimit. Në çështje komplekse (të tilla si korrupsioni ose krimi i organizuar), një gjyqtar i procedurës paraprake mund të japë një zgjatje gjashtë-mujore të këtij afati, duke u dhënë hetuesve një maksimum prej 30 muajsh për të përfunduar hetimin. Hetimet që nuk janë përfunduar brenda këtyre afateve përfundojnë automatikisht. Në rrethana normale, këto afate janë të arsyeshme. Nëse hetuesit veprojnë me shpejtësi (siç duhet), afatet kohore janë të mjaftueshme për të lejuar përfundimin e hetimeve edhe komplekse dhe / ose ato që përfshijnë kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike. Për më tepër, në rastet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar / ndihmës juridike të ndërsjellë, autoriteti kompetent, "duhet t'i përmbahet një kërkesë për ndihmë sa më shpejt të jetë e mundur"(Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R (80) 8). Prandaj, kërkohen prova të mëtijshme për të mbështetur pretendimin se afatet aktuale janë të shkurtra në rastet kur kërkohet bashkëpunim juridik ndërkombëtar. Afatet kohore për</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>hetimet dhe ndjekjet penale janë masa mbrojtëse të rëndësishme procedurale që synojnë të parandalojnë procedimet tepër të gjata në çështjet penale dhe në këtë mënyrë të mbështesin të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Prandaj, ne sugjerojmë që hartuesit të shqyrtojnë më tej këtë çështje.</p> <p><i>*Terminologjia në këtë fjali është veçanërisht e paqartë sepse Kodi i Procedurës Penale, neni 157 lejon pezullimin e hetimeve atje ku ka, "rrethana që përkohësisht parandalojnë ndjekjen penale të suksesshme të të pandehurit". Shembujt e dhënë në nen janë ato kur i pandehuri ka ikur ose ka paaftësi të përkohshme mendore. Por dispozita është hartuar gjerësisht, dhe ata shembuj janë jo-shterues. Neni 157 (5) thotë se, "Koha derisa hetimi është pezulluar nuk llogaritet në kohën për zbatimin e hetimit, e as në kohën për parashkrimin e veprës penale". Me fjalë të tjera, pezullimi ka efektin e 'ndalimit të orës' kur llogaritet si afati kohor për përfundimin e hetimit ashtu edhe afati i parashkrimit të veprës/ave penale.</i></p>	
--	--	--	--	--	--

OSCE	Koment i përgjithshëm			<p>Problemet në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit: <i>Të merret parasysh lidhja e bazës së të dhënave të policisë me prokurorinë</i> - Nën pjesën, "Problemet në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit" (faqe 14, paragrafi i fundit), drafti i Strategjisë vë në dukje kapacitetin e kufizuar të Policisë së Kosovës në lidhje me hetimin e veprave penale në përgjithësi, duke theksuar më tej se "databaza e tyre nuk është e lidhur me atë të gjyqësorit". Ne konsiderojmë që baza e të dhënave të policisë duhet të lidhet me prokurorinë, në mënyrë që të mundësojë hetime më efektive dhe të shpejta. Kështu, ne sugjerojmë që të merret parasysh lidhja e bazës së të dhënave të policisë me prokurorinë, nën këtë pjesë. Gjyqësori ka një rol të kufizuar gjatë fazës së hetimit të një çështjeje ndërsa ekziston një nevojë e identifikuar për të përmirësuar bashkëpunimin midis policisë dhe prokurorisë (Raporti i Monitorimit të Drejtësisë EULEX).</p>	Pranohet plotësisht	Kjo çështje është analizuar në detaje në dokumentet e politikave, ndërkaq është paraqitur në mënyrë më të shkurtër në tekst të strategjisë. Do të reflektohet për të dhënë më shumë detaje në përputhje me dokumentet e politikave.
------	-----------------------	--	--	--	---------------------	---

OSCE	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	Koment në tekstin e Strategjisë		<p>Problemet në ekzekutimin e sanksioneve penale (Draft Strategjia, faqe 14): <i>Të merret parasysh përmendja e qëllimeve/synimeve të tjera të rëndësishme të dënimeve të shqiptuara siç janë “mbrojtja e publikut”, “rehabilitimi”, “pengimi” dhe “ndëshkimi”, krahas riintegrimit të të dënuarve në shoqëri”</i> - Tek "Problemet në ekzekutimin e sanksioneve penale" (faqe 14, paragrafi 1), projektstrategjia parasheh sa vijon: “Mënyra e sanksionimit të kryerësve të veprave penale dhe ekzekutimi i këtyre sanksioneve është i rëndësisë primare për zvogëlimin e kriminalitetit. Synimi duhet të jetë gjithmonë riintegrimi i të dënuarve në shoqëri, duke përmendur “riintegrimin e të dënuarve në shoqëri” si të vetmin synim. Derisa riintegrimi është gjithsesi një ndër synimet e dënimit, ka dhe shumë qëllime tjera të pranura gjerësisht, siç janë “mbrojtja e publikut”, “rehabilitimi”, “pengimi” dhe "ndëshkimi". Që të gjitha këto "synime" janë të njëjloj të rëndësishme. Varësisht nga rastet, rëndësia e disa sosh mund të jetë më e shprehur se të tjerat. Për shembull, kur kryerësi vlerësohet të jetë i</p>	Pranohet pjesërisht	Këto qëllime do të përmenden në tekst, përveç "ndëshkimit". Gjithashtu do të shtohet "parandalimi"
------	--------------------------------------	---------------------------------	--	--	---------------------	--

				<p>rrezikshëm, “mbrojtja publike” ka të ngjarë të jetë qëllimi mbizotërues i dënimit. Prandaj, sugjerojmë që në projektstrategji të përfshihen të gjitha qëllimet e sipërpërmendura.</p>		
OSCE	II.3_Ekzekutimi i sanksioneve penale	Koment në tekstin e Strategjisë		<p>Problemet ne ekzekutimin e sanksioneve penale: <i>Të merret parasysh shtjellimi i mëtejme i dënimeve alternative dhe i mënyrave për ta shtuar shkallën e përdorimit të tyre:</i> Gjersa në projektstrategji deklarohet se “numri i sanksioneve dhe masave alternative që shqiptohen nga gjykatat është shumë i ulët, rreth 3.1%.” (faqe 14, paragrafi i fundit), ne konsiderojmë se kjo çështje duhet të shtjellohet në mënyrë më të thuktë. Konkretisht, projektstrategjia duhet të mbajë po ashtu parasysh faktin që ka mungesë të programeve rehabilituese për dënime alternative dhe, për rrjedhojë, dënimet prirën të jenë ose burgim i menjëhershëm, dënim me kusht pa detyrime shtesë, burgim i zëvendësuar me gjobë ose vetëm si</p>	Pranohet plotësisht	Dokumenti i politikave II.3 i adreson në detaje këto çështje, dhe prandaj dalin rekomandimet për nxitjen e shqiptimit të masave alternative.

				<p>gjobë më vete. Sipas mendimit tonë, projektstrategjia duhet ta adresojë kornizën legjislative, të politikave dhe atë institucionale e cila nuk e zhvilluar aq sa t'u mundësojë gjykatave të shqiptojnë dënime të tilla si punë pa pagesë, kufizim të qarkullimit, mbikëqyrje, trajtim për varësia nga alkooli/droga, programe për kryerës të dhunës në familje etj. Lidhur me këtë, konsiderojmë që projektstrategjia duhet të mbajë po ashtu parasysh nevojën për shtim të burimeve dhe trajnimeve për shërbimin sprovues ashtu që ta kenë të mundur të realizojnë mbikëqyrjen e nevojshme për këto lloj dënimesh.</p>		
OSCE	III.1_Qasja ne drejtesi	Koment në tekstin e Strategjisë		<p>Problemet lidhur me qasjen në gjykata dhe prokurori (faqe 16): <i>Të merret parasysh që të përmendet dhe njëherësh të merret më shumë në konsideratë përshtatshmëria e sistemit për caktim të avokatëve sipas detyrës zyrtare nga OAK. Në pjesën "Problemet lidhur me qasjen në gjykata dhe prokurori" (faqe 16 e versionit në gjuhën angleze) të projektstrategjisë theksohet se "ofrimi i ndihmës juridike, sidomos asaj falas, mbetet sfidues" dhe se "kjo vjen nga faktorë të ndryshëm, siç janë buxheti dhe kapacitetet e kufizuara të ANJF-së për të mbuluar</i></p>	Pranohet plotësisht	Për këtë janë paraparë shumë masa në kuadër të PV, që dalin nga Dokumenti i Politikave III.1

				<p>tërë territorin e Kosovës, mos-definimi i qartë i 'interetit të drejtësisë' kur duhet të sigurohet mbrojtja falas sipas ligjit, mungesa e mekanizmit të licencimit të OJQ-ve ... " . Dëshironim të theksojmë se, në praktikë, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) nuk bën përfaqësimin në çështjet penale, ndonëse legjislacioni sugjeron që do duhej të bënte një gjë të tillë. Për çështjet penale është Oda e Avokatëve të Kosovës që siguron këshillim ligjor sipas detyrës zyrtare. OAK ka një regjistër (listë) të anëtarësisë së vet dhe kur i kërkohet angazhon avokatë për të shkuar në stacion policor ose gjykatë për t'i përfaqësuar të dyshuarit/të pandehurit që nuk kanë mundësi financiare të sigurojnë përfaqësim. Duke qenë se ky sistem po përballet me sfida ligjore të vazhdueshme nga avokatët e rinj, statusi i tij mbetet i paqartë dhe, kështu, konsiderojmë që kësaj çështje duhet t'i kushtohet vëmendje më e plotë në projektstrategji.</p>	
--	--	--	--	--	--

OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Problemet lidhur me qasjen në gjykata dhe prokurori (faqe 17): Të merret parasysh që t'i kushtohet më shumë vëmendje mjeteve juridike për sigurim të kompensimit për dëmet e shkaktuara nga organet administrative, por edhe në rastet e privimit të kundërligjshëm nga liria. Në pjesën "Problemet lidhur me qasjen në gjykata dhe prokurori (faqe 17, paragrafi i fundit i versionit në gjuhën angleze) të projektstrategjisë, thuhet: "Për më shumë, mjetet juridike për të siguruar kompensimin për dëmet e shkaktuara nga organet administrative por edhe në rastet e privimit të kundërligjshëm nga liria, kanë mangësitë e saj". Kjo gjë është problematikë domethënëse për sundimin e ligjit që, sipas mendimit tonë, meriton shtjellim më të hollësishëm. Nuk ka procedurë të qartë për kërkim të kompensimit për shkelje të të drejtave themelore/të njeriut nga institucionet e Kosovës.^[1] Korniza ligjore nuk krijon një sistem të shqyrtimit gjyqësor dhe është e paqartë se në ç' raste një person mund të kërkojë kompensim për shkeljen e të drejtave të tij. Një gjë e tillë ua vështirëson personave që t'i realizojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre dhe minon</p>	Pranohet pjesërisht	çështja e kompensimit për dëmet e shkaktuara nga organet administrative do të analizohet tutje dhe do të shikohen mundësitë për ta reflektuar në vitet e ardhshme në PV, në koordinim edhe me MPB-në.
------	-----------------------	--	--	---	---------------------	---

				<p>përgjegjësinë e institucioneve. Prandaj, sugjerojmë që hartuesit t'i kushtojnë më shumë vëmendje kësaj çështjeje në kuadër të projektstrategjisë.</p>		
OSCE	Koment i përgjithshëm			<p>Problemet lidhur me ofrimin e shërbimeve ligjore (Projektstrategjia, faqe 17): <i>Duhet të merret parasysh nëse këto shërbime janë të disponueshme në mbarë vendin dhe të merret më shumë në konsideratë situata në komunat veriore në përgjithësi- Në pjesën “Problemet lidhur me ofrimin e shërbimeve ligjore (faqe 17, paragrafi i parë i versionit në gjuhën angleze) të projektstrategjisë thuhet “Në Kosovë, gjatë dhjetë viteve të fundit, janë krijuar një sërë profesioneve të lira, me kompetencë për ofrimin e drejtësisë. Përveç profesionit të avokatit, që është i natyrës klasike, profesionet e lira më të reja në Kosovë, përfshijnë noterët, ndërmjetësuesit, përmbartuesit privat dhe administratorët falimentues”.</i></p>	Pranohet pjesërisht	Strategjia ka qasje gjithëpërfshirëse për të gjithë territorin e Kosovës dhe aktivitetet janë hartuar në këtë frymë. Gjithashtu me rishikimin e PV do të parashihet shtimi i numrit të profesioneve të lira në ato komuna ku ka nevojë.

				<p>Duam të vëmë në dukje se në katër komunat veriore nuk ka noterë ose përbarues privatë. Andaj, konsiderojmë se projektstrategjia duhet të marrë parasysh edhe faktin nëse këto shërbime janë të disponueshme në mbarë vendin dhe t'i kushtojë më shumë vëmendje situatës në komunat veriore në përgjithësi.</p>		
OSCE	Koment i përgjithshëm			<p>Ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial (faqe 20): <i>Të merret parasysh përfshirjen e masave për të mundësuar caktimin e seancave gjyqësore në ditë të njëpasnjëshme - Në pjesën "Ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial" (faqe 21 e versionit në gjuhën angleze) të projektstrategjisë thuhet: "Përmes masës për qartësimin e procedurave të brendshme, pritet që të përmirësohen procedurat e caktimit të lëndëve, trajtimit të lëndëve joaktive dhe në përgjegjësi menaxhimi i rrjedhës së lëndëve. Futja e caktimit automatik të lëndëve, zbatimi i obligueshëm i CEPEJ për menaxhim të kohës si dhe ndërmarrja e masave ndëshkuese ndaj palëve për mungesë në seanca janë disa nga masat e propozuara këtu. Përdorimi i parimit FIFO (first</i></p>	Pranohet plotësisht	<p>Pas diskutimit edhe me KGJK-në, janë shtuar tri aktivitete që adresojnë këtë problematikë: e para, të bëhet e detyrueshme për gjyqtarët që të në SMIL të vendosin arsyet e vonësës/shtyerjes së seancës; e dyta, kryetarët e gjykatave të raportojnë cdo tre muaj për këto raste të shtyerjeve/vonesave të seancave; dhe, e treta, njëra nga kriteret për matjen e performancës së kryetarëve të gjykatave të jetë edhe mënyra e adresimit të</p>

				<p>one in - first one out; pranohet e para – trajtohet e para), do të mundësojë aktivizimin dhe zgjidhjen e lëndëve më të vjetra. Për më tepër, ndërtimi i një sistemi më të mirë për raportim në KGJK dhe KPK, do të mundësojë mbledhje më të mirë dhe të besueshme të të dhënave dhe, në fund, analizë dhe politikëbërje më të mirë”. Duke u bazuar në monitorimet që Misioni u bën gjyqësorëve, duam të vëmë në dukje se sistemi aktual ku ka pauza të gjata midis shqyrtimeve gjyqësore shkakton vonesa shtesë meqë gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë në dispozicion në periudhat ndërmjet shqyrtimeve (për shkak të angazhimit në gjykata/prokurori tjera, pensionimit, problemeve shëndetësore etj.). Prandaj, sugjerojmë që hartuesit të marrin parasysh përfshirjen e masave për të mundësuar caktimin e shqyrtimeve gjyqësore në ditë të njëpasnjëshme. Veç kësaj, FIFO nuk është doemos metoda më e mirë e prioritizimit të lëndëve (madje mund të shkaktojë prioritizimin e veprave më të lehta karshi veprave të rënda apo rasteve në të cilat lipset mbrojtje publike). Për të siguruar besimin e publikut, çdo sistem i prioritizimit të lëndëve dhe zgjidhjes së lëndëve më të vjetra</p>	<p>këtyre rasteve të vonesave/shtyerjeve të seancave në gjykatat e tyre.</p>
--	--	--	--	--	--

				që vendoset të përdoret duhet që të jetë i qartë dhe transparent. Prandaj, konsiderojmë që hartuesit duhet t'i kushtojnë vëmendje të mëtejshme kësaj çështjeje.		
OSCE	Koment i përgjithshëm			Rritja e integritetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial (faqe 22): <i>Të mbahet parasysh përshtatshmëria dhe ligjshmëria e mbledhjes së informatave mbi shëndetin - Në pjesën "Rritja e integritetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial" (faqe 22 e versionit në gjuhën angleze) të projektstrategjisë përmendet "mundësuar kështu mbledhjen e të dhënave jo vetëm nga regjistrat publikë por edhe informatave të tjera financiare dhe shëndetësore për</i>	Pranohet plotësisht	Kjo çështje do të diskutohet më detajisht në koncept dokumentin për vetingun. Gjatë përpilimit të dokumenteve për atë proces, duhet pasur parasysh komentin e OSCE-së për çështjen e të dhënave shëndetësore. MD do të sigurohet që të

				<p><i>kandidatët” (faqe 23). Konsiderojmë që një gjë e tillë përbën ndërhyrje në jetën private dhe mund të argumentohet si a panevojshme dhe jo proporcionale për qëllimet e sigurimit të integritetit të gjyqtarëve. Veç kësaj, një gjë e tillë mund të çojë në praktika diskriminuese dhe të kthehet në pengesë për kandidatët me aftësi të kufizuara. Duhet të mbahet parasysh që, sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, informatat shëndetësore konsiderohet si "të dhëna personale të ndjeshme", dhe përpunimi i tyre lejohet vetëm në rrethana të veçanta të parapara me ligj. Andaj, sugjerojmë që hartuesit të marrin në konsideratë përshtatshmërinë dhe ligjshmërinë e mbledhjes së informatave mbi shëndetin.</i></p>		<p>respektohet privatësia dhe të dhënat personale në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare.</p>
OSCE	Koment i përgjithshëm			<p>Vlerësimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë (faqe 24): Të merret parasysh që në kuadër të kësaj pjesë theksi të vihet në bashkërendimin më të mirë midis hetuesve dhe prokurorëve, si edhe përmirësimet në disponueshmërinë e kontabilistëve forenzikë/ekspertizës financiare. Në pjesën “Vlerësimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë”</p>	Pranohet plotësisht	<p>Në PV është paraparë rritja e numrit të ekspertëve financiar në PSRK si dhe Koncept Dokumenti për Ekspertiza Gjyqësore dhe Prokuroriale do të analizoj gjithashtu ngritjen e cilësisë së ekspertizës në sistem.</p>

				<p>(faqe 24) të projektstrategjisë thuhet: “Objektivi ka identifikuar tri fusha ku sektori i drejtësisë ka dështuar që në mënyrë konsistente të mbajë përgjegjës ata që abuzojnë me pozitën e tyre publike përmes përfshirjes së tyre në korrupsion të nivelit të lartë, e që rekomandon se duhet të shfrytëzohen me mirë mekanizmat ligjor në adresimin e çështjeve të krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë konvertimit të pasurive të fituara jashtëligjshëm.” Konsiderojmë se bashkërendimi më i mirë ndërmjet hetuesve dhe prokurorëve, si edhe përmirësimet në disponueshmërinë e ekspertizës forenzike (përfshirë kontabilitetë forenzikë dhe ekspertë financiarë) do të ndihmonin me këto hetime komplekse.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Përmirësimi i qasjes në gjykata dhe prokurori (faqe 29): <i>Të merret parasysh dhënia e rekomandimeve më konkrete mbi çështjen e dhunës me bazë gjinore dhe strehimoret, si edhe të ketë më shumë fokus në zbatimin e akteve ligjore që rregullojnë këtë çështje</i> - Në pjesën “Përmirësimi i qasjes në gjykata dhe prokurori” të projektstrategjisë theksi është vënë me të drejtë në dhunën me bazë gjinore dhe çështjen e strehimoreve. Megjithëkëtë, rekomandimet janë shumë të përgjithësuara. Trajtimi i kësaj problematike vetëm me anë të "ndryshimeve legjislative" nuk mjafton, duke qenë se problem kryesor është zbatimit, e jo ligjet. Veç kësaj, dëshirojmë të përgëzojmë hartuesit për nismën e propozuar në projektstrategji për “transpozimin e dispozitave të Konventës së KiE për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në ligjin vendor të Kosovës”, dhe konsiderojmë se, gjersa Konventa e Stambollit tani është pjesë përbërëse e Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, drejtpërdrejt e zbatueshme, transpozimi i dispozitave të saja drejtpërsëdrejti në legjislacionin e Kosovës do të mundësojë zbatim më</p>	Refuzohet	<p>Kjo çështje është trajtuar në dokumentin e politikave mbi përmirësimin e qasjes në gjykata dhe prokurori (III.1). Kjo çështje bie në kuadër të një strategjie të vecantë për të adresuar dhunën në familje, dhe prandaj nuk është e nevojshme të trajtohet më detajisht në këtë strategji.</p>
------	-----------------------	--	--	---	-----------	---

				<p>të mirë të këtij instrumenti të rëndësishëm ndërkombëtar. Ne jemi të gatshëm ta mbështesim këtë proces, duke qenë se kemi bërë tashmë përpjekje për t'i identifikuar ligjet dhe dispozitat specifike që duhet të harmonizohen me Konventën e Stambollit. Në fund, duke mbajtur parasysh zbatueshmërinë e saj të drejtpërdrejtë dhe natyrën e dispozitave të Konventës së Stambollit, konsiderojmë se është e rëndësishme që Strategjia të ketë më shumë në fokus këtë temë të veçantë, ashti si edhe rëndësinë dhe implikimin ligjor të inkorporimit të Konventës në Kushtetutë.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Të merret parasysh përcaktimi i qartë i kompetencave për vendimmarrje që i janë dhënë Institucionit të Avokatit të Popullit:</p> <p>Në pjesën “Përmirësimi i qasjes në gjykata dhe prokurori” (faqe 29 e versionit në gjuhën angleze) të projektstrategjisë, që adreson masën e katërt, thuhet: “Theks i veçantë në kuadër të kësaj mase i është kushtuar rolit të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) dhe është propozuar ndryshimi i ligjit për IAP për t’i dhënë kompetenca vendimmarrëse, dhe jo vetëm këshillëdhënëse. Kjo do të ndikonte dukshëm në përmirësimin e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe po ashtu do ta rriste përgjegjësinë e autoriteteve publike karshi pretendimeve të ngritura të qytetarëve për shkelje të të drejtave të njeriut”. Konsiderojmë që dhënia e kompetencave vendimmarrëse Institucionit të Avokatit të Popullit, veç atyre këshillëdhënëse do të duhet të përcaktohet me kujdes pasi kjo mund të ndikojë dukshëm jo vetëm në natyrën dhe mandatin kushtetues të Institucionit të Avokatit të Popullit por të të gjithë sistemit të drejtësisë. Për këtë qëllim, sugjerojmë që hartuesit të rishikojnë mandatin dhe rolin e Institucionit të</p>	Pranohet plotësisht	Aktiviteti për dhënien e kompetencave shtesë për IAP është larguar nga PV.
------	-----------------------	--	--	--	---------------------	--

				<p>Avokatit të Popullit në përputhje me Kushtetutën dhe Parimet e Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin e institucioneve kombëtare (Parimet e Parisit) dhe rekomandimet e tij udhëzuese. Veç kësaj, nëse Institucionit të Avokatit të Popullit i jepen kompetenca vendimmarrëse, duhet të merret parasysh se si do të rishikohen këto vendime. Prandaj, sugjerojmë që të ngritet njëherazi një sistem për rishikimin gjyqësor.</p>		
OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të mjeteve juridike (faqe 30): Të merret parasysh nëse ka ndonjë mënyrë më të mirë për të siguruar llogaridhënie institucionale në lidhje me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Jemi dakord që në kuadër të procedurës penale ka nevojë për një mjet efektiv juridik kur rrezikohet e drejta e një personi për gjykim të drejtë. Megjithatë, kufizimi i mjetit në 'gjykim brenda një afati të arsyeshëm' është panevojshmërisht kufizues. Krijimi i legjislacionit për një çështje të vetme, kur ka shumë çështje të tjera sistematike për t'u adresuar, rrezikon krijimin e një</p>	Pranohet plotësisht	Pikërisht për ta adresuar këtë çështje me në detaje, aktiviteti kërkon hartimin e një analize/koncept dokumenti të veçantë.

				<p>sistemi që është shumë i ndërlikuar nga shumë legjislacione. Këtu i referohemi komentit tonë me numër 15 në pjesën "Problemet lidhur me qasjen në gjykata dhe prokurori" duke qenë se bëhet fjalë për të njëjtën çështje, d.m.th. mungesën e mekanizmave të qartë për përgjegjësinë institucionale kur shkelen të drejtat themelore dhe të njeriut. Futja në zbatim e një gjëje të tillë sikurse 'abuzimi me doktrinën e procesit', ose një sistemi të rishikimit gjyqësor, mund ta përmirësojë shkallën e respektimit jo vetëm të drejtën për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm, por të të gjitha të drejtave të gjyqimit të njerëzishëm dhe të drejtë, si dhe do ta ngriste llogaridhënien në përgjithësi. Sistemi i rishikimit gjyqësor do të kishte avantazhin shtesë të sjelljes së përgjegjësisë për shkeljet e të drejtave të njeriut jashtë procesit të drejtësisë penale. Prandaj, konsiderojmë që hartuesit duhet t'i kushtojnë vëmendje të mëtijshme kësaj çështjeje.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

OSCE	Koment i përgjithshëm			<p>Përmirësimi i kornizës institucionale kundër korrupsionit (Projektstrategjia, faqe 34):Të merret parasysh përfshirja e zbatimit efektiv të Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve si mjet për luftimin e korrupsionit. Konsiderojmë se në strategji duhet të përmendet zbatimi efektiv i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve si mjet për luftimin e korrupsionit. Sipas Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2020 (në faqen 28), "Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirë legjislacionin e ri të BE-së në këtë fushë. Zyrtarët e ngarkuar me trajtimin e ankesave të sinjalizuesve u emëruan në mbi 175 institucione publike, por legjislacioni sekondar që detajon procedurën për trajtim të tillë ende nuk është miratuar. Mekanizma të forcuar të sinjalizimit dhe kërkesa të mbrojtjes mbeten ende të zbatohen në praktikë." Duke qenë se mbrojtja efektive e sinjalizuesve është çelës për luftimin e korrupsionit, sugjerojmë që kjo çështje të konsiderohet në strategji.</p>	Pranohet plotësisht	Ky koment do të reflektohet në tekstin e Strategjisë
------	-----------------------	--	--	--	---------------------	--

OSCE	Koment i pergjithshem			<p>Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit (faqe 35): Të merret parasysh përfshirja e Institucionit të Avokatit të Popullit si anëtar i Komitetit Drejtues që mbikëqyr zbatimin e Strategjisë. Në pjesën “Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit” (faqe 38 e versionit në gjuhën angleze) të projektstrategjisë parashihet Komiteti Drejtues të Strategjisë, “që është trupa kryesore drejtuese e strategjisë dhe planit të veprimit”. Komiteti Drejtues “përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë dhe përbërja e tij specifike është e përcaktuar në figurën e mëposhtme”. Në përbërjen e Komitetit Drejtues janë kryesuesit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), bashkë me Ministrinë e Drejtësisë si bashkëkryesuese, si edhe tetë (8) anëtarët, gjegjësisht ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Financave, përfaqësues nga Zyra e Presidentit, përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, drejtori i Akademisë së Drejtësisë, përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës, përfaqësues nga partnerët zhvillimorë. Sugjerojmë që Institucioni i Avokatit të Popullit, si institucion i pavarur i të drejtave të</p>	Pranohet plotësisht	Pranohet komenti dhe IAP do të përfshihet në Komitetin Drejtues.
------	-----------------------	--	--	--	---------------------	--

				njeriut dhe kushtetues, të përfshihet në radhët e Komitetit Drejtues që mbikëqyr zbatimin e Strategjisë.		
ZPS	Koment i pergjithshem			Zyra për Planifikim Strategjik konsideron se fusha e sundimit të ligjit është shumë e gjerë e cila mbulohet nga disa institucione, kryesisht nga MD dhe MPB. Duhet theksuar se fusha e sundimit të ligjit është trajtuar pjesërisht edhe në dokumente tjera strategjike, si strategjia kombëtare për zhvillim, strategjia e sigurisë, kundër krimit të organizuar, etj. Në bazë të definimit të fushëveprimit, kjo strategji mbulon kryesisht vetëm një pjesë të fushës së sundimit të ligjit, kryesisht sektorin e drejtësisë. Prandaj, ZPS konsideron së është më e nevojshme dhe dobishme që fushëveprimi i kësaj strategjie të ndryshohet në mënyrë që të mbulojë vetëm sektorin e drejtësisë. Duke e marrë parasysh që sundimi i ligjit nuk trajtohet si sektor i veçantë në	Refuzohet	Emri i procesit të Rishikimit dhe, rrjedhimisht emri i Strategjisë, janë të përcaktuara me vendimin e Qeverisë me të cilin është nisë ky proces. Për këtë arsye, MD nuk mund të ndryshojë emrin e Strategjisë në mënyrë të pavarur.

				<p>kuptimin e definimit të sektorëve, por si fushë e gjerë ku hyn edhe sektori i sigurisë publike dhe fusha tjera, ZPS konsideron se titulli i kësaj strategjie duhet të jetë “Strategjia e Drejtësisë”. Kjo edhe për arsye se tanimë ka filluar përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030, e cila ka si shtyllë të parë “Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja e Mirë”, ku do të trajtohen në tërësi dhe në përgjithësi sfidat në fushën e sundimit të ligjit, përfshirë drejtësinë, sigurinë publike, të drejtat e njeriut, krimin e organizuar dhe korrupsionin, të drejtat pronësore, etj. Duke zbatuar Kornizën Kombëtare për Planifikim Strategjik, strategjitë sektoriale do të bazohen dhe do të rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim. Në këtë rast, Strategjia e Drejtësisë është një shembull i mirë i referimit. MD duhet të sigurojë që gjithashtu kjo strategji të integrojë në vete edhe fushën e të drejtave pronësore e cila aktualisht mbulohet përmes Strategjisë për të Drejtat Pronësore.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

ZPS	Koment i pergjithshem			<p>Sa i përket treguesve, Zyra për Planifikim Strategjik, siç e ka theksuar edhe në takimet e mbajtura me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, konsideron se nuk janë mjaftueshëm të përshtatshëm për matjen e zbatimit të strategjisë. Kjo për dy arsye:</p> <p>1) për shkak të gjithëpërfshirjes së matjes nga ana e ëorld Justice Project (ëJP) për fusha të caktuara, dhe</p> <p>2) për shkak të metodologjisë që përdorë ëJP për të bërë matje.</p> <p>Duke marrë parasysh përmbajtjen e planit të veprimit, ZPS konsideron se fushat të adresuara në PV nuk mbulojnë sa duhet treguesit e ëJP, për arritjen e planifikuar. Po ashtu, në bazë të metodologjisë, ëJP interviston apo merr në konsideratë përgjigjet e praktikuesve të ligjit, ekspertëve të avancuar, akademikëve, etj. Prandaj, konsiderojmë se jo të gjithë këta mund të kenë informacionet e duhura mbi zbatimin e veprimeve të caktuara të PV të strategjisë dhe të japin përgjigjet e tyre që mund të ndikojnë në indeks. Sidoqoftë, ZPS ka theksuar dhe ende qëndron prapa propozimit që të përdoren tregues vendorë në Strategji, aty ku kjo është e mundur.</p>	Pranohet pjesërisht	Pranohet dhe janë shtuar indikatorë tjerë shtesë.
-----	-----------------------	--	--	--	---------------------	---

ZPS	Koment i pergjithshem			<p>Aspekte të tjera që ZPS i konsideron të rëndësishme për Strategjinë janë ato aspekte si: puna rutinore e institucioneve që janë palë zbatuese e strategjisë, veprimet e shumta të cilat mund të bashkohen, kuantifikimi i rezultateve, riorganizimi i strukturave të institucioneve, periudha e miratimit të ligjeve në Qeveri apo në Kuvend, hartimi i akteve nënligjore të parapara në ligj si bazë specifike ligjore, propozimi i hartimit të dokumenteve strategjike, etj.</p> <p>ZPS nuk është lëshuar në tërësi në PV sa i përket komentimit të këtyre veprimeve veç-e-veç, përveç në disa raste të caktuara. Sidoqoftë, ZPS konsideron se duhet të tregohet një kujdes më i madh sa i përket largimit nga PV të punës rutinore, ndonëse disa prej veprimeve të vendosura kanë për qëllim të shtyjnë përpara aspekte që aktualisht nuk janë duke u zbatuar.</p>	Pranohet plotësisht	Pranohet dhe është reflektuar në Planin e Veprimit për aq sa ka qenë e mundshme.
ZPS	Koment i pergjithshem			ZPS po ashtu rekomandon që rezultatet duhet të kuantifikohen (posaçërisht në ato rezultatet ku ka trajnime), në mënyrë që të jenë të sakta dhe të matshme.	Pranohet plotësisht	Pranohet dhe kjo është përcaktuar në bashkëpunim me AD.

ZPS	Koment i pergjithshem			Gjithashtu konsideron se një pjesë e veprimeve të vendosura në PV mund të bashkohen, pa marrë parasysh se janë për institucione të ndryshme, pasi që ato janë të njëjta.	Refuzohet	Arsyeja e ndarjes së aktiviteteve në dy apo më shumë rreshta është që gjatë fazës së zbatimit të mundësohet matja më e mirë e rezultateve. Kështu, psh., nëse KGJK e ka kryer një aktivitet por KPK jo, atëherë njihet edhe puna e KGJK-së edhe ngecja e KPK-së në këtë aktivitet specifik.
ZPS	Koment i pergjithshem			ZPS njëkohësisht konsideron se duhet të ndiqet një qasje uniforme sa i përket rezultateve për ato veprime që parashohin hartimin dhe miratimin e ligjeve: a parashihet miratimi i ligjeve të bëhet në Qeveri apo në Kuvend (kjo pasi që në raste të caktuara theksohen ndryshe)? Po ashtu, duke marrë parasysh propozimin e hartimit të akteve nënligjore, ka filluar një praktikë që propozimet e akteve nënligjore të kenë bazë specifike ligjore, kërkesë kjo e Rule of Laë Check List të Komisionit të Venedikut.	Pranohet plotësisht	
ZPS	Koment i pergjithshem			ZPS rekomandon që veprimet që parashohin shtimin apo riorganizimin e strukturës brenda një institucioni	Refuzohet	Pavarësisht ekzistencës së procedurës ligjore,

				që është palë zbatuese e strategjisë (në këtë rast të MD-së) të largohen nga PV, duke qenë se konsiderojmë se një riorganizim i tillë nuk mund të jetë pjesë e planifikimit strategjik, pasi që ka procedurë përkatëse ligjore për të njëjtë çështje.		është më mirë që ndryshimet e këtilla të parashihen strategjikisht.
ZPS	Koment i pergjithshem			Mes tjerash, ZPS konsideron se të gjitha propozimet për hartim të dokumenteve tjera strategjike në PV, duhet të largohen, duke marrë parasysh se për propozimet e tilla ka një procedurë të caktuar ligjore e cila duhet të ndiqet.	Refuzohe t	Në shumicën e rasteve nuk është fjala për Dokumente të përgjithshme strategjike, por të tilla që adresojnë probleme specifike.
ZPS	Koment i pergjithshem			Sa i përket pjesës narrative të Strategjisë, ZPS konsideron se Strategjia përveç definimit të sfidave dhe pengesave në sektorin e drejtësisë, ajo duhet dhe do të jetë edhe një dokument reprezentativ i Qeverisë, brenda dhe jashtë vendit. Prandaj, ZPS konsideron se fjalitë si “Cenueshmëria e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, ndaj akterëve të jashtëm, qoftë në aspekt të organizatave apo individëve, mbetet problematike në Kosovë. Kjo nënkupton se integriteti mungon tek gjyqtarët dhe prokurorët e caktuar, që pastaj ndikon potencialisht në vendimet e tyre.”, duhet të largohen nga pjesa narrative. Kjo për shkak se nuk është vërejtur se ka një referim	Pranohet plotësisht	Pranohet dhe është reflektuar në tekstin e Strategjisë.

				apo burim të sigurt dhe të besueshëm në lidhje me këtë. Po ashtu, në tërësi, draft strategjisë, duhet t'i bëhet një lekturë e lehtë.		
ZPS	I.1_Llogaridhenja	22	Zbatimi i masave të politikës nga KGJK dhe KPK për sigurimin e përfaqësimit gjinor dhe etnik	Ky veprim është punë rutinë. Parimisht, nëse këto masa ekzistojnë, ato duhet të zbatohen. Prandaj, ose të largohet, ose të riformulohet në atë mënyrë që të përbëjë diçka të re.	Refuzohet	Wshtë diskutuar edhe me KGJK-në dhe OSCE-në dhe është konsideruar që kjo masë është me rëndësi që të mbetet këtu. KGJK ka disa masa edhe në planet e tyre strategjike si dhe në aktet e tyre të brendshme që adresojnë më detajisht këtë qëllim.
ZPS	I.1_Llogaridhenja	24	Ndryshimi i legjislacionit mbi vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, për t'u siguruar se kriteret kualitative, treguesit dhe procedurat për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve	Duhet të theksohet se legjislacion (primar apo sekondar). Varesisht si vendoset, të percillet forma e njejtë në të gjitha veprimet. Sa me konkret veprimi, aq me mirë.	Pranohet plotësisht	Wshtë riformuluar aktiviteti, për të specifikuar se është fjala për një akt nënligjor.

			parashikohen në detaje me legjislacion			
ZPS	I.1_Llogaridhenja	26	Miratimi i kornizës ligjore për të siguruar që funksionet e Njësive të Inspektimit Gjyqësor (NJIGJ) të parashihen me ligj, duke respektuar pavarësinë prokuroriale	Te behet nje riformulim i lehte. A eshte ne pyetje ndryshimi i ndonje ligji, apo hartimi i nje ligji te ri?	Pranohet plotësisht	Wshtë riformuluar aktiviteti - është sqaruar që duhet ndryshuar ligji për KPK-në
ZPS	I.1_Llogaridhenja	29	Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve me shpjegime të hollësishme nga KGJK dhe KPK lidhur me tërë procesin e vlerësimit të performancës	Udhëzimet ne kete rast jane udherrefyes apo manuale. Per te shmangur paqartesine eventuale, mendoj se eshte me mire te perdoret fjala udherrefyes apo manual.	Pranohet plotësisht	Wshtë riformuluar në "manuale"

ZPS	I.1_Llogaridhenja	30	Komisionet e vlerësimit të performancës të bëjnë publikimin e rregullt të raporteve mbi numrin e gjyqtarëve që janë vlerësuar, rekomandimet e dhëna, dhe t'ua dorëzojnë ato palëve me kohë	A eshte kjo nje detyrim per komisionet? Nese po, atehere eshte pune rutinore. Nese jo, atehere se pari per ta bere kete duhet te rregullohet me legjislacion (ndoshta me ndonje ndryshim plotesim te ndonje akti juridik).	Refuzohet	MD është e mendimit që kjo mund të adresohet pa pasur nevojë që të ndryshohet rregullorja. Nuk është e nevojshme të ndryshohet rregullorja për dicka që praktikisht mund të bëhet edhe pa ndryshim të rregullores.
ZPS	I.1_Llogaridhenja	31	Komisionet e vlerësimit të performancës të bëjnë publikimin e rregullt të raporteve mbi numrin e prokurorëve që janë vlerësuar, rekomandimet e dhëna, dhe t'ua dorëzojnë ato palëve me kohë	A eshte kjo nje detyrim per komisionet? Nese po, atehere eshte pune rutinore. Nese jo, atehere se pari per ta bere kete duhet te rregullohet me legjislacion (ndoshta me ndonje ndryshim plotesim te ndonje akti juridik).	Refuzohet	MD është e mendimit që kjo mund të adresohet pa pasur nevojë që të ndryshohet rregullorja. Nuk është e nevojshme të ndryshohet rregullorja për dicka që praktikisht mund të bëhet edhe pa ndryshim të rregullores.

ZPS	I.2_Efikasiteti	22	Zbatimi i vazhdueshem dhe konsistent i SMIL në mënyrë që raportet të ofrojnë përmbajtje sasiore dhe analitike dhe që publiku të ketë qasje në informata për rolin dhe veprimtarinë e gjykatave dhe prokurorive.	Kjo eshte pune rutinore dhe obligim per Gjykatën. Prandaj, duhet te konsiderohet largimi i ketij veprimi.	Refuzohe t	Zbatimi i SMIL është element qenësor për këtë Strategji dhe nga i cili varen edhe shumë veprime të tjera. Prandaj, është tejet e rëndësishme që të mbetet këtu.
ZPS	I.2_Efikasiteti	26	Futja e caktimit automatik të lëndëve tek gjyqtarët	Ky veprim eshte ne rregull, vetemse duhet te behet nje riformulim i lehte qe te jete i qarte.	Pranohet plotësisht	Wshtë riformuluar
ZPS	I.2_Efikasiteti	28	Themelimi i një komisioni të vetëm për rishikimin e legjislacionit në fushën komerciale.	Duhet te behet formulimi i sakte sa i perket themelimit te ketyre mekanizmeve. Kjo duhet te jete nje grup punues dhe jo nje komision.	Pranohet plotësisht	Wshtë riformuluar në "grup punues".
ZPS	I.2_Efikasiteti	29	Kryerja e vlerësimit të ndikimit legjislativ në kuadrin ligjor ekzistues.	Ky veprim mund te bashkohet me veprimin me larte, ku theksohet themelimi i mekanizmit.	Refuzohe t	Këto janë dy aktivitete të ndara, për qëllime të ndara. Ndërkohë që i pari bën vlerësim
ZPS	I.2_Efikasiteti	30	Hartimi i Pakos së Ligjeve komerciale.	Ndoshta eshte me mire te behet nje identifikim i ligjeve, apo i fushave qe do te rregullojne keto ligje. Natyrisht, kjo mund te jete indikative, pasi qe kjo parimisht behet gjate vleresimit te ndikimit rregullativ.	Refuzohe t	Kjo është e pamundur të bëhet në këtë fazë. Për këtë qëllim është propozuar që të themelohet grupi

						punues i përmendur më sipër.
ZPS	I.2_Efikasiteti	31	Hartimi i Ligjit për Gjykatën Komeriale.	Ligji është hartuar. Kjo duhet të riformulohet. Psh., mund të jetë adresimi i komentimit publik.	Refuzohet	Ligji është kthyer prapa dhe prandaj fillon ri-hartimi i tij. Edhe adresimi i komenteve është punë drejt hartimit të Ligjit.
ZPS	I.2_Efikasiteti	33	Përshtatja dhe rirregullimi i buxhetit të Gjykatës Komeriale.	Me funksionalizimin e GJK, kjo realizohet me kërkesë dhe paraqitje të nevojave buxhetore. Prandaj, si veprim nuk e ka vendin në Strategji.	Refuzohet	Ligji është kthyer prapa dhe prandaj fillon ri-hartimi i tij. Edhe adresimi i komenteve është punë drejt hartimit të Ligjit.
ZPS	I.2_Efikasiteti	37	Nxitja e përfshirjes së klauzolave të arbitrazhit në kontratat biznesore që përfshijnë ekzekutimin e aktiviteteve me risk të lartë dhe kohë të ndjeshme	Ky nuk është një veprim. Ky mund të jetë një objektivi. Prandaj, rekomandojmë që të ketë një planifikim më të detajshëm në lidhje me këtë nxitje, që përfshijnë disa veprime të njepasnjeshme.	Pranohet plotësisht	Wshhtë pranuar dhe është konkretizuar me fokus në fushata dhe aktivitete të tjera vetdijësuese
ZPS	I.2_Efikasiteti	39	Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale të MD-së për	Kjo nuk duhet të jetë pjesë e Strategjise si veprim. Rregullorja e brendshme e MD-së hartohet dhe nënshkruhet nga autoriteti përkatës dhe sipas nevojave të veta	Pranohet pjesërisht	Aktiviteti është riformuluar, por nga MD është konsideruar e nevojshme që edhe struktura e ardhshme

			mbikëqyrje të duhur të profesionit të ndërmjetësimit.	organizates buxhetore. Mirepo, nuk është praktike dhe nuk duhet të zhvillohet një praktike e tillë që në dokumente strategjike të planifikohet edhe organizimi i strukturave të ministrive, pa marrë parasysh qëllimin e fuqizimit të kapaciteteve, për çfarë mendojme se është ide e mirë.		organizative e MD-së të theksohet në Strategji, ngase kjo siguron arritjen e objektivave të paracaktuara.
ZPS	I.3_Profesionalizimi	32	Përcaktimi i kriterëve të rrepta dhe të qarta për zgjedhjen e mentorëve.	Te riformulohet.	Refuzohet	Aktiviteti është konkret dhe i nevojshëm
ZPS	I.3_Profesionalizimi	33	Përcaktimi i kriterëve të qarta për zgjedhjen e mentorëve	Te riformulohet.	Refuzohet	Aktiviteti është konkret dhe i nevojshëm
ZPS	I.4_Integriteti	28	Këshilli fton partnerët ndërkombëtar dhe OSHC-të për monitorimin e të gjitha fazave të procesit të rekrutimit.	Konsiderojmë se kjo nuk ka nevojë të jete pjese e PV si veprim.	Refuzohet	Aktiviteti është konkret dhe i nevojshëm për të siguruar bashkëpunimin midis OSHC-ve dhe institucioneve.
ZPS	I.4_Integriteti	46	Miratimi i Planit të Integritetit për gjyqtarë.	Është e njëjta me rezultatin. Riformulim: "Hartimi...". Kjo sepse po perseritet me rezultatin.	Pranohet plotësisht	Pranohet dhe riformulohet në "Hartimi"
ZPS	I.4_Integriteti	47	Miratimi i Planit të Integritetit për prokurorë.	Është e njëjta me rezultatin. Riformulim: "Hartimi...". Kjo sepse po perseritet me rezultatin.	Pranohet plotësisht	Pranohet dhe riformulohet në "Hartimi"

ZPS	I.4_Integriteti		Ligji për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës (shih 1.4.3.1) përcakton qartazi qëllimin e kontroleve të integritetit.	Nese kjo percaktohet me ligj, pse duhet te jete si veprim. Propozojme qe kjo te largohet si veprim.	Refuzohet	
ZPS	I.4_Integriteti		Ligji për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës (shih 1.4.3.1) parasheh realizimin e kontroleve të rregullta të integriteti.	Nese parashihet kjo me ligj, pse duhet te theksohet si veprim. Propozojme te largohet.	Refuzohet	Qëllimi i formulimit të aktivitetit në formë të këtillë është që të sigurohet se Ligji do t'i përmbajë këto karakteristika. Nëse aktiviteti lihet si i përgjithshëm, lejon mundësi të miratimit të ligjit pa i siguruar këto elemente të cilat janë të rëndësishme për procesin e Rishikimit.
ZPS	II.4_Policia	12	Përditësimi i strategjisë për marrëdhënie me publikun për përdorim më të mirë të mediave sociale në ndërtimin e	Kjo nuk eshte strategji e rregullt sipas UA 07/2018, por nje strategji e brendshme. Prandaj, si te tille rekomandojme largimin nga PV.	Refuzohet	Pavarësisht së është Strategji e llojit tjetër, nuk duhet hequr nga PV meqë ekzistenca e saj është me rëndësi për Policinë.

			raporteve me publikun			
ZPS	II.4_Policia	20	Hartimi i Udhëzimit Administrativ i cili përcakton procedurën për punë të përbashkët, përfshirë këtu zhvillimin e hetimeve të përbashkëta, brenda drejtorateve të Policisë, dhe zhvillimin e hetimeve të përbashkëta ndërkombëtare	A është kërkesë e ligjit?	Pranohet plotësisht	Po, ka bazë ligjore dhe është e nevojshme të ketë një procedurë të këtillë.
ZPS	III.2_Mjetet juridike	16	Prokurorët e shtetit dhe policia ofrojnë informata të detyrueshme për individët në lidhje me të drejtën e tyre për përfaqësim ligjor dhe pasojat e heqjes dorë nga kjo e drejtë	A nuk është kjo obligim? Nëse po, është punë rutinore dhe duhet të largohet nga PV.	Refuzohet	Obligimi ligjor ekziston, por është e domosdoshme të mbetet në PV për shkak të rëndësisë dhe meqë raportet dokumentojnë se ai nuk zbatohet gjithmonë në praktikë.

ZPS	III.2_Mjetet juridike	26	Ndryshimi i kornizës legislative për vendosjen e kriterëve të kualifikimit për avokatët mbrojtës të caktuar "ex officio" në çështje të ndërlikuara dhe të rënda penale	Cila është kjo kornizë? Është mirë të theksohet legjislacioni që duhet të ndryshohet dhe e njëjta të reflektohet edhe në rezultat.	Pranohet plotësisht	Pranohet dhe do të sqarohet në PV.
ZPS	III.4_Shoqëria civile	10	Miratimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	A hartohet kjo strategji sipas UA 07/2018? Sidoqoftë, konsiderojmë se hartimi apo miratimi i strategjive tjera, nuk është e nevojshme të paraqitet në PV të një strategjie. Prandaj, kerkojmë që kjo të largohet nga PV.	Refuzohet	Nuk është e nevojshme që një Strategji të jetë vetëm e tillë në përputhje me UA 07/2018 për t'u konsideruar si e rëndësishme dhe e nevojshme. Hartimi dhe miratimi i këtyre dokumenteve strategjike është i rëndësishëm për të mundësuar bashkëpunim më konkret midis OSHC and KGJK, KPK etj.

ZPS	III.4_Shoqeria civile	11	Miratimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	A hartohet kjo strategji sipas UA 07/2018? Sidoqofte, konsiderojme se hartimi apo miratimi i strategjive tjera, nuk është e nevojshme të paraqitet në PV të një strategjie. Prandaj, kerkojme që kjo të largohet nga PV.	Refuzohet	Nuk është e nevojshme që një Strategji të jetë vetëm e tillë në përputhje me UA 07/2018 për t'u konsideruar si e rëndësishme dhe e nevojshme. Hartimi dhe miratimi i këtyre dokumenteve strategjike është i rëndësishëm për të mundësuar bashkëpunim më konkret midis OSHC and KGJK, KPK etj.
ZPS	III.4_Shoqeria civile	12	Miratimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	A hartohet kjo strategji sipas UA 07/2018? Sidoqofte, konsiderojme se hartimi apo miratimi i strategjive tjera, nuk është e nevojshme të paraqitet në PV të një strategjie. Prandaj, kerkojme që kjo të largohet nga PV.	Refuzohet	Nuk është e nevojshme që një Strategji të jetë vetëm e tillë në përputhje me UA 07/2018 për t'u konsideruar si e rëndësishme dhe e nevojshme. Hartimi dhe miratimi i këtyre dokumenteve strategjike është i rëndësishëm për të mundësuar bashkëpunim më konkret midis OSHC and KGJK, KPK etj.

ZPS	III.4_Shoqeria civile	13	Hartimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	A hartohet kjo strategji sipas UA 07/2018? Sidoqofte, konsiderojme se hartimi apo miratimi i strategjive tjera, nuk është e nevojshme të paraqitet në PV të një strategjie. Prandaj, kerkojme që kjo të largohet nga PV.	Refuzohet	Nuk është e nevojshme që një Strategji të jetë vetëm e tillë në përputhje me UA 07/2018 për t'u konsideruar si e rëndësishme dhe e nevojshme. Hartimi dhe miratimi i këtyre dokumenteve strategjike është i rëndësishëm për të mundësuar bashkëpunim më konkret midis OSHC and KGJK, KPK etj.
ZPS	III.4_Shoqeria civile	14	Hartimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	A hartohet kjo strategji sipas UA 07/2018? Sidoqofte, konsiderojme se hartimi apo miratimi i strategjive tjera, nuk është e nevojshme të paraqitet në PV të një strategjie. Prandaj, kerkojme që kjo të largohet nga PV.	Refuzohet	Nuk është e nevojshme që një Strategji të jetë vetëm e tillë në përputhje me UA 07/2018 për t'u konsideruar si e rëndësishme dhe e nevojshme. Hartimi dhe miratimi i këtyre dokumenteve strategjike është i rëndësishëm për të mundësuar bashkëpunim më konkret midis OSHC and KGJK, KPK etj.

ZPS	III.5_MD	14	Themelimi i një mekanizmi të koordinimit me të gjithë akterët e drejtësisë.	Cfare natyre ka ky mekanizem? Nuk mund te jete nje trup qeveritar sipas RrPQ. Kush e themelon? A ka baze ligjore per kete?	Refuzohet	Dokumentet e politikave qartësojnë se është fjala për një mekanizëm jo-obigativ por me fokus në koordinim. Bazë ligjore tjetër nuk ka nevojë të ketë, përveç ndonjë memorandumit të mirëkuptimit për të lehtësuar procedurat.
ZPS	III.5_MD	15	Themelimi i mekanizmit për koordinimin e donatorëve në sektorin e drejtësisë.	Cilet jane keta donatore? Ne nivel qeveritar, koordinimi i donatoreve behet nga DAZH, ku ekzistojne ndarjet strukture per mbulimin e sektorit te drejtesise. Po ashtu, ekziston edhe rregullorja perkatese per kete.	Refuzohet	Konsiderojmë se nuk është e nevojshme të cekem donatorët në PV. DAZH natyrisht se përfshihet dhe koordinimi bëhet në përputhje me rregullat e qeverisë për donatorë.